The electronic version of the book is created by
http://www.enverhoxha.ru

EPOPEJA
E LUFTES ANTIFASHISTE
NACIONALÇLIRIMTARE
E POPULLIT SHQIPTAR
1939 - 1944





EPOPEJA E LUFTES ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE E POPULLIT SHQIPTAR 1939-1944

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

INSTITUTI I HISTORISË PRANË AKADEMISË SË
SHKENCAVE TË RPSSH

ARKIVI QENDROR I PPSH

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORU TIRANË. 1980



E N V E R H O X H A

Organizatore dhe udhëheqëse e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ishte Partia Komuniste e Shqipërisë me shokun Enver Hoxha në krye, themeluesin dhe mësuesin e saj.

«Në luftën legjendare me armiqtë më të egër të njerëzimit, fashistët italianë e nazistët gjermanë, u shfaqën me një forcë të dhjetëfishuar e mbi një bazë të re trimëria dhe heroizmi i popullit shqiptar, shpirti i tij i pamposhtur liridashës, urrejtja e thellë për shtypësit e skllavëruesit, guximi dhe vendosmëria për të luftuar pa marrë parasysh asnjë sakrificë dhe për të fituar mbi armiqtë.

Udhëheqja e kësaj lufte ishte Partia Komuniste e Shqipërisë, e cila me politikën e saj të drejtë e largpamëse e me heroizmin e saj të pashoq ngriti në këmbë mbarë popullin dhe e çoi atë në fitoren e madhe historike, çlirimin e plotë të Atdheut dhe triumfin e revolucionit popullor».

ENVER HOXHA

EPOPEJA E LUFTES ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE E POPULLIT SHQIPTAR 1939-1944

Shqiptarët kanë luftuar pa pushim gjatë shekujve kundër pushtuesve e skllavëruesve të ndryshëm për lirinë dhe pavarësinë, por asnjëherë nuk siguruan liri e pavarësi të plotë dhe të qëndrueshme. Edhe më 1912, kur Shqipëria shpalli pavarësinë dhe krijoi shtetin e parë kombëtar shqiptar, imperialistët nuk e lanë të gëzonte frytet e kësaj fitoreje historike. Gjatë regjimit mbretëror të Zogut, pavarësia nuk ishte veçse formale. Në të vërtetë, Zogu me anë të politikës së tij antipopullore dhe antikombëtare e kishte shndërruar vendin në një gjysmëkoloni italiane.

Vetëm me fitoren e arritur në luftën kundër pushtuesve fashistë italianë e gjermanë dhe kundër tradhtarëve, populli shqiptar fitoi lirinë dhe pavarësinë e plotë kombëtare, u bë zot i fateve të veta. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare është epopeja më e lavdishme në historinë e popullit shqiptar.

Shqipëria është nga viktimat e para të agresionit fashist. Më 7 prill 1939 ushtria italiane zbarkoi në tokën shqiptare. Populli shqiptar, ndonëse i tradhtuar dhe i braktisur nga mbreti dhe qeveria e tij, u ngrit në këmbë kundër agresorëve fashistë. Por ai nuk mund t'i bënte ballë këtij agresioni për arsye se ishte i paarmatosur, i paorganizuar, pa udhëheqje.

Italia fashiste vendosi në Shqipëri një regjim të egër pushtimi dhe u mundua të zbatojë planet e saj të italianizimit e shfrytëzimit ekonomik, si edhe të shndërrimit të tokës shqiptare në plasdarm për agresione kundër popujve fqinjë. Pas kapitullimit të Italisë, në shtator 1943, Shqipërinë e pushtuan nazistët gjermanë dhe e vunë atë nën një regjim robërie akoma më të egër. Ushtritë fashiste shkaktuan rrënime dhe dëme të jashtëzakonshme. Në krahasim me popullsinë, Shqipëria është një nga vendet, që zë radhën e parë në dëmet e pësuara në njerëz dhe sidomos në vlera materiale dhe kulturore.

Për më tepër se pesë vjet e gjysmë populli shqiptar zhvilloi kundër pushtuesve italianë e gjermanë luftën më burrërore, më të organizuar e më fitimtare, që kishte bërë gjatë historisë së tij.

EPOPEJA E LUFTES ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE E POPULLIT SHQIPTAR 1939-1944

Organizatore dhe udhëheqëse e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ishte Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH) me shokun Enver Hoxha në krye, themeluesin dhe mësuesin e saj.

Luftën Nacionalçlirimtare populli shqiptar e filloi si një qëndresë, një kundërveprim të ligjshëm kundër pushtimit të vendit, për t'i bërë ballë asgjësimit si komb e si popull. Kjo luftë, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, u zgjerua dhe u forcua pandërprerje, u organizua dhe u shndërrua në një revolucion të vërtetë antifashist, antiimperialist demokratik.

Një faktor vendimtar në arritjen e fitores përfundimtare mbi pushtuesit e tradhtarët ishte *bashkimi i çeliktë i popullit rreth Partisë,* që u farkëtua në zjarrin e luftës çlirimtare, të revolucionit popullor.

Çdo herë që populli shqiptar ka arritur të bashkohet, si në kohën e Skënderbeut dhe në kohën e Rilindjes, ai është bërë i pathyeshëm përballë armiqve, sado të mëdhenj, të fuqishëm e të egër të kenë qenë ata.

Por bashkim të atillë të fortë e'të qëndrueshëm të popullit, si ai që u arrit në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare nën udhëheqjen e PKSH, nuk ka njohur më parë historia shumëshekullore e Shqipërisë. Ky bashkim u mishërua në *Frontin Nacionalçlirimtar.*

Fronti në Shqipëri nuk u krijua si një koalicion partish a organizatash politike, por si një bashkim vullnetar i masave të gjera popullore. Partia dhe udhëheqësja e vetme në Front ishte Partia Komuniste.

Forcat shoqërore kryesore të Frontit ishin klasa punëtore, si forcë politike udhëheqëse, dhe fshatarësia punonjëse, si baza më e gjerë, burimi e forca më e madhe e armatosur e Luftës Nacionalçlirimtare.

Në mënyrë të veçantë në Front vërshoi rinia, e cila përbënte fuqinë më të gjallë, më luftarake të Lëvizjes. Rinia gjeti në vijën politike të Partisë e në platformën e Frontit plotësimin në perspektivë të dëshirave të zjarrta materiale e shpinërore të saj për liri e pavarësi, për zhvillim e përparim ekonomik, arsimor e kulturor, për një jetë të begatshme e të lumtur. Nuk ishte e rastit që Lufta Nacionalçlirimtare e popullit thirrej shpesh «lufta e rinisë».

Një fenomen i ri në bashkimin e popullit në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare ishte pjesëmarrja e gjerë e gruas shqiptare, e cila luftoi krah për krah me burrat me të gjitha format, duke përfshirë edhe luftën me armë.

Bashkimi i popullit në Frontin Nacionalçlirimtar u qëndroi të gjitha provave, duke u treguar i oathyeshëm përballë përpjekjeve që bënë dhe mjeteve që përdorën armiqtë për ta shkatërruar atë. «Balli Kombëtar» dhe «Legaliteti», që u krijuan si reaksion kundër Frontit, posaçërisht për ta përçarë dhe për ta asgjësuar bashkimin e popullit rreth Partisë, u demaskuan si organizata tradhtare, vegla të pushtuesve, dhe u dërrmuan nga goditjet e fuqishme të popullit kryengritës e të Ushtrisë së tij Nacionalçlirimtare.

Fatin e luftës kundër pushtuesve e tradhtarëve e vendosi *kryengritja me armë.*

Kjo kryengritje filloi me aksione të guximshme të armatosura të komunistëve e të patriotëve, të njësiteve guerile e të çetave partizane e vullnetare, që erdhën gjithnjë duke u shtuar dhe forcuar në valën e lëvizjen çlirimtare revolucionare. Nga njësitet guerile e çetat u kalua në batalione, në krijimin e shtabeve të qarqeve dhe të Shtabit të Përgjithshëm 10 korrik 1943, kur kryengritja e armatosur kishte marrë karakterin e një kryengritje të përgjithshme, e një lufte të armatosur popullore e cila bazën kryesore e kishte në fshat, por që zhvillohej me forcë të madhe edhe në qytet.

Shtabi i Përgjithshëm organizoi *Ushtrinë e rregullt Nacionalçlirimtare Shqiptare (UNÇSH),* themelet e së cilës qenë hedhur që në vitin 1942 dhe në fillim të vitit 1943 me njësitet guerile, me çetat e batalionet partizane. Ai realizoi udhëheqjen e centralizuar strategjike e operative të kryengritjes së përgjithshme të armatosur, përpunoi njëkohësisht edhe taktikën e kësaj kryengritjeje.

Formacioni më i madh i Ushtrisë së rregullt Nacionalçlirimtare në fillim u caktua brigada, kurse në Kongresin e Përmetit, maj 1944, u vendos krijimi edhe i divizioneve e i korparmatave. Në Kongres shoku Enver Hoxha, Sekretar i Përgjithshëm i PKSH, u emërua Komandant i Përgjithshëm i UNÇSH.

Ushtria Nacionalçlirimtare dhe populli kryengritës shqiptar u bënë ballë me heroizëm operacioneve të mëdha armike të dimrit 1943-1944 dhe të qershorit 1944, dolën ngadhnjyes mbi ushtrinë naziste gjermane dhe forcat e armatosura kuislinge. Ua morën nga duart armiqve iniciativën operative e strategjike dhe në fund të qershorit 1944 u hodhën në mësymje të përgjithshme, e cila çoi në dëbimin e pushtuesve, në shkatërrimin e forcave tradhtare dhe në çlirimin e plotë të vendit më 29 nëntor 1944, pa qenë nevoja të vinte në Shqipëri Ushtria e Kuqe ose ndonjë ushtri tjetër mike për ndihmë të drejtpërdrejtë. Shqipëria është i vetmi vend në Evropë që u çlirua vetëm nga Ushtria e tij Nacionalçlirimtare dhe populli kryengritës.

EPOPEJA E LUFTES ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE E POPULLIT SHQIPTAR 1939-1944

Njëkohësisht me organizimin e forcimin e luftës së armatosur, në zjarrin e kësaj lufte, lindi, u zhvillua dhe u forcua *pushteti popullor i këshillave nacionalçlirimtare.*

Këshillat u krijuan drejtëpërdrejtë nga masat popullore kryengritëse nën udhëheqjen e PKSH. Konferenca Nacionalçlirimtare e Labinotit, shtator 1943, duke iu përgjigjur kërkesave të masave popullore, i shpalli këshillat nacionalçlirimtare si i vetmi pushtet i popullit në Shqipëri, kurse Kongresi i Përmetit, në maj 1944, mbi bazën e këtij pushteti themeloi shtetin e ri shqiptar të demokracisë popullore. Në Kongres u krijua Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar, si i pari kuvend popullor i Shqipërisë, dhe Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar, si e para qeveri demokratike popullore me president shokun Enver Hoxha.

Çlirimi i plotë e gjeti vendin me çështjen e pushtetit plotësisht të zgjidhur në dobi të forcave demokratike revolucionare, të popullit.

Në shkallë ndërkombëtare Lufta Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar ishte pjesë përbërëse e luftës bolërore antiiashiste. Me luftën e vet heroike populli ynë i tregoi botës se Shqipëria e vërtetë nuk ishte ajo që një grusht tradhtarësh e kishin shpallur «aleate të Boshtit», por ajo që populli kryengritës, me Partinë Komuniste në krye, e kishte vënë veten në radhët e pjesëtarëve më aktivë të popujve dhe shteteve të koalicionit të madh antifashist, një popull prej vetëm 1 milion vetash, që ngriti një ushtri çlirimtare prej 70 mijë luftëtarësh, që angazhoi në luftë 15 divizione italiane gjermane dhe u shkaktoi atyre mijëra të vrarë, të plagosur dhe dëme të shumta materiale.

Populli kryengritës shqiptar dërgoi edhe përtej kufijve shtetërorë përmbi 20 mijë luftëtarë të Ushtrisë së tij Nacionalçlirimtare, të cilët luftuan me vetëmohim për çlirimin e popujve të Jugosllavisë dhe të vëllezërve shqiptarë të Kosovës.

Luftën antifashiste botërore, sidomos Luftën patriotike të Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga Partia Bolshevike dhe J. V. Stalini, populli ynë e

ka vlerësuar dhe e vlerëson gjithnjë si një faktor të madh, të jashtëm për arritjen e fitores. Por ai nuk priti asnjëherë që fitoren t'ia sillnin aleatët anglo-sovjeto-amerikanë. Partia Komuniste ia kishte rrënjosur atij në mendje se liria nuk dhurohet, por fitohet me gjak e me sakrifica. «Çdo etapë e luftës sonë u shkrua me gjak, — shkruante shoku Enver Hoxha, në pragun e çlirimit të plotë të vendit, — çdo gur i pushtetit ushtarak e politik u vadit me gjak dhe ky pushtet. . . i ka themelet e forta, mbrohet nga gjokset e popullit, prandaj është i pavdekshëm dhe i pathyeshëm. Lufta jonë çlirimtare nxori popullin në krye dhe këtu e vetëm këtu qëndron arsyeja e fitores».

Duke zbatuar parimin revolucionar, sipas të cilit fatet e luftës dhe të së ardhmes së atdheut i vendos vetë populli, Partia Komuniste, Fronti Nacionalçlirimtar dhe Shtabi i ri Shqiptar i dalë nga zjarri i luftës çlirimtare nuk lejuan asnjë përzierje në punët e brendshme, politike, ushtarake dhe ekonomike të vendit. Zbatimi me guxim dhe me konsekuencë i këtij parimi bëri që të shkatërroheshin planet dhe orvatjet e qeverive angleze e amrikane për të mbajtur më këmbë rendin e vjetër çifligaro-borgjez dhe për të vendosur kontrollin e tyre imperialist në Shqipëri.

Me fitoren e madhe historike të 29 Nëntorit 1944, në Shqipëri mori fund jo vetëm sundimi i pushtuesve fashistë, por edhe sundimi politik i çifligarëve dhe i borgjezisë vendase, njëkohësisht edhe sundimi i çdo fuqie imperialiste. Me çlirimin e plotë të Atdheut në Shqipëri u vendos diktatura e proletariatit. Vendi hyri në rrugën e ndërtimit të një bote të re, botës së socializmit, ku do të zhdukej jo vëtëm prapambetja shekullore ekonomike e kulturore, por edhe shfrytëzimi i njeriut prej njeriut, ku do të krijohet një jetë e lumtur për popullin.

Përvoja e madhe revolucionare e Luftës Nacionalçlirimtare shërben si një armë e shëndoshë në duart e gjithë punonjësve shqiptarë për të ecur me vendosmëri dhe pa u ndalur në rrugën e zhvillimit të pandërprerë të revolucionit, për të zbuluar dhe shkatërruar planet dhe veprimtarinë armiqësore të imperialistëve amerikanë, të socialimperialistëve sovjetikë, të socialimperialistëve kinezë dhe të armiqve të tjerë imperialistë e revizionistë kundër atdheut tonë socialist, për të siguruar fitore të reja të mëdha ekonomike, shoqërore, politike, kulturore-arsimore dhe ideologjike në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

«Në vitin 1939, kur Evropa heshtte, bijtë e vendit tonë binin në fushën e nderit për një çështje të drejtë, që pak më vonë do të bëhej çështje e mbarë njerëzimit.

Fashistët italianë mund të na zaptonin, por kurrë s'do të na dërrmonin, ne e kishim kockën të regjur nga mjerimet, që kishin pllakosur vendin tonë shekuj me radhë».

ENVER HOXHA








«Duam armë për të mbrojtur atdheun», jehoi fuqishëm zëri i popuilit anembanë atdheut, në ato ditë të rënda të prillit të vitit 1939, kur gjakësori fashist përgatitej për të pushtuar Shqipërinë.

Java e parë e prillit të vitit 1939 ishte java e demonstratave të fuqishme të masave popullore, ku u shfaq me forcë të madhe patriotizmi dhe gatishmëria për të mbrojtur atdheun.

Komunistët shqiptarë u bënë organizuesit e këtyre demonstratave.





7 prill 1939. Për popullin shqiptar nis një nga periudhat më të rënda të historisë së tij. Italia fashiste sulmon Shqipërinë me forca të mëdha ushtarake dhe e pushton. Populli shqiptar, i tradhtuar nga mbreti dhe regjimi i tij feudalo-borgjez, i paarmatosur dhe i paorganizuar, pa ndihmë dhe përkrahje nga jashtë, ndonëse i gatshëm për të bërë çdo sakrificë për mbrojtjen e atdheut, nuk ishte në gjendje të ndalojë agresionin dhe pushtimin e vendit.

Qindra aeroplanë, qindra luftanije bënin zjarr nga qielli dhe nga deti, dhjetëra mijëra ushtarë italianë shkelën tokën shqiptare. Ushtria shqiptare, e braktisur nga Komanda e saj e Përgjithshme dhe nga oficerët, shumica e të cilëve ishin agjentë të fashizmit italian, u shpërnda. Vetëm grupe të veçanta ushtarësh patriotë, së bashku me shumë patriotë të tjerë të vendit, i qëndruan me trimëri agresionit. Në Durrës, në Sarandë, në Shëngjin, në Vlorë agresorët u pritën me pushkë. Qindra armiq ngelën të vrarë nga plumbat e patriotëve.







Mujo Ulqinaku, Hero i Popullit, organizoi në Durrës qëndresën më të fortë kundër agresorëve. Më 7 prill ai ra duke luftuar me trimëri dhe u bë kështu simbol i qëndresës popullore kundër agresionit fashist italian.




Ura e Baçallëkut (mbi Drin) në Shkodër e hedhur në erë nga patriotët shqiptarë.




Makina ushtarake italiane u shtri në të gjitha anët e vendit. Shqipëria u shndërrua në një kamp të vërtetë ushtarak; kudo ndihej atmosfera e luftës, që përzihej me atmosferën e shtypjes së egër kombëtare dhe e bënte jetën e popullit shqiptar të padurueshme.

Divizionet italiane zbarkuan njëri pas tjetrit në tokën shqiptare, duke shtypur me hekur dhe zjarr qëndresën e popullit shqiptar. Në Shqipëri hynë dhe u vendosën 100.000 ushtarë italianë.










Regjimi pushtues fashist qëndronte në këmbë vetëm me forcën e armëve.





Humbja e lirisë dhe e pavarësisë kombëtare preku thellë ndjenjat tradicionale të atdhedashurisë së flaktë dhe të krenarisë kombëtare të popullit shqiptar. Ligjet fashiste krijuan në gjithë vendin një atmosferë terrori e pasigurie. Urrejtja për pushtuesit erdhi gjithnjë duke u rritur. Kjo urrejtje u shpreh në forma të ndryshme, duke marrë trajtën e një qëndrese të madhe popullore.

Komunistët qenë frymëzuesit, organizatorët dhe udhëheqësit e demonstratave të mëdha antifashiste, që shpërthyen në mjaft qytete të Shqipërisë me rastin e 28 Nëntorit 1939. Në demonstrata jehoi fuqishëm zëri i popullit: «Rroftë Shqipëria e lirëU, «Ja vdekje, ja liri!»






«Fill të vetëm para një armiku të pamëshirshëm, ne kemi mbajtur lart ballin në furtunë, ne i shpallëm armikut luftë të ashpër dhe të paprerë».

ENVER HOXHA



Enver Hoxha, luftëtar dhe organizator i palodhur për bashkimin e lëvizjes komuniste shqiptare dhe organizimin e Luftës Antifashiste të popullit shqiptar. Në këtë luftë ai u shqua si udhëheqës i revolucionit popullor.




Me vendim të Grupit Komunist të Korçës, Enver Hoxha u dërgua në Tiranë, ku ngriti degën e Grupit të Korçës. Shoku Enver nga Tirana krijoi lidhje me komunistë të grupeve të ndryshme dhe me nacionalistë patriotë.

Dega e Tiranës u bë qendra më e rëndësishme e lëvizjes komuniste dhe antifashiste në Shqipëri.



Dyqani «Flora» në Tiranë, qendër e veprimtarisë revolucionare dhe antifashiste të shokut Enver Hoxha.



Populli i Korçës shpreh solidaritetin e tij me popullin grek dhe hedh poshtë pretendimet e qarqeve shoviniste greke për copëtimin e Shqipërisë.

Më 28 tetor 1940 ushtria italiane sulmoi Greqinë nga toka shqiptare e pushtuar.

Populli shqiptar i robëruar nuk dëshironte që popujt e tjerë të kishin fatin e tij të keq. Prandaj ngriti zërin e tij kundër këtij agresioni të ri fashist duke marrë anën e popullit grek në luftën e tij të drejtë për mbrojtjen e atdheut të vet.

Populli shqiptar e mbështeti me të gjitha forcat luftën e popullit grek kundër agresionit italian, goditi vijat e komunikacionit të ushtrisë italiane dhe nuk lejoi që të përdorej prej fashizmit si mish për top kundër popullit grek.



Luftëtarë të Çetës së parë partizane të Pezës.



«Tokimi i parë» — G. Modhi

Më 28 qershor 1941 shoku Enver Hoxha u takua në afërsi të Pezës së Vogël me Mysl im Pezën dhe luftëtarët e udhëhequr prej tij. Sipas vendimit që u mor në këtë takim, në Çetën e Pezës shkuan një numër komunistësh ilegalë. Komisari i parë politik i çetës së Pezës u caktua Vasil Shanto, Hero i Popullit.

Kjo shënoi fillimin e një faze të re në lëvizjen antifashiste. Lufta e armatosur po merrte trajtë të organizuar, në të cilën komunistët do të luanin një rol drejtues.

Me hyrjen e komunistëve në Çetën e Pezës ajo u shndërrua në çetë partizane dhe zona e Pezës mori një rëndësi të veçantë. Peza u shndërrua në një bazë të rëndësishme për zhvillimin e luftës ilegale në kryeqytet, duke e vënë armikun e përqendruar në Tiranë, në një unazë të zjarrtë.

«Në këto rrepe, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — u takova me Myslim Pezën dhe shokët e tij, ramë dakord e vendosëm luftë kundër okupatorit dhe tradhitarëve të atdheut».



"Vasil Laçi." Reliev - Th. Thomaj



Vasil Laçi. Hero i Popullit.



Atentati i guximshëm i punëtorit Vasil Laçi në maj të vitit 1941, në Tiranë, kundër Viktor Emanuelit ishte shprehje e urretjes së thellë të popullit shqiptar ndaj armiqve fashistë, e vendosmërisë së tij të patundur për t'u ngritur në luftën çlirimtare.



Demonstratat historike të 28 tetorit në Tiranë dhe të 8 nëntorit 1941 në Korçë qenë një fitore e madhe në rrugën e bashkimit të komunistëve në një parti të vetme. Ato përbënin një kushtrim të vërtetë, një prelud të furtunës revolucionare, që do të fshinte nga toka shqiptare fashizmin italian.

Enver Hoxha, udhëheqës i demonstratës së 28 tetorit në Tiranë dhe organizator i bashkimit të grupeve komuniste në një parti të vetme.



Demonstrata e 28 tetorit 1941 në Tiranë.



Koçi Bako — P. Mele



Koçi Bako, komunisti i parë shqiptar rënë dëshmor në demonstratën e 8 nëntorit 1941 në Korçë. Hero i Popullit.



Demonstrata e 8 nëntorit 1941 në Korçë.

«Partinë Komuniste Shqiptare e krijuan komunistët shqiptarë, ajo lindi si rezultat dhe si kurorëzim i luftës së deriatëhershme të klasës punëtore të vendit tonë, i lëvizjes çlirimtare dhe i përpjekjeve të tërë popullit shqiptar».

ENVER HOXHA





Enver Hoxha, themelues dhe udhëheqës i Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Krijimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë, vënia e saj në krye të popullit kryengritës dhe të luftës së tij çlirimtare ishte kthesë rrënjësore në fatet historike të Shqipërisë. Ajo i dha atij një program të qartë veprimi dhe i tregoi rrugën e vetme të drejtë për ta vënë atë në jetë.

Partia Komuniste e Shqipërisë, me urtësinë dhe largpamjen e saj, me veprën e saj të pavdekshme, u bë nderi, lavdia dhe krenaria e gjithë popullit shqiptar.



Dhoma ku u zhvillua mbledhja e grupeve komuniste.




Shtëpia ku u themelua PKSH në Tiranë.




«U themelua Partia» Sh. Hysa

THEMELIMI DHE ORGANIZIMI I P K TE SHQIPERISE (8.XI. 1941)



Faksimile e Rezolucionit të mbledhjes së grupeve kryesore komuniste të Shqipërisë. Nëntor 1941.



REZOLUCIONI I MBLEDHJES SË GRUPEVE KRYESORE KOMUNISTE TË SHQIPËRISË PËR KRIJIMIN E PARTISË

Nëntor 1941

REZOLUCION

Në mbledhjen e parë të grupeve kryesore komuniste të Shqipërisë, është përfunduar në këtë rezolucion:

I. Situata politike

Kemi hyrë në vitin e tretë të luftës imperialiste, e cila është shndërruar në luftë të përbotshme dhe ka përfshirë të gjitha kontinentet dhe të gjitha vendet kryesore të botës. Qysh prej shumë kohësh komunistët kanë sinjalizuar dhe kanë treguar rrezikun që kërcënon njerëzimin prej kësaj lufte të tmerrshme dhe të përgjakshme që në fakt është vazhdimi i kasaphanës së parë të përbotshme

VI. Detyrat politike

Partia duhet të zgjerojë punën ndër masat e gjera punonjëse të Shqipërisë dhe të zgjerojë e të forcojë edhe më fort punën e saj me lëvizjen nacional-çlirimtare nga poshtë dhe nga lart. Të mbjellim idenë për një kryengritje të përgjithshme çlirimtare të popullit nëpërmjet aksioneve të përbashkëta.

Duhet:

1) Të krijohet dhe të zgjerohet njësia luftarake në mes të masave punonjëse të qytetit e të fshatit.

2) Të luftohet për pavarësinë kombëtare të popullit shqiptar dhe për qeverinë popullore demokratike, në një Shqipëri të lirë prej fashizmit.

3) Duhet të zhvillohet dashuria për Bashkimin Sovjetik, duke popullarizuar realizimet e popujve sovjetikë dhe rolin e pararojës të URSS-it në luftën çlirimtare kundër fashizmit.

4) Nëpër aksione (sabotazhe), greva, demostrata etj. të pregatitim politikisht e ushtarakisht popullin drejt kryengritjes së përgjithshme me armë, duke përmbledhur në luftë të gjitha fuqitë patriotike dhe antifashiste. E me gjithë këto nuk duhet të harrojmë rrezikun e influencës së nazizmit. Të demaskojmë qeverinë e tradhëtarit Kruja , manevrat e saja për të përçarë frontin nacional-çlirimtar të popullit shqiptar, duke paraqitur si rrezik për Shqipërinë luftën çlirimtare të popujve fqinjë, jugosllavë dhe

lufta kundër fashizmit. Të luftojërçarë popullin shqiptar me anë të fetare.

dhe bashkëpunimin luftarak me domos me popujt serb, grek, maë heroikisht për çlirimin e vet

së popullit punëtor shqiptar — si dhe për brezin tonë të ri luf-


r këto detyra, Partia jonë mundet masat popullore dhe të vërë ar-

ngur luftën popullore prej udhës së drejtë, prej udhës së luftës kundër fashizmit.

Çdo anëtar i Partisë duhet të jetë koshient dhe ta kuptojë këtë situatë serioze dhe fatprurëse, të punojë pa pushim për të arritur në këtë rezultat.

Kështu dhe vetëm kështu do të mund të luajmë rolin e pararojës në luftën për liri të popullit të robëruar dhe të mjeruar për çlirimin kombëtar.

KOMITETI CENTRAL
I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE



THIRRJA E PARË E KQ TË PKSH DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR PAS KRIJIMIT TË PARTISË

Nëntor 1941

POPULL SHQIPTAR!

Fashizmi gjerman bashkë me hyzmeqarët e tij të vendeve të tjera, Musolini, Manerheimi, Antonesku e të tjerë fashistë tradhëtarë të popullit të vet, i pangopur me gjakderdhjet që ka shkaktuar në kurriz të popujve të shtypur e të robëruar me qëllim që të majmet me djersën e tyre dhe me pasuritë e vendeve të zaptuara, po vazhdon me shpirt ndër dhëmbë luftën.

PUNËTORË, KATUNDARË, QYTETARË, USHTARË, XHANDARË, NËNOFICERË DHE OFICERË SHQIPTARË!

Lufta e sotme grabitëse të cilën popujt e Gjermanisë dhe të Italisë nuk e kanë dashur aspak dhe që nuk bën tjetër veçse i shton vuajtjet e tyre e tonat dhe ato të popujve të tjerë, po jep

fashizmit i kanë ardhur ditët e fundit. parashikuar vdekjen e tij të sigurtë, po e të burgimesh, rrahjesh, vrasjesh e interumbjet kolosale që shkon duke pësuar , i pazoti t'i bëjë ballë rrymës së madhe në vendin e tij dhe ndër ne, fashizmi që dhe xhandarë shqiptarë për ta vënë arin, për të na pasur xhelatë të mirë luftojnë për çlirimin e tyre kombë- dobësisë së fashizmit është shpër- rta dhe e premtimeve për të ashtu-

nuk duhet të rrimë me duar kryq. jithë shqiptarëve të ndershëm që e të bashkojmë të gjitha forcat tona onë për çlirimin kombëtar. Lufta undrejt zaptuesit. Çdo bir i këtij onal-çlirimtare. Për ta mposhtur e organizuar, e bashkuar dhe e tarë duhet të rrokin armët dhe uftojnë për vatrat tona. Lufta e ke e vullnetit të popullit shqipshiste dhe për të rrojtur i lirë.

ISTË SHQIPTARË!

e popullit shqiptar ju vë detyra të vënë në provën e zjarrit besnikërinë aj revolucionare, aftësinë tuaj organrë përherë më të fuqishme radhët kurdoherë në ballë të Luftës nacioin shqiptar. Organizoni luftën çlist. Lidhuni përherë më tepër me të vendit tonë. Kryeni detyrën që Eksperienca revolucionare e deriuftën e sotme. Që të jeni të denjë ka vënë në ju, vazhdoni traditën talinit, duke dhënë shembullin e ficës, të inisiativës dhe të organin kombëtar. Të jeni përherë në ku më i madh të jetë rreziku. nga zgjedha e fashizmit italian të ndershëm kontributin e tyre. shtë kësaj lufte.

PËR ÇLIRIMIN KOMBËTAR KUNDËR ZAPTUESIT FASHIST!

Rroftë bashkimi i popullit shqiptar në Luftën nacional-çlirimtare!

Rroftë bashkimi i popujve ballkanikë në luftën kundër fashizmit!

Rroftë kujtimi i dëshmorëve të popullit shqiptar të rënë në Luftën nacional-çlirimtare!

Rroftë Unioni Sovjetik, pararojë e luftës kundër fashizmit!

Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!

KOMITETI QENDROR
I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

Faksimile e Thirrjes së Parë të KQ të PKSH.

KUADRO DREJTUES TË PKSH, ORGANIZATORË TË LËVIZJES ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE (VITI 1942).





Nën udhëheqjen e KQ të Përkohshëm me shokun Enver Hoxha në krye, Partia Komuniste iu përvesh menjëherë punës, duke hedhur në veprim të gjithë anëtarët e simpatizantët e saj. Anëtarët e KQ u shpërndanë në të gjitha anët e vendit për të organizuar Partinë, për të shpjeguar vijën politike të saj, për të mobilizuar komunistët në zbatimin e kësaj vije. Për drejtimin e punës së Partisë e të luftës çlirimtare në qytete e në qarqe u krijuan Komitetet Qarkore të Partisë në Tiranë, në Korçë, në Shkodër, në Vlorë, në Gjirokastër, në Elbasan, në Durrës.

Në zjarrin e luftës çlirimtare u përgatitën organizatorë të shquar komunistë si Qemal Stafa, Nako Spiru, Hysni Kapo, Vasil Shanto, Mehmet Shehu, Pilo Peristeri, Kozma Nushi, Gogo Nushi, Petro Papi, Myzafer Asqeriu.




















«Trakti i Parë» Sh. Hysa

Rinia Komuniste Shqiptare, e krijuar në Tiranë më 23 nëntor 1941, u bë ndihmësja më besnike e Partisë për edukimin e masave të gjera të rinisë shqiptare me frymën e patriotizmit luftarak dhe me idetë komuniste, për mobilizimin e tyre në luftën antifashiste.

Rininë Komuniste e udhëhiqte drejtpërdrejt Partia Komuniste nëpërmjet direktivave dhe nëpërmjet anëtarëve të Partisë të ngarkuar me punën me rininë në të gjitha hallkat e ndërtimit të Partisë dhe të Rinisë Komuniste. Për drejtimin e Rinisë Komuniste, Komiteti Qendror i Partisë kishte ngarkuar kuadrot më të mirë të Partisë si shokët Qemal Stafa, Nako Spiru, Nexhmije Xhuglini, Misto Mame, Tasi Mitrushi, të zgjedhur anëtarë të KQ të RKSH.



Qemal Stafa, Sekretar Politik i KQ të Rinisë Komuniste Shqiptare. Hero i Popullit





Shtëpia në Tiranë, ku u themelua Rinia Komuniste Shqiptare.

Komitetit Qendror të Partisë
të Rinis Komuniste Shqiptare

e dashur dhe inkurajuese i ariu
K. q. P të partis komuniste Shqiptare, përshëndet
e zjarrtë shoqrore e K q. P. të Rinis Komuniste
Shqiptare në këtë kohë të vështirë të organizmit, e partis tonë, të rinis komuniste, dhe
të luftës çlirimtare kundra zgjedhës
fashiste

Partija ushqen shpresat më të
mëdha se Rinija Komuniste Shqiptare
do të jetë e deje për kësinia që ka qenë
më të partija e jonë era, dhe se do të
dijë të kujtojë revolucionarisht detyrën e
lartë që i është ngarkuar tue u frymezue
nga shembulli heroik i Rinis komuniste
sovietike me ujdi të afërtë, mall-
tesh dhe gjerash në partin të
organizoje dhe të udhëhegë revolucionarisht
rinin Shqiptare të shllaverisur, drejt
të ardhmes të ndritun, drejt çlirimit
nga zinxhirat mejetare të shllavërisë
fashiste dhe drejt një jete të re
të përparimit, të kulturës dhe të gëzimit

Rroftë Rinija Komuniste
Shqiptare -


Komiteti Qendror Provizor
i Partis Komuniste Shqiptare.


Foksimile e Letrës drejtuar KQ të Rinisë Komuniste Shqiptare nga KQ i PKSH, shkruar nga shoku Enver Hoxha.




Qemal Stafa u vra në Tiranë më 5 maj 1942, duke luftuar me heroizëm kundër qindra karabinierëve dhe milicëve fashistë.

Hamid Shijaku ishte komunisti i parë që u var nga xhelatët fashistë. Fjalët e tij të fundit para trekëmbëshit ishin: «Rroftë Komunizmi»!








Njësitet guerile qenë shkollë e parë e kryengritjes së armatosur. Nën udhëheqjen e Partisë, ato u ngritën në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë. Njësitet guerile, me aksionet e tyre, i kallnin tmerrin armikut.

Aksioni kombëtar i shkatërrimit të ndërlidhjes telegrafonike i 24 korrikut 1942, një nga veprimet më të guximshme dhe më të rëndësishme të luftëtarëve të lirisë.



DIREKTIVA TË KQ TË PKSH NË LIDHJE ME KRIJIMIN E FRONTIT NACIONAL-ÇLIRIMTAR, KRIJIMIN E KËSHILLAVE NACIONAL-ÇLIRIMTARE, ORGANIZIMIN E GUERRILEVE DHE TË ÇETAVE PARTIZANE, FORCIMIN E PUNËS ORGANIZATIVE TË PARTISË

Qershor 1942


Të dashur shokë,

Duke marrë parasysh situatën politike në të cilën ndodhemi, Komiteti Qendror po u dërgon gjithë qarkorëve e përgjegjësve të celulave, të cilët t'ua njoftojnë anëtarëve të celulave, direktivat e poshtëshënuara, që duhet të zbatohen përpikërisht prej të gjitha organizatave të Partisë.

Përpara organizatave tona të Partisë parashtrohen këto detyra në lidhje me zhvillimin e ngjarjeve politike si në Shqipëri, në Ballkan ashtu edhe në krejt botën. Këto detyra përcaktohen nga faktet që vijojnë:


Faksimile e «Direktivave të KQ të PKSH në lidhje me krijimin e Frontit Nacionalçlirimtar, këshillave nacionalçlirimtare, organizimin e njësiteve guerile dhe të çetave partizane, forcimin e punës organizative të Partisë» (qershor 1942).

Në radhët e njësiteve guerile, Partia caktoi luftëtarë me vullnet të çeliktë, që e kishin në zemër Partinë dhe komunizmin, të cilët nuk e përfillnin vdekjen për lirinë e atdheut. Heronjtë e Popullit Kajo Karafili, Vojo Kushi, Perlat Rexhepi, Misto Mame, Mihal Duri, Xhoxhi Martini, Sadik Staveleci, Branko Kadia, Nazmi Rushiti, Shyqri Ishmi, Maliq Muço, Zaho Koka, Myslym Keta, Shyqri Alimerko.





«Komunistët nuk dorëzohen» - K. Nini



Më 22 qershor 1942 Perlat Rexhepi, anëtar i Komitetit të Partisë për qarkun e Shkodrës dhe komunistët Branko Kadia dhe Jordan Misja kryen një akt të lartë heroizmi. Të rrethuar nga disa qindra armiq, në një shtëpi në qytetin e Shkodrës, luftuan për orë të tëra, derisa dhanë jetën.

Shtëpia, ku u zhvillua qëndresa heroike e Perlat Rexhepit me shokë, disa orë pas kësaj qëndrese.



Grupe luftëtarësh të njësiteve dhe çetave të para partizane.
Shoku Enver Hoxfta midis partizanëve të Çetës së Bërzeshtës.



Në fillim të vitit 1942, KQ i PKSH dha udhëzime që të merreshin masa për organizimin e **çetave partizane,** si formacione bazë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në këtë etapë të kryengritjes së armatosur. Përveç Çetës së Pezës, në mars-prill 1942, u krijuan: Çeta e Kurveleshit, Çeta e Skraparit, Çeta e Gorës; në qershor: Çeta e Dibrës, Çeta e Shkodrës, Çeta e Mokrës; në korrik: Çeta e Moravës (Devollit), Çeta e Matit; në gusht: Çeta e Çermenikës. Njësite të tjera partizane, që u shndërruan pak më vonë në çeta, në këtë kohë nga më kryesoret ishin: Njësiti i Vlorës, Njësiti i Mokrës, Njësiti i Kolonjës, Njësiti i Martaneshit, Njësiti i Malësisë së Gjakovës, Njësiti i Mallakastrës etj.

KOMANDANTË ÇETASH PARTIZANE. HERONJ TË POPULLIT.



HAXHI LLESHI



TEKI KOLANECI




RESHIT ÇOLLAKU





Crupe luftëtarësh të njësiteve dhe çetave të para partizane.

Disfata e fashistëve italianë në Skrapar, në shtator të vitit 1942, është një nga fitoret më të bujshme të forcave partizane në vitin 1942. «Populli i Skraparit dhe i gjithë Shqipërisë, - shkruante për këtë ngjarje «Zëri i popullit», — e mori vesh ku qëndron e vërteta, ai e pa me sytë e tij, e dëgjoi me veshët e tij se cilët janë partizanët e lirisë, cilët janë komunistët dhe patriotët e vërtetë. Ai e kuptoi cilët luftojnë dhe vdesin për liri».











Grupe luftëtarësh të njësiteve dhe çetave të para partizane.



ZËRI I POPULLIT

(ORGANI I LUFTËS NACIONAL-ÇLIRIMTARE)

VITI I, 1942 GUSHT 1942 Nr.1

ZËRI I POPULLIT

Ka një mision të rëndësishëm historik Zëri i Popullit, organi qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë. Ai do të bëhet, pa asnjë dyshim, një nga armët më të fuqishme në luftën tonë për çlirimin kombëtar dhe shoqëror. Zëri i Popullit ka ardhur në kohën më të vështirë të historisë së popullit shqiptar. Populli shqiptar po luftonte dhe po derdhte gjakun e bijve të tij më të mirë kundër pushtuesve fashistë, por ai nuk kishte ende një udhëheqje të vërtetë, një organizim të fortë, që t'i bashkonte të gjitha forcat e tij në një front të vetëm, në një front kombëtar, që t'i drejtonte ato me siguri e me vendosmëri në luftën e madhe për çlirimin e Atdheut. Populli shqiptar nuk e kishte ende të qartë se cilët ishin armiqtë kryesorë, kundër të cilëve duhej të përqendronte të gjithë forcat e tij, se cilët ishin miqtë e tij më të afërt, me të cilët duhej të bashkohej, se cilët ishin rrugët dhe mënyrat e luftës për t'i shpëtuar Atdheut nga rreziku i madh që i kanoste. Populli shqiptar kishte nevojë për një udhëheqje të tillë, sepse pa të ai nuk mund të ngrihej në luftë të organizuar kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

ZËRI I POPULLIT

ORGAN I LUFTËS KOMBËTARE SHQIPTARE

VITI II — PRILL 1943 — Nr.27

7 PRILL, DITA E ZIEJ DHE DITA E LUFTËS

7 Prill 1939 - 7 Prill 1943, pikë

4 vjetët e rrobërisë nën armikun e tmerrshëm e shekullor, nën kuqërinën fashiste të Ijer

ZËRI I POPULLIT

Organ i Par

RONTI SOV

Çeshtje të Di

Interesi i nalt i kombit.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

ZERI I POPULLIT

(ORGAN I PARTIS KOMUNISTE SHQIPT.RE.)

VITI I-rë — Nëndor 1941 — Nr. 5-6

POPULLI I TIR.NË HEROI ADHTHIN E HEROIT TË POPULLIT

FOLO TUDRIT

(Nëntë dëshmor më 8 Nëntor 1941)

Populli krenohet i Tiranës,
ty çë nëmrit t'u dhanë jetën e
e Qetorit, kur shkriti dhe te-

HISTO KAH, PARLAT KAHAPI e
VASO KADIJA, HAKOLLA TOPA
e HAKI MËMELI, BRAHEO KA-

ZERI I POPULLIT

ORGAN I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

VITI II — Prill 1943 — Nr.21

MARE NGA MINISTRIA E ARMËVE NE AKUIONIN E ÇREKJE NE QERSHOR 1943 - U DERGUA NE KATUNDIN ISLAMI NJË DO MAKINE E TEKNIKA E TIRANES QË FUNKSIONONIN PAK KOHE. U LIEJ PREJ PUSHIMEVE TE KRAHINES


Trathtarët e shpetuan për këtë radhë ikurën e tyre. Por shpata e drejtësisë nuk do të mbetet pa rënë së shpejti mbi ta.



Shtëpia e Sefer dhe Emine Shijakut në Tiranë, ku u shtyp numri i parë i «Zërit të popullit».




Athina Nushi, Bije Vokshi, Ije Farka, Emine Keta, Adivije Agolli, Silla Duri, nëna patriote në bazat e Komitetit Qendror të Partisë në Tiranë.



Shtëpia e Emine Ketës, një nga bazat ilegale më të rëndësishme të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Tiranë.


Bazat ilegale në shtëpitë e qytetarëve të varfër ishin çerdhe e pjesëtarëve të guerileve, të anëtarëve të Komitetit Qendror dhe të komiteteve qarkore të Partisë. Aty thureshin planet e aksioneve, aty strehoheshin të sigurt pjesëmarrësit e këtyre aksioneve. Anëtarët e familjeve, ku ishin këto baza, jepnin një kontribut të drejtpërdrejtë në luftën me armë kundër armikut dhe përballonin një rrezik të madh sa edhe pjesëtarët e guerileve. Kontribut të veçantë jepnin nënat trime e patriote, që me aq dashuri i prisnin dhe i përcillnin ilegalët, i ushqenin dhe i përkujdesnin me dhembshuri prindërore, u bënin roje natë e ditë, i ndërlidhnin me shokët e tyre, me udhëheqësit e Partisë e të luftës çlirimtare.





Shoku Enver Hoxha, për të kryer detyrat si organizator dhe luftëtar revolucionar, detyrohej të përdorte letërnjoftim fals, të ndryshonte pamjen e jashtme, duke u paraqitur herë si elektricist, herë si marangoz, herë si murator, herë si nëpunës, duke zbatuar gjithnjë me rreptësi kërkesat e konspiracionit.





KUESTURA MBRETNORE E TIRANËS

Nr. 2276 Gab. Tiranë, më 25-6-1943/XXI/

LAJDA: Enver Hoxha i Korçës dhe i Gjirokastër lindur në Gjinokaster - 1918 -

Komunist, -

KUESTURAVE MBRETNORE:

Gjirokastër - Berat - Dibër - Durrës - Elbasan - Peqë - Korrçë - Prishtinë - Prizren - Shkodër - Vlonë -
Komandës Kompanisë Mbrendëshme të Gjindarmerisë Mbret.
Komandës Kompanisë Jashtëme të Gjindarmerisë Mbretnore
Skuadrës Politike të Kuesturës Mbretnore - Tiranë
Skuadrës Gjyqësore të Kuesturës Mbretnore - Tiranë
e për nj. Drejtorisë së P.të Policisë - Tiranë

Ne përgjegjen e Qarkoreve të kalueme të kësaj Zyre dhe me lutje qi të dendësohen shërbimet dhe hetimet për gjetjen e rreshtimin e të sipërshkruemit komunist'i rrezikshem, njoftoj se ky asht i goditur me urdhën rreshtimi të datës 16 të k.m. Nr. 990/43 i lëshuem nga Prokurorija e Përgjithëshme e Gjyqit Posaçem të Shtetit, pse i denuem me vendimin 20/5/1943/XXI/ me vdekje.

KUESTORI
(f.Papalil)

1933
12/8/43

Con riferimento alle precedenti circolari di quest. Ufficio e con preghiera di voler intensificare i servizi e le indagini per il rintraccio e l'arresto del sopranscritto comunista pericoloso, comunico che quest è colpito da ordine di arresto in data 16 corrente nr. 990/43 emesso dalla Procura Generale del Tribunale Speciale dello Stato condannato con sentenza 20/5/u.s. alla pena di morte.


Il Questore
(f/to P.Papalil)



Faksimile të dokumenteve të armikut. për gjetjen dhe arrestimin e «komunistit të rrezikshëm» Enver Hoxha.


Gogo Nushi, Pilo Peristeri e Vasil Shanto, të veshur si fshatarë për të maskuar veprimtarinë e tyre ilegale.








Konferenca e Pezës, që u mbajt më 16 shtator 1942, vuri themelet politike dhe organizative të bashkimit të popullit shqiptar në Frontin e përbashkët Nacionalçlirimtar, hodhi themelet e pushtetit popullor revolucionar.





ENVER HOXHA ME MYSLIM PEZËN.






Pamje e jashtme dhe e brendshme e shtëpisë, ku u mbajt Konferenca e Pezës.




ENVER HOXHA,
frymëzues dhe organizues
i Konferencës së Pezës.












MYSLIM PEZA, HAXHI LLESHI, MUSTAFA XHANI, NEXHMIJE XHUGLINI, NAKO SPIRU,

pjesëmarrës në Konferencë.



REZOLUCIONI I KONFERENCËS NACIONAL-ÇLIRIMTARE TË PEZËS

16 Shtator 1942

REZOLUCION I KONFERENCËS PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLIT TE PËRGJITHSHËM NACIONAL-CLIRIMTAR

Delegatët, të ardhur nga të gjithë anët e Shqipërisë, përfaqësuesit e gjithë tendencave të nacionalizmit shqiptar, të Partisë Komuniste Shqiptare, të rinisë nacionaliste, të rinisë komuniste dhe të rinisë femnore popullore shqiptare, të udhëhequr nga qëllimi i shenjtë për çlirimin e Shqipërisë nga thundra e Italisë fashiste dhe nga tradhëtarët e shitur tek i huaji, pasi përkujtuan dëshmorët e rënë në luftë kundër fashizmit, pasi shqyrtuan mirë gjendjen shqiptare dhe veçanërisht pasi theksuan dëshirën dhe nevojën për organizimin e gjithë energjive shqiptare për bashkim të plotë të tyre në Luftën Nacional-Çlirimtare, arritën në këto përfundime:

Kudo, në të katër anët e Shqipërisë, po bucet kushtrimi i lirisë, populli ka marrë armët në dorë dhe me flamurin e Skënderbeut po luftan me tërbim okupatorin dhe veglat e tia tradhëtare... Në qytete e në katunde të Shqipërisë me dyzina sabotazhe e aksione po kryhen nga njësitë guerile partizane. Në këtë luftë populli shqiptar ka dhënë dëshmorë: grushti i fashizmit po godit e ka goditur me rreptësi të gjithë ata, qofshin nacionalistë ose komunistë, që luftojnë me vepra zaptuesin dhe tradhëtarët. Në luftën kundër okupatorit janë hedhur e do të hidhen bazat e vërteta të bashkimit kombëtar, bazat e vërteta të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare.

Nga gjithë kjo pasqyrë e gjendjes ndërkombëtare dhe gjendjes së brendëshme të atdheut tonë, pas diskutimesh dhe rrahje mendimesh, delegatët e kësaj konference çfaqën dëshirën dhe vullnetin e vazhdimit të luftës së popullit shqiptar kundër okupatorit; në konferencë është pranuar që çetat partizane, që luftojnë me flamurin e Skënderbeut, të mbajnë si shenjë dalluese shenjën partizane, flamurin kuq e zi me yllin e kuq, dhe çetat vullnetare si shenjë dalluese flamurin kuq e zi; në konferencë, gjithashtu, delegatët çfaqën dëshirën dhe vullnetin e plotë për një organizim të shëndoshë të të gjithë shqiptarëve të vërtetë, pa dallim feje, krahine, klase dhe rryme politike dhe zgjodhën Këshillin e Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar (të përkohshëm). Kjo konferencë çfaqi dëshirën dhe ka bindje se Këshilli i zgjedhur do t'i plotësojë ashtu si e do momenti historik detyrat e veta.

...për të forcuar tendencën aktive të po... Mustafa Merli... fashizmi italian, ...popullit shqiptar, ...allonte Kongresin e ...e një shteti të li...

...u përpoq dhe po ...pjesë të nacionalmin mirë të shkuqi, filluan shtypjet, ...lat pregatisin armë ...mbajnë me ushqi...

...risa të formohet Shtabi Madhor, i cili do të merret me veprimet e tyre.

Konferenca dhe delegatët me unanimitet realizojnë bashkimin e vërtetë të pikëpamjeve të të gjitha tendencave politike në luftë kundër fashizmit. Ajo ka bindjen se këto pikëpamje sikundër edhe detyrat që u ngarkuan do të zbatohen pikë për pikë dhe si u ka hije bijve të Arbërit. Ajo ka bindje se rruga e lavdishme e stërgjyshërve tanë do të ndiqet me guxim dhe krenari dhe se me vetëmohim do të sakrifikohet edhe pika më e fundit e gjakut për realizimin e dëshirave të popullit tonë, të dëshmorëve tonë që ranë si luanë për lirinë e Shqipërisë; ajo ka bindje se do të punohet pa pushim për ta pregatitur popullin tonë gjatë luftës që do të zmadhohet dhe do të forcohet gjithmonë më tepër për një kryengritje të përgjithëshme.


POSHTË FASHIZMI DHE KLIKA TRADHËTARE!
RROFTË POPULLI SHQIPTAR!
RROFTË BASHKIMI I POPULLIT SHQIPTAR NË LUFTË KUNDËR OKUPATORIT!
RROFTË LUFTA PËR LIRINË E POPUJVE TË SHTYPUR!
RROFSHIN ALEATËT TANË TË MËDHENJ ANGLO-SOVJETO-AMERIKANË!
RROFTË KËSHILLI NACIONAL-ÇLIRIMTAR!
RROFTË SHQIPËRIA E LIRË, E PANDARËSHME, INDIPENDENTE DHE DEMOKRATIKE!

KËSHILLI I PËRKOHSHËM NACIONAL-ÇLIRIMTAR


...luftë kundër okupatorit. ...bën bashkimin e po...
Portat janë kurdoherë të hapta për të gjithë nacionalistët e vërtetë që janë të vendosur të luftojnë për çlirimin e atdheut.
Çetat duhet të ndihmojnë njëra tjetrën ndër aksione përde...

...Nedicit 10 që të shtypë më me zell Lëvizjen Nacio...

Faksimile e Rezolucionit të Konferencës Nacionalçlirimtare të Pezës.



«Përmendore kushtuar dëshmorëve të Pezës herolke».



THIRRJE E PARË E KËSHILLIT TË PËRKOHSHËM NACIONAL-ÇLIRIMTAR, DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR

Shtator 1942

POPULL SHQIPTAR!

Ndodhemi në pragun e fitores. Ushtritë e tripalshit — Gjermani, Japoni dhe Itali — po hanë grushtet e fundit, grushtet e vdekjes. Ushtria fashiste hasi përpara Ushtrisë së Kuqe si sha-

Popull shqiptar!

Më tepër se kurdoherë në historinë e Shqipërisë sonë, tot kemi nevojë për bashkimin kombëtar, për bashkimin e të gjitha forcave luftarake dhe morale të vendit tonë, për luftën kundër zaptuesit. Gjithë populli shqiptar pa dallim krahine, feje, rryme politike, duhet të bashkohet në Luftën Nacional-Çlirimtare. Vëllazërimi i tij duhet të bëhet jo me fjalë, por me gjak, se vetëm lufta kundër armikut e shenjtëron bashkimin.

S'duhet të ketë më shqiptarë që të bëjnë lodrën e armikut. Milicia dhe policia janë vegla për të shtypur popullin shqiptar,

...prandaj p... ...karabinat... ...ata milli... ...të gënjy... ...me luftë... ...nyrë osh... ...për t'i ç...

POPULL SHQIPTAR! ...

Duke ndjerë me zemër shqiptari këtë nevojë të madhe për bashkimin nacional-çlirimtar, duke qenë të bindur që bashkimi i vërtetë themelohet vetëm me luftën e armatosur, duke qenë të bindur që e drejta e lirisë e fitorja mund të vijë vetëm në të bindur që sot kundër armikut zaptues, (luftë që sot është ...duke luftuar që sot kundër armikut zaptues, (luftë që sot është ...

Rroftë bashkimi i popullit shqiptar dhe Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar!
Rroftë Lufta Nacional-Çlirimtare e popujve të robëruar!
Rroftë lufta e aleatëve tanë të mëdhenj, Amerikës, Bashkimit Sovjetik e Anglisë.
Rroftë Shqipëria e lirë demokratike, e pavarur!

Shtator 1942

KËSHILLI I PËRKOHSHËM NACIONAL-ÇLIRIMTAR


...krahinat dhe fshatrat K... ...të jenë organet e vërteta për luftën kundër ...
Poshtë zaptuesi fashist, poshtë tradhëtarët!
Poshtë Mustafa Kruja që e shpuri popullin shqiptar në luftën vëllavrasëse!
Rrofshin luftëtarët e lirisë, partizanët dhe vullnetarët që luftojnë heroikisht për popullin tonë!

Faksimile e Thirrjes së Parë të Këshillit të Përkohshëm Ndcionalçlirimtar të zgjedhur në Konferencën e Pezës.





Komunistët çojnë zërin e Konferencës së Pezës në masat e gjera të popullit.



Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në vitin 1942 mori një përhapje të gjerë në mbarë vendin. Në hartë: çetat partizane, veprimet e tyre, zonat e lira deri në fund të dhjetorit 1942. Në qytetet dhe zonat e paçliruara vepronin njësitet guerile dhe çetat partizane.


Deri në fund të vitit 1942, në qarqet e Gjirokastrës, Vlorës, Korçës e Beratit nuk kishte pothuaj asnjë fshat pa këshilla nacionalçlirimtare.

Në qarqet e Elbasanit, Tiranës, Durrësit, shumica e fshatrave gjithashtu kishin këshillin e vet. Këshillat nacionalçlirimtare qenë ngritur dhe në mjaft fshatra të qarqeve të Shkodrës, Dibrës e të Kukësit.

Në tetor 1942 u ngrit Këshilli i parë Nacionalçlirimtar në qytetin e Durrësit. Në të gjithë qytetet e tjera të vendit këshillat nacionalçlirimtare u organizuan në tremujorin e parë të vitit 1943. Përpara ngritjes së këshillave në qytete, ishin ngritur këshillat e lagjeve.



MUSTAFA MATOHITI



ZYLYFTAR VELESHNJA



RAMIZ ARANITASI



FUAT BABANI



XHELADIN BEQIRI



ASAF DRAGOTI

KOMANDANTË E KOMISARË ÇETASH PARTIZANE:

Konferenca e Pezës u pasua nga një forcim e zgjerim i mëtejshëm i luftës së armatosur partizane.

Radhët e partizanëve u rritën me të shpejtë. Deri në fund të vitit 1942 numri i partizanëve arriti rreth 2000 veta. 3-4 herë më shumë kishin çetat vullnetare territoriale të vetëmbrojtjes. Ndër çetat e reja, që u krijuan pas Konferencës së Pezës deri në shkurt të vitit 1943, ishin: Çeta e Kolonjës, Çeta e Martaneshit, Çeta e Oparit, çeta «Koto Hoxhi» (tetor), një çetë tjetër e Skraparit (nëntor), Çeta e Vlorës, Çeta e Kuçovës, çeta «Çerçiz Topulli», Çeta e Myzeqesë, Çeta e Dumresë, dy çeta të Kurveleshit, «Hajredin Tremishti» dhe «Avni Rustemi» (dhjetor), Çeta e Vithkuqit, Çeta e Dangëllisë, Çeta e Ostrovicës, çeta «Tomori», çeta «Kurora» (Opari), tri çeta të tjera të Gorës, Çeta e Leskovikut, një çetë tjetër e Mokrës, Çeta e Malit të Thatë, një çetë tjetër e Skraparit, Çeta e Bërzeshtës, çeta «Selam Musaj» dhe çeta «Verikoll» (Tepelenë), Çeta e Mallakastrës, Çeta e Lumës, Çeta e Pukë-Mirditës, çeta «Çamëria» (Konispol), Çeta e Sllovës,








Luftëtarë të çetave partizane të krijuara pas Konferencës së Pezës.





MBRETNIJA SHQIPTARE

KUESTURA MBRETNORE E FIRANËS

No. 6540. I Prot. Tiranë, më 22/X/1942.Viti XX

LËNDA: NDJEKTIM I TERRORISTIT SHYQYRI ISHMA.

DREJTORISË P. TË POLICISË

T I R A N Ë.

Sikundër asht lajmëruar dhe këtë mëngjez,n'ore 7.45, në sheshin e Pazarit të Ri,asht vepruar ndigjim' i të denuemit me vdekje,shpallun me d.j të vazhduesit prej Gjyqit Ushtarak të FF. AA.t'Unjisueme të Shqipnie,kunder terroristit SHYQYRI ISHMA, i të ndyervet malil e Nazes,lindun në Tivar me 1920,banues në Tiranë,elez triçist.-

I kthyem prej burgut në vendin e zbatimit,ka qenë fillue prej nji funksionari të Policisë,për të i ngarkuem prej Prokurorit të Shtetit,lexim' i ndigjesës së denimit dhe i Dekretit aprovues i ekzekutimit.Me të shpejtë SHYQYRI ISHMA, filloj me thanë me za të naltë se jam komunist,dhe jam pjestar' i Elmis Komunaite Shqiptare dhe nuk kam frigë nga vdekja, e qi e'fundi keni për t'i pague të gjitha.Me vdekjen t'eme rinija komuniste Shqiptare nuk do të marri fund dhe pa tjetër e sigurisht se kam me'kene i ngarrun. Mandej bërtitte "Krofte Shoku i Madh Stalini".-

Pue vazhdue leximin e ndigjesës dhe të Dekretit Shyqyriu filloj me i kputë fjalët funksionarit tue thanë: "Ç'fare ndigjese ! lene ndigjesën e drejtesia Fashiste ! poshtë fashizmi ! Njaft,tradhëtar,nuk nevojitet që të lexoni,epu fund.-

Ç'ka keni me më bamë ma tepër se me vdekë une nuk i frikohem vdekjes.Njaft,pse i kendoni ?Nuk po locheni.A ke si marrun vesht ? Rinija Shqiptare asht si bari i livadhit,si i kositun,len ma i gjallshëm .Ashtu asht pa dhe rinija Komuniste qi dita ditës rritet (shtohet)".

Porsa Hoxha u pregaditte për me e ngushlime me lutje,ai e shtyn tue i thanë:"shkoni hiquni prej këtu,nuk u due- Nuk asht Zoti qi më merr shpirtin,por Fashizmi.""

Në pyetjen që i bani Prefekti i Tiranes,tue i thanë në se kishte ndonji gja për me shprehë, i denuemi filloj me shqyptue shamije kundra fashizmit,Tue i përserit pyetjen,përgjigjet gjithnji negativisht.-

Mandej me nji herë u dha urenn'i varjes.

Mbas 7 minutesh njeriu konstatoj vdekjen e ti. Trupi i vdekun (kufoma) asht kenë e rrethuem deri n'orën 11.Ndn-shoqerimin e Ajutantavet të Policisë,ai asht Tren transportuem në Spitalë për formalitetet e rithmit-Myelinan (lam e kufomës)dhe mbasandej u dergue në varr me të shpejt që mundë me dhe.

Popullit qi [illegible] ishte mbledhun në sh shin e Pazarit të Ri,asht [illegible] të mbrapsane mungue Komentat e policimit të nenvit [illegible].


Vendimet e Konferencës së Pezës i dhanë forcë e gjallëri të madhe zjarrit të luftës revolucionare në të katër anët e vendit. Me terror dhe masakra çnjerëzore, pushtuesi fashist dhe tradhtarët u përpoqën të asgjësonin luftën çlirimtare të popullit shqiptar, të shkatërronin Frontin Nacionalçlirimtar dhe shtabin drejtues të luftës, Partinë Komuniste të Shqipërisë.



Me emrin e Partisë në gojë, me besimin e patundur në fitore, vdiq në trekëmbësh nga dora gjakatare e armiqve i riu komunist Shyqyri Ishmi, Hero i Popullit.

Edhe dy martirë, Kiço Greço e Midhi Kostahi, bënë fli jetën për çështjen e Panisë dhe të popullit.










Mine Peza, Heroinë e Popullit, vrarë nga fashistët italianë në demonstratën e grave antifashiste para burgut të Tiranës, në shtator të vitit 1942.



Të rinj antifashistë të burgosur.


Fshatra shqiptare në tym dhe në flakë.







Epopeja e Shkodrës u përsërit edhe në Vlorë natën e 18-19 tetorit 1942, kur katër të rinjtë komunistë vlonjatë Heronj të Popullit, Hajredin Bylyshi, Mumin Selami, Bajram Tusha e Hiqmet Buzi, luftuan me trimëri kundër aindra fashistëve italianë dhe tradhtarëve, derisa dhanë jetën.

LUFTIMET KRYESORE KUNDËR OKUPATORËVE FASHISTË ITALIANË







Aksioni i Voskopojës, në janar të vitit 1943, përbënte rastin e parë të veprimit sulmues të kombinuar të disa çetave partizane për asgjësimin e një garnizoni armik. Që nga janari 1943 Voskopoja e lirë u shndërrua në një bazë kryesore të reparteve partizane dhe të pushtetit popullor në qarkun e Korçës.




Për aksionin e Snosëm-Bulçarit (janar 1943), «Zëri i popuilit»: shkruante «Çetat partizane kanë korrur një nga sukseset më të bujshme, një fitore që u ka me të vërtetë hije luftëtarëve zemërluanë».



Aksioni i Patosit (shkurt 1943), që i shkaktoi armikut humbje të mëdha, përbën një faqe tjetër të lavdishme të forcave partizane. «Populli, — shkruante për këtë ngjarje «Zëri i popullit», — e priti me entuziazëm aksionin e Patosit, ky ka dëmtuar rëndë armikun».



Aksioni i Libohovës (shkurt 1943) solli çlirimin e qendrës së nënprefekturës, e cila ishte e treta qendër nënprefekture, pas Çorovodës dhe Gusmarit, që çlirohej nga thundra e pushtuesve.



Një tjetër aksion i madh luftarak, po në shkurt 1943, ishte dhe ai i Selenicës, që i shkaktoi armikut humbje shumë të mëdha.



«Vojo Kushi» S. Shijaku

Më 7 tetor 1942, brenda në Tiranë, trimi i trimave Vojo Kushi luftoi si luan, tok me shokët e tij Xhoxhi Martini e Sadik Staveleci, kundër qindra karabinierëve dhe milicëve fashistë, që i kishin rrethuar. Ai vdiq duke sulmuar tankun armik.

Lufta e koalicionit antifashist të popujve me Bashkimin Sovjetik në krye, ishte një mbështetje e fuqishme dhe një garanci e jashtme për fitoren e popullit kryengritës shqiptar të udhëhequr nga PKSH. «Të popullarizojmë luftën e drejtë që ndjekin Bashkimi Sovjetik, Anglia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës,- vinte detyrë Konsulta I e Aktivit të PKSH, në prill 1942. - Të lidhim sa më ngushtë Luftën tonë Nacionalçlirimtare me këtë luftë... Të popullarizojmë rolin e pararojës së URSS-it në këtë luftë çlirimtare».


Выступление по радио
Председателя Государственного Комитета Оборон
И. В. СТАЛИНА.
3 июля 1941 года.

«Qëllimi i kësaj lufte patriotike të mbarë popullit kundër skllavëruesve fashistë nuk është vetëm për të zhdukur rrezikun, që kanos vendin tonë, por edhe të ndihmojë gjithë popujt e Evropës që lëngojnë nën thundrën e fashizmit».

j. V. STALIN


352 (9123) Пятница, 18 декабря 1942 г. ЦЕНА 15 КОП.

ВОЛЯ К ПОБЕДЕ

От Народного Комиссариата Иностранных Дел

О независимости Албании

Faksimile e Deklaratës së Komisariatit për Punët e Jashtme e datës 18.12.1942 «Mbi pavarësinë e Shqipërisë».


dër okupatorit.

DEKLARATAT E QEVERIVE ALEATE PËR NJOHJEN E IDENDENCËS SË POPULLIT SHQIPTAR.

Londër 17 Dhjetor. Qeverija Britanike e ka në program që Shqipëria të bëhet një vend i lirë dhe independent.

Ministri i jashtëm Anglez, Eden, përcaktoi sot në mënyjes në dhomën e komunevet politikën e qeverisë britanik kundrejt Shqipërisë. Ja deklarata zyrtare e qeverisë britanike: "Qeverija e M.T. Britanike, shpreh ndjenjat e saje të simpatisë kundrejt Shqipërisë.

që pati fatin e keq të jetë një nga viktimat e para të agresjonit fashist.

Qeverija Britanike dëshëron t'i japë lirinë dhe indipendencën Shqipërisë, dhe t'a shpëtojë nga zgjedha e Italisë fashiste. Ajo deklaron se populli Shqiptar do ta zgjedhë vetë dhe lirisht regjimin dhe formën e qeverisë që do të dëshërojë dhe që do të duket më e mirë.

Këto që thamë më lart, përfundoi Eden nuk i paracaktojnë lidhjet që Shqipëria në të ardhmen mund të bëjë me shtetet ballkanike.

Qeverija Britanike e konsideron çështjen e kufijve të Shqipërisë

Faksimile të deklarateve zyrtare të Fuqive të Mëdha mbi Shqipërinë, botuar në «Zëri i popullit» Nr. 8, viti 1942, mbi njohjen e pavarësisë e të luftës së popullit shqiptar, të cilat dëshmojnë se që nga viti 1942 Shqipëria njihej si pjesëmarrëse aktive e koalicionit të madh antifashist.


Më 17-22 mars 1943, në Labinot të Elbasanit u mbajt Konferenca I e Vendit e PKSH. Aty u bë bilanci i luftës dhe i forcave të Partisë, ku u caktua vija e Partisë, që duhej të ndiqej pas Konferencës I të Vendit. Nga Konferenca doli Komiteti Qendror Definitiv i Partisë Komuniste të Shqipërisë. Vendin kryesor, në gjithë punimet e konferencës, e zuri problemi i përgatitjes së popullit për kryengritjen e përgjithshme popullore dhe i organizimit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Konferenca I e Vendit, e mbajtur në Labinot, është një ngjarje historike nga më të rëndësishmet e Partisë sonë.







Enver Hoxha u zgjodh në Konferencën I të Vendit
Sekretar i Përgiithshëm i PKSH



Pamje e jashtme dhe e brendshme e shtëpisë, ku u mbajt Konferenca I e Vendit.







REZOLUCIONI I KONFERENCËS SË PARË TË PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

17 mars 1943

REZOLUCION

I KONFERENCËS SË PARË TË VENDIT TË PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

1. — Konferenca e parë e Vendit konstaton se lëvizja nacional-çlirimtare është duke u shtuar dita-ditës, ajo ka zënë rrënjë në popull dhe është [illegible] forcat e gjall[illegible] të momentit pë[illegible] monë më tepë[illegible] monë më të [illegible] janë bërë shu[illegible] çetat partizane [illegible] të re bashkimi[illegible] Hovi i L[illegible] armikun ja k[illegible] simin në forc[illegible] Partia Ko[illegible] trimit për ba[illegible] e ka kërkuar[illegible] kim, ajo vaz[illegible] bashkimin e[illegible]

c) Të bëhet në popull shpjegimi i nevojës dhe i qëllimit të Luftës nacional-çlirimtare, shpjegimi dhe popullarizimi i luftës sonë dhe i sukseseve të saj, mobilizimi politik i popullit për luftën kundër okupatorit dhe tradhtarëve të vendit, për një Shqipëri të lirë, të përtëritur, independente dhe demokratike, ku popull shqiptar do të ketë jetën më të mirë dhe më të lumtur.

ç) Të realizojmë dhe të forcojmë bashkimin e popullit shqiptar, pa marrë parasysh gjendjen ekonomike, tendencat dhe rrymat politike dhe fetë e ndryshme, duhet të kemi durim dhe të mbërrijmë bashkimin e sinqertë ose bashkëpunimin me nacionalistët.


d) Të kemi kujdes për njerëzit që e duan Luftën nacional-çlirimtare edhe për ata që janë të pabindshëm dhe të luejtshëm, [illegible] duhet të kemi durim[illegible] për të cilët

Puna në Ushtrinë Partizane dhe Vullnetare Nacional-Çlirimtare Shqiptare

Që të mund të bëhet Partia jonë udhëheqësja e vërtetë e Luftës nacional-çlirimtare, duhet të kuptojmë rëndësinë e formimit dhe forcimit të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Gjithë anëtarët dhe se në këtë sektor megjithëse është punuar dhe janë mbërritur rezultate, këto rezultate nuk kanë qenë të mjaftueshme. Për këtë gjë është e nevojshme: a) që organizatat tona duhet ta kenë të qartë që sot sektori kryesor i punës është të derdhin të gjithë aktivistët e tyre për të mobilizuar sa më shumë popull nëpër njësitë partizane dhe vullnetare si domos prej fshatarëve dhe prej rinisë; b) të krijojmë prej njësive partizane e vullnetare Ushtrinë Nacional-Çlirimtare të rregullt, e cila do të jetë fuqia e tmerrshme kundër okupatorit dhe garancia e sigurtë dhe e fuqishme për çlirimin e popullit; c) duhet ne të gjitha njësitë dhe organizatat e Partisë të zhvillojnë punën politike në shkallë të gjerë dhe të punojnë pa pushim duke shpjeguar qëllimin e Luftës nacional-çlirimtare, të vënë në dijeni luftëtarët mbi ngjarjet në botë dhe tek ne, të jenë shembull i disiplinës, i vendosjes, i vetëmohimit dhe guximit; të zhvillojnë disiplinën dhe shoqërinë ndërmjet luftëtarëve; ç) t'i bindim për nevojën e aksioneve kundër okupatorit dhe shërbëtorëve të tij, tradhtarëve të vendit, duke zhdukur çdo oportunizëm që duket në këtë drejtim; d) të plotësojmë radhët e Partisë me luftëtarët më të mirë, më të vendosur, më të disiplinuar.

Faksimile e Rezolucionit të Konferencës I të Vendit të Partisë Komuniste Shqiptare.


Lufta për çlirimin e Leskovikut, një nga betejat e përgjakshme në vargun e panumërt të betejave të forcave partizane kundër trupave ushtarake fashiste. Më 25 maj 1943, partizanët çliruan qytetin e Leskovikut. «Sytë e popullit, — shkruante buletini i lajmeve, — drejtoheshin nga partizanët dhe kudo gjëmonte parulla çlirimtare •Vdekje Fashizmit! Liri Popullit !»





Luftëtarë të batalioneve portizane të krijuara para formimit të Shtabit të Përgjithshëm.

Shoku Enver Hoxha në mes të partizanëve të batalionit «Hakmarrja»,




Faksimile e Thirrjes së KO të PKSH, më 7 prill 1943.

Vendimet e Konferencës I të Vendit i dhanë një hov të paparë zmadhimit dhe forcimit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e cila u bë një fuqi e tmerrshme kundër pushtuesve dhe tradhtarëve.

Në të gjitha anët e vendit u krijuan çeta të reja dhe batalione partizane nga bashkimi i dy-tre çetave. Në maj u krijuan në qqrkun e Korçës: batalioni «Ali Kelmendi», batalioni «Thëmistokli Gërmenji», batalioni «Fuat Babani», batalioni «Çlirimi», batalioni «Hakmarrja», Batalioni i Mokrës; në qarkun e Elbasanit: Batalioni i Dumresë dhe Batalioni i Çermenikës; në qershor u krijuan në qarkun e Vlorës: batalioni «Halim Xhelo» dhe batalioni «Ismail Qemali»; në qarkun e Elbasanit: Batalioni i Martaneshit; në qarkun e Beratit: batalioni «Riza Cerova», Batalioni i Kuçovës dhe Batalioni i Myzeqesë; në korrik u krijuan në qarkun e Shkodrës: batalioni «Perlat Rexhepi»; në qarkun e Dibrës: Batalioni i Dibrës; në qarkun e Gjirokastrës: batalioni «Naim Frashëri» dhe batalioni «Çamëria»; në qarkun e Elbasanit: Batalioni i Bërzeshtës. Batalione të tjera ishin në formim e sipër. Në korrik 1943 numri i partizanëve në çetat dhe batalionet e rregullta arrinte në 10.000 luftëtarë. Dyfishi i këtij numri vepronin në çetat vullnetare territoriale të fshatrave.






Luftëtarë të batalioneve partizane të krijuara para formimit të Shtabit të Përgjithshëm.




Shoku Enver Hoxha në mes të luftëtarëve të Botalionit të Mokrës.



Tom Kola, anëtar i Komitetit Qarkor të Rinisë Komuniste të Shkodrës, rënë heroikisht më 19 prill 1943. Hero i Popullit.





Në Pezë e Mallakastër (qershor-korrik 1943), forcat partizane, të përkrahura nga populli, shpartalluan ushtritë e shumta të pushtuesit, që u sulën me zjarr dhe hekur për të asgjësuar Lëvizjen Nacionalçlirimtare në këto krahina.







Luftëtarë të batalioneve partizane të krijuara para formimit të Shtabit të Përgjithshëm.






Asim Zeneli, komisar i çetës «Hgjredin Tremishti», rënë heroikisht. në Grykën e Mezhgoronit, më 2 korrik 1943. Hero i Popullit.





Luftëtorë të batalioneve partizone të krijuara para formimit të Shtabit të Përgjithshëm.





Më 2-4 korrik 1943, repartet partizane të qarqeve Korçë, Gjirokastër dhe Bergt kryen një goditje në shkollë të gjerë kundër ushtrisë italiane në rrethin e Përmetit, në zonën Përmet-Kuqar-Grykë e Mezhgoranit-Qgfg e Kiçokut. Lufta e Përmetit kg qenë një epope e lavdishme e popullit kryengritës dhe një grusht i rëndë për fashistët italianë.



Gryka e Mezhgoranit G. Madhi







Më 6 korrik 1943, partizanët shqiptarë kryen goditjen e parë kundër forcave pushtuese gjermane gjatë rrugës Korçë-Janinë, në fshatin Barmash të Kolonjës. Xhelatët nazistë u lëshuan fshatrave të afërta duke vrarë njerëz të popullit dhe duke djegur shtëpi.

Vetëm në fshatin Borovë ata pushkatuan 107 vetë, midis të cilëve shumë gra dhe fëmijë.

Më 10 korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, në Labinot të Elbasanit u shpall krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH. Dita e 10 korrikut ka hyrë në historinë e popullit shqiptar si dita e Ushtrisë Popullore Shqiptare.

«Formimi i Shtabit të Përgjithshëm shënon një ngjarje me rëndësi historike për zhvillimin e mëtejshëm të luftës së armatosur të popullit tonë kundër okupatorëve, për formimin e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare. Pas formimit të Shtabit të Përgjithshëm u organizuan shtabet e qarqeve dhe të zonave. U kalua nga faza e çetave dhe e batalioneve në fazën e brigadave partizane...

Me formimin e Shtabit të Përgjithshëm filloi një etapë e re e luftës për çlirimin e vendit; kryengritja e përgjithshme e popullit kundër okupatorit kishte filluar».

ENVER HOXHA





Enver Hoxha, organizues dhe udhëheqës i UNÇSH.

PJESË NGA PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË PARË TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË USHTRISË NACIONALÇLIRIMTARE

5-10 korrik 1943

PROCESVERBAL

Sot, ditën e hënë 5 korrik 1943 ora 10,15' u mblodh për të parën herë Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, i dalë nga Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar...

Propozohet dhe pranohet për rend-dite:
1) Kompetencat e Shtabit.
2) Struktura e Shtabit.
3) Ndarja e përgjegjësive.
4) Të ndryshme.

Propozohet të zgjidhet një komision për të pregatitur një projekt për kompetencat dhe për strukturën e Shtabit.

U propozua dhe u pranua që të procedohet imediatisht në zgjedhjen e kryetarit dhe të komisarit të Shtabit...

U procedua në votimet e kryetarit të Shtabit dhe rezultoi unanimisht major Spiro Moisiu.

U procedua në votimin e komisarit të Shtabit dhe rezultoi unanimisht i zgjedhur Enver Hoxha.


U propozua dhe u pranua që komisioni i formuar për projektin e kompetencave dhe të strukturës së Shtabit të ngarkohet edhe me formulimin e Betimit të Shtabit dhe të ushtrisë...

Mbledhja e datës 10 korrik ora 4 pasdreke.

Pranohet struktura e Shtabit të Përgjithshëm:

Shtabi operativ
Komisariati politik
Komisariati (ekonomik)
Seksioni i brendshëm
Seksioni i shëndetësisë

Faksimile e Procesverbalit të mbledhjes së parë të Shtabit të Përgjithshëm për organizimin e Ushtrise Nacionalçlirimtare Shqiptare.




Faksimile e Proklamatës së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe e Shtabit të Përgjithshëm drejtuar popullit shqiptar mbi krijimin e Shtabit të Përgjithshëm te UNÇSH, 10 korrik 1943.



Enver Hoxha, Komisar Politik i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare.

Spiro Moisiu, Komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare.




Ndërtimi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare u krye në bazë të direktivave të Konferencës I të Vendit të PKSH dhe të Komitetit Qendror të PKSH, të urdhrave dhe udhëzimeve të Shtabit të Përgjithshëm.

U ngritën shtabet e grupeve në qarqet (ose shtabet e qarqeve) Berat, Durrës (përfshinte Kavajën, Pezën, Shijakun, Peqinin 'dhe njihej zakonisht me emrin Shtabi i Grupit të Pezës), Elbasan, Dibër (përfshinte edhe Kukësin), Shkodër (përfshinte Tropojën, Malësinë e Gjakovës), Krujë (përfshinte edhe Matin me Kthellën). Për qarqet Vlorë e Gjirokastër u formua një shtab i vetëm me emrin Shtab i Zonës I Operative. Ndërsa shtabi i Grupit të Korçës qe krijuar në qershor 1943.

Pranë çdo shtabi u krijuan shërbimet e informacionit, të ndërlidhjes, të shëndetësisë, të intendencës, të agjitacionit e propagandës dhe gjykata ushtarake.

Formacionet e UNÇSH ishin çeta, batalioni dhe brigada.



URDHËR PËR ORGANIZIMIN E USHTRISË NACIONALÇLIRIMTARE SHQIPTARE

17 gusht 1943

Komanda e Shtabit të Përgjithshëm
të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare

URDHËR

Katër vjet me radhë populli shqiptar po lufton zaptuesin dhe tradhtarët e vendit, lufta e tij dita-ditës është shtuar. Njësitet luftarake të popullit shqiptar janë shtuar dhe janë zmadhuar. Nga çetat e vogla, ato kanë kaluar në çeta të mëdha, në batalione e në brigada.

Zhvillimi politik dhe ushtarak i popullit tonë ka bërë hapa të mëdhenj dhe një pjesë e madhe e popullit po shkon drejt kryengritjes së përgjithshme. Ndër këto cirkostanca dhe momente, kur duhet me i dhënë grushtin e vdekjes zaptuesit dhe veglave të tij dhe me i shporrë këta nga toka e atdheut tonë të dashur, Shtabi i Përgjithshëm urdhëron formimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Partizane Vullnetare Shqiptare në të cilën populli ynë ka vënë shpresat dhe pret çlirimin e shpejtë të Shqipërisë nga thonjtë e zaptuesit.

Komisari Politik
ENVER HOXHA

Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të
Ushtrisë Nacionalçlirimtare Part. Vull.
Major SPIRO MOISIU

Faksimile e Urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm për organizimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare.



«10 Korrik 1943. Formimi i Shtabit të Përgjithshëm» G. Modhi





Luftëtarë dhe kuadro të batalioneve partizane të qarkut të Tiranës. Në këtë qark vepronin Grupi i Pezës dhe batalioni «Dajti».
Në foto Nr. 3, në të majtë të Myslim Pezës, patrioti Esat Dishnica.






Anëtarë të Shtabit të Zonës I Operative Vlorë-Gjirokastër. Nga e djathta në të majtë: Hysni Kapo, Fejzo Dervishi dhe Shefqet Peçi.

Luftëtarë dhe kuadro të batalioneve partizane të Zonës I Operative Vlorë-Gjirokastër. Në këtë zonë vepronin batalionet «Asim Zeneli», «Baba Abaz», «Misto Mame», «Thanas 2iko», «Çamëria» ose «Thoma Lulo» , «Naim Frashëri», «Perlat Rexhepi», «Halim Xhelo», «Ismail Klosi», «Petro Sota» dhe «Ismail Qemali». Këto batalione, në nëntor 1943, u bashkuan dhe formuan Grupin I, Grupin II, Grupin III, Grupin IV dhe Grupin V.





Mbrojtja popullore e Konispolit, në gusht 1943, kundër nazistëve gjermanë, që kërkonin të depërtonin në tokën shqiptare në rajonin e Konispolit, u kurorëzua me sukses dhe trupat gjermane u kthyen në tokën greke me humbje të mëdha.




Memo Meto
Hero i Popullit




Kastriot Muço
Hero i Popullit



Luftëtarë dhe kuadro të batalioneve partizane të Zonës I Operative.





Luftëtarë dhe kuadro të batalioneve partizane të Zonës I Operative.





Skënder Çaçi
Heroi i popullit





Luftëtorë dhe kuadro të batalioneve partizane të qarkut të Korçës. Në këtë qark vepronin batalionet: «Ali Kelmendi», «Themistokli Gërmenji», «Çlirimi», «Hakmarrje», «Fuat Babani», «Reshit Çollaku», «Tomori», «Qamil Panariti», «6 Dëshmorët», «Shqiponja» dhe «Skënder Çaçi».

Në foto Nr. 2 ndodhen, midis të tjerëve, Sali Mborja, Mihal Lako, Paisi Vodica.








Fahri Ramadani.
Hero i Popullit.



Luftëtarë dhe kuadro të botalioneve partizane të Shkodrës e të Tropojës.



Lufta e Reçit, një nga veprimet luftarake më të rëndësishme të UNÇSH, në gusht të vitit 1943. Forcat e batalionit «Perlat Rexhepi», në bashkëpunim me popullsinë vendase, shpartalluan trupat fashiste italiane prej 1200 vetësh, duke u shkaktuar humbje të rënda.







Margarita Tutulani, Dino Kalenja, Ajet Xhindole. Heronj të Popullit.



Luftëtarë dhe kuadro të batalioneve partizane të qarkut të Beratit. Në këtë qark vepronin batalionet «Riza Cerova», «Rinia», «Tefik Lapani», «Myzeqeja», «Kuçova», «Shpiragu» dhe «Vojo Kushi». Në nëntor-dhjetor 1943, këto batalione u bashkuan dhe formuan Grupin I, Grupin II dhe Grupin III.









Luftëtarë dhe kuadro të batalioneve partizane të qarkut të Dibrës dhe Kukësit. Në këtë qark vepronin Batalioni i Dibrës «Rinia» ose «Nazmi Rushiti», Çeta e Lumës dhe Çeta e Hasit.

Nga 31 korriku deri më 4 gusht 1943, Çeta partizane e Matit me 3000 matjanë të armatosur sulmoi garnizonin fashist në Burrel dhe Qafën e Buallit, duke çliruar dhe qytetin e Burrelit. Më 4 gusht Batalioni i Dibrës çliroi Zerqanin dhe dy javë më vonë sulmoi dhe u shkaktoi dëme të mëdha forcave kryesore të një divizioni italian, që orvatej të kalonte nga Dibra në Mat. Në të njëjtën kohë partizanë të Çetës së Matit, të Çetës së Dajtit dhe të Çetës Krujë-Ishëm i bënë një pritë të fortë në Qafështamë kolonës së ushtarëve që vinte nga Kruja në Burrel, për t'i ardhur në ndihmë garnizonit të rrethuar në Burrel.

Ngjarjet e gushtit në Mat, Dibër e Qafështamë treguan forcën e reparteve partizane dhe të popullit kryengritës të këtyre zonave.











Shejnaze Juka.
Heroinë e Popullit.

Luftëtarë dhe kuadro të batalioneve partizane të qarkut të Elbosanit. Në këtë qork vepronin: Batalioni i Çermenikës, i Dumresë, i Vërçë-Sulovës, i Bërzeshtës dhe i Martoneshit.

Në foto Nr. 2, File Musaj (i katërti nga e djathta në këmbë)


Në foton Nr. 3. në mes Tomor Sinani, sekretar politik i Komitetit Qarkor për Elbasanin.



Luftëtarë dhe kuadro të batalioneve partizane të Krujës dhe të Matit. Në këtë krahinë vepronin: batalioni «Krujë-Ishëm» dhe Çeta e Matit.

Në foton 1, në plan të parë, ulur, Rexhë Deliu, Hero i Popullit.





«Sulm partizan». F. Haxhiu.



Brigada I Sulmuese u krijua më 15 gusht 1943, në Vithkuq të Korçës me partizanë nga të gjitha qarqet e Shqipërisë.

«Brigada I Sulmuese partizane u dallua në luftimet e saj të paprera, të guximshme, dërrmuese për okupatorin e truallit tonë dhe për tradhtarët e vendit. Shpirti i lartë i sakrificës dhe i vetëmohimit në shërbim të çështjes së madhe, nga e cila varet jeta ose vdekja e popullit tonë, ka shkëlqyer si një yll mbi Brigadën I Sulmuese partizane, dhe në çdo luftë dhe përpjekje, në ditët e mira dhe të vështira të asaj brigade, heroizmi, dashuria e madhe për popullin tonë, urrejtja për okupatorin e kanë udhëhequr Brigadën I drejt rrugës së fitores së sigurt të armëve tona. Brigada I Sulmuese partizane me vrullin e saj luftarak ka qenë tmerr për okupatcrin e tradhtarët e vendit dhe shprehja më e gjallë e vullnetit të një populli më këmbë për të mbrojtur dhe fituar të drejtat e tij».

ENVER HOXHA



Brigada I Sulmuese u nderua nga Partia dhe nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me titullin «Hero i Popullit», me këtë motivacion:

«Për heroizmin e lartë masiv të luftëtarëve të saj dhe për shërbimet e shquara në çlirimin e atdheut nga pushtuesit fashistë e tradhtarët dhe për vendosjen e pushtetit popullor.

Me luftën dhe veprimtarinë e saj revolucionare, si formacioni i parë i madh i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, ajo u bë shembull për gjithë repartet dhe njësitë partizane, duke korrur fitore pas fitoreje mbi armiqtë dhe duke fituar një dashuri të zjarrtë dhe një mbështetje të pakufishme nga masat e gjera të popullit...»



Mehmet Shehu, komandant i Brigadës I Sulmuese. Hero i Popullit.



Pamje nga inaugurimi i Brigadës I Sulmuese. Në inaugurim mori pjesë shoku Enver Hoxha.



Shoku Enver Hoxha në tribunë, ditën e inaugurimit të Brigadës I Sulmuese. Shoqja Fiqret Sanxhaktari përshëndet krijimin e Brigadës në emër të gra-ve antifashiste.

Brigada I Sulmuese parakalon përpara përfaqësuesve të KQ të PKSH, Shtabit të Përgjithshëm dhe popullit të qarkut të Korçës.







Luftëtarë të Brigadës I Sulmuese. Heronj të Popullit:


Xheladin Beqiri, Gjok Doçi, Fejzi Micolli, Inajete Dume, Myslym Shyri, Estref Caka (Osoja).

Lista e anëtarëve të Partisë të Brigadës I S shkruar nga shoku Enver.






Më 26 gusht 1943, forca të mëdha armike prej 10 000 vetësh, me ortileri dhe aviacion sulmuan Vithkuqin. Brigada I Sulmuese së bashku me batalionet e qarkut të Korçës u përlesh me armikun për 4 ditë rresht. Nga zjarri i armëve partizane armiku u tërhoq, pasi la në fushën e luftës 200 të vrarë dhe shumë material luftarak.




Shtypi i Partisë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare u bë një armë e fuqishme për edukimin politik, ushtarak të partizanëve dhe të masave të gjera popullore. Ai shërbeu si një tribunë për demaskimin e planeve të pushtuesve e tradhtarëve, duke ngjallur tek populli urrejtjen e pakufishme për armiqtë e vendit. Me dhjetëra mijëra trakte, komunikata, përhapeshin anembanë vendit. Përveç «Zërit të popullit» dolën edhe organe të tjera si «Kushtrimi i lirisë», «Bashkimi», si dhe dhjetëra organe të njësive partizane. Lufta me pendë sikurse lufta me armë luajti një rol shumë të rëndësishëm për bashkimin politik të popullit rreth Frontit Nacionalçlirimtar të udhëhequr nga Partia Komuniste, rriti besimin në fitore, ngriti popullin peshë në luftën e përgjithshme të armatosur.











Nën ndikimin e drejtpërdrejtë të luftës çlirimtare të popullit dhe nën udhëheqjen e Partisë Komuniste lindi një letërsi e re politike dhe artistike me tipare krejt të reja. Artikujt publicistikë të shokut Enver Hoxha në «Zërin e popullit», në «Bashkimi» dhe në organe të tjera janë model i kësaj letërsie.

Shumë të dashura për popullin gjatë viteve të luftës ishin: këngët revolucionare, vjershat patriotike, himnet dhe marshet partizane. Vepra letrare, që u bë më popullore gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, është «Epopeja e Ballit Kombëtar» e Shevqet Musarajt (Buburicka).



Komanda e Shtabit të Përgjithshëm
të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare

17 gusht 1943

URDHËR

Gjatë luftës që po zhvillojmë kemi mjaft *të sëmurë* dhe *të plagosur*, për të cilët duhet të kemi kujdesin më të madh me i shërue që kështu të mundin të zënë përsëri vendin në radhët e luftës.

Prandaj urdhërojmë që çdo grup duhet të krijojë një spital ku të shtrohen vetëm të plagosurit dhe të sëmurët rëndë. Ky spital të drejtohet, mundësisht, prej një doktori, ose një infermieri të stërvitur.

Të sëmurët lehtë të çohen në shtëpi miqsh ose në ndonjë ambulancë për shërbim të shpejtë.

Për shërbim në spitale duhet t'u bëhet apel vullnetareve, gra të qyteteve ose të fshatrave, të cilat të kryejnë punën e infermiereve.

Komisari Politik
ENVER HOXHA

Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare P. V.
MAJOR SPIRO MOISIU

Faksimile e Urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm, dërguar komandave të shtabeve të qarqeve për ngritjen e spitaleve partizane.





«Shokët». O. Paskali.








Jeta në repartet partizane ishte për luftëtarët e lirisë një shkollë e vërtetë. Në pushimet e shkurtra midis luftimeve, në repartet partizane bëhej një punë e madhe për edukimin politik të luftëtarëve, për ngritjen e tyre kulturore dhe arsimore, për brumosjen e tyre me një moral të shëndoshë partizan.

Pastërtia morale e partizanëve plotësohej me ndershmërinë dhe drejtësinë shembullore të tyre në marrëdhëniet me masat popullore.




1 Grupi teatral i një reparti partizan jep shfaqje për partizanët dhe popullin.

2 Partizanët ndihmonin fshatarët në punët e tyre të përditshme.



Konferenca II Nacionalçlirimtare u mblodh në Labinot të Elbasanit, më 4-9 shtator 1943, me iniciativën e KQ të PKSH dhe me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Ajo shënoi një etapë të rëndësishme në thellimin e procesit revolucionar të luftës, në bashkimin politik të popullit shqiptar rreth Frontit Nacionalçlirimtar, në zgjerimin e luftës së armatosur, në forcimin e pushtetit nacionalçlirimtar, në zgjerimin e bazës demokratike dhe centralizmin e pushtetit popullor dhe vendosi që «Këshillat Nacionalçlirimtare të njihen si i vetmi pushtet i popullit në Shqipëri».

Konferenca II Nacionalçlirimtare njohu organizatat e Bashkimit të Rinisë Antifashiste, të Bashkimit të Grave Antifashiste, të Bashkimit të Universitarëve Antifashistë, të krijuara në verë të vitit 1943 nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, si pjesë përbërëse të Frontit Nacionalçlirimtar.






Enver Hoxha, udhëheqës i punimeve të Konferencës II Nacionalçlirimtare.



Shoku Enver Hoxha në mes të delegatëve në ditët e Konferencës II Nacionalçlirimtare në Labinot, midis të cilëve ndodhen Nako Spiru, Ollga Plumbi, Mustafa Xhani, Medar Shtylla, Spiro Koleka, Ethem Barhani, Fetah Ekmeçiu.



REZOLUCIONI I KONFERENCËS SË DYTË NACIONAL-ÇLIRIMTARE »

5 Shtator 1943

Konferenca e dytë Nacional-Çlirimtare, ku muarnë pjesë delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, u mblodh motmot pas Konferencës së Pezës për të bërë bilancin e një vit veprimi të Këshillit të Përgjithshëm Provizor dhe për të zgjedhur Këshillin e Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar.

Në konferencë u biseduan raportet mbi situatën e jashtme e të brendëshme, mbi veprimin e Këshillave dhe mbi detyrat e tyre në situatën e sotme, mbi qendrimin e Lëvizjes sonë kundrejt rrymave të ndryshme politike jashtë Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, mbi Ushtrinë Nacional-Çlirimtare, mbi »Rininë Popullore Antifashiste«, mbi »Bashkimin e Gruas Antifashiste Shqiptare« edhe u zgjodh Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar. Konferenca erdhi në këto konkluzione:

II. Që nga Konferenca e Pezës e tëhu, Lëvizja Nacional-Clirimtare ka marrë një hov të madh. Në Shqipërinë Jugore dhe në Shqipërinë e Mesme pothuaj kudo u formuan Këshillat Nacional-Çlirimtare; po krijohen konditat që të organizohen Këshillat kudo edhe në Shqipërinë Veriore.

Çetat partisane e vullnetare, që në krye nëmëroheshin me gisht, u shtuan e mbuluan Shqipërinë, u formuan batalione, u formua brigada, u organizua Shtabi i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar. Demostratat nëpër qytete, demostratat në gjithë Shqipërinë, ku merrnin pjesë mijëra e mijëra, heroizma e shokëve tanë, shkundën gjithë popullin, e mobilizuan dhe e bashkuan në luftë rreth Lëvizjes sonë. Falimentuan planet e armikut për të organizuar një parti fashiste shqiptare, një milici fashiste shqiptare, për një mobilizim të gjerë të popullit shqiptar në ushtrinë italiane. Falimentoi manevra d... e armikut për një xhandarmëri »kombëtare« etj. Ku... ria s'kish parë në lëvizje kaq të madhe. Çetat, bata... brigada, e goditnë armikun kudo (Patos, Selenicë, F... pratit, Pezë, Gjorm, Libohovë, Përmet, Leskovik, Q... mës, Skëterë, Barmash, Vithkuq) dhe e shtërngua... nëpër qytete. Krahina të tëra u çliruan (Opar, Gorë, D... kër, Dangëlli, Zagori, Lunxheri, Mesaplik, Dukat, Tre... pallti, Mallakastër, Skrapar, Tomoricë, Çermenikë, ... Pezë, Shpat, Polis, Dumre, Gramsh, Qukës, Zaranik... Shqipëria s'kish parë një entuziazëm kaq të madh, një ... kaq të lartë.

Përpara një lufte të tillë qeveria e Mustafa Kruj... kullis si një kështjellë prej karte. Armiku e humbi pushtetin dhe nisi të ndërrojë qeveritë njerën pas tjetrës (4 qeveri në tre muaj) duke kërkuar parulla e metoda të reja.

Lufta jonë u njoh nga gjithë bota. Deklaratat e Hullit, Molotovit e Idenit, ku njihet indipendenca e Shqipërisë,[40] i detyrohen fund e krye luftës sonë. Me ardhjen e një misioni ushtarak anglez në vendin tonë[41], Lëvizja tonë Nacional-Çlirimtare hyri në lidhje e në bashkëpunim direkt me aleatët e mëdhenj.

U realizuan lidhje të nguahta me EAM-in* në Greqi dhe me »Komitetin Nacional-Çlirimtar« në Jugosllavi, me shtabet e ushtrive nacional-çlirimtare në Greqi e Jugosllavi...

Konferenca e dytë Nacional-Çlirimtare vetë dëshmon vullnetin e zgjerimin e luftës sonë që nga Konferenca e Pezës e tëhu.

III. Në lidhje me gjithë situatën ndërkombëtare, me sukseset tona, me dobësimin e armikut, me hyrjen e gjermanëve në token tonë, është krijuar një situatë e re në Shqipëri: jemi në pragun e një kryengritjeje të përgjithshme. Prandaj duhen vënë të gjitha fuqitë për të bashkuar të gjithë popullin rreth Këshillave Nacional-Çlirimtare, duhet forcuar Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare, duhen forcuar prapavijat tona, duhet pregatitur e organizuar kryengritja.

Në këtë situatë problemi i brendshëm ka një rëndësi të veçantë, pse, bashkë me ashpërsimin e reaksionit nga ana e armikut nën kontrollin e gjermanëve, reaksioni i brendshëm ka nisur të grumbullohet e të organizohet. Po theksohen tendencat reaksionare të tij. Nën këtë prizmë duhet ...

c) Te njihen Keshillat Nacional-Çlirimtare si i vetmi pushtet i popullit në Shqipëri.

b) Të njihet aleanca e popullit shqiptar me Bashkimin Sovjetik, me Anglinë dhe Amerikën: të njihet aleanca e popullit shqiptar me popujt e shtypur nga Boshti dhe, veçanërisht, me popujt fqinj jugosllav e grek; të njihet Karta e Atlantikut,[44] traktatet e Londrës dhe të Vashingtonit,[45] që janë baza politike e kësaj aleance. Çështja e Kosovës dhe e Çamërisë do të zgjidhet në bazë të Kartës së Atlantikut, në bazë të parimit të vetëvendosjes së popujve, dhe garancia më e madhe për triumfin e këtij principi është vetë lufta që bëjnë dhe do të bëjnë Kosova e Çamëria krah për krah me popujt jugosllav e grek kundër okupatorit fashist, për të zhdukur fashizmin italian e gjerman, dhe, bashkë me të, të gjitha tendencat imperialiste e shoviniste kudo në botë e, veçanërisht, në Ballkan.

c) Të njihen Këshillat Nacional-Çlirimtare si i vetmi pushtet i popullit në Shqipëri.

ç) Duhen ...

... lidhur me okupatorët e nga të gjithë ... aprovon vendimarrëveshja që bëri ... përfaqësuesit e »Barimet krvesore të ... një frymëruar dhe ... luftën e tij kundër ...

... Këshillat Nacionet organet politiur lidhje të shën... të Këshillave të tje... dobët dhe nuk ka pasur kontroll e ... duhet nga ana e instancave më të larta.

Konferenca ngarkon Këshillin e ri të Përgjithshëm të përpiqet që:

1. Të organizohen kudo në Shqipëri Këshilla Nacional-Çlirimtare.
2. Të forcohen Këshillat nga pikëpamja organizative.
3. Këshillat të ushtrojnë pushtetin civil në bashkëpunim të ngushtë me komandat e Ushtrisë sonë Nacional-Çlirimtare.
4. Të shpjegohet e të përhapet gjithë materiali për propagandë; dokumentat me rëndësi politike të këndohen e të biseduhen në mbledhjet e përgjithshëm dhe në Këshillat Nacional-Çlirimtare.
5. Të forcohen lidhjet dhe kontrolli në të gjithë sistemin organizativ të Këshillave.

* EAM — Ethnikos Apeleftherikon Metopo (greqisht) — Fronti Nacional-Çlirimtar.

Faksimile e Rezolucionit të Konferencës II Nacionalçlirimtare.



«Tregim nga Lufta Nacionalçlirimtare» **N. Zajmi**



Partizanë shqiptarë të Brigadës I e italianë të batalionit «Antonio Gramshi».

THIRRJE DREJTUAR POPULLIT SHQIPTAR ME RASTIN E KAPITULLIMIT TË ITALISË FASHISTE

10 shtator 1943

Vdekje fashizmit — Liri popullit

POPULL SHQIPTAR,

Italia kapitulloi pa kondita[1]. Ushtria italiane në Shqipëri jo vetëm që nuk është më një forcë që na lufton, por një pjesë e saj po hidhet drejtpërdrejt në radhët tona kundër gjermanëve. Është në urdhër të ditës kryengritja e përgjithshme për të çliruar gjithë Shqipërinë, për të marrë fuqinë në dorë, e për të ngritur një Shqipëri demokratike popullore.

Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar që u zgjodh në Konferencën e Dytë, fton të gjitha këshillat e qyteteve, të krahinave, të komuneve e të fshatrave, gjithë Ushtrinë tonë Nacionalçlirimtare, Bashkimin e Rinisë Antifashiste, Bashkimin e Gruas Antifashiste Shqiptare, e të gjithë anëtarët e saj të çdo tendence politike qofshin, që të mobilizojnë gjithë popullin shqiptar për kryengritje. Ky mobilizim duhet të bëhet nën flamurin e parimeve politike që u shpall në Konferencën e Pezës dhe që me luftë të paprerë e heroike u rrënjos në shpirtin e popullit tonë. Ky bashkim duhet të bëhet nën flamurin e bashkimit të popullit shqiptar rreth këshillave nacionalçlirimtare, rreth ushtrisë sonë heroike në një front të përbashkët antifashist kundër okupatorit gjerman e këlyshëve të tij.

POPULL SHQIPTAR,

Erdhi dita që të rrëmbeni armët e të lironi Shqipërinë nga zgjedha e huaj, nga zgjedha e Gjermanisë hitleriane, që është koka e fashizmit. Rrëmbeni armët e i bini armikut me tërbim në fshatra, në krahina, në qytete e kudo që ta gjeni; goditeni për vdekje në rrugë, në kazerma, në të gjitha qendrat e tij; hapni dyert e kampeve e të burgjeve; shkatërroni tërë makinën skllavëruese të tij, thyeni zinxhirët e robërisë.

Hapni sytë e demaskoni pa mëshirë manovrat e reaksionit në shërbim të Gjermanisë hitleriane, zbuloni e shkatërroni të gjitha foletë e tij, demaskoni e goditni pa mëshirë, bashkë me ushtarët italianë, këlyshët e Hitlerit në radhët e ushtrisë italiane.

Shtoni dhe shtërngoni radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ngrini dhe vendosni kudo këshillat nacionalçlirimtare, vendosni kudo pushtetin demokratik popullor.

Çdo gjë për kryengritje!
Ra ora e vdekjes për fashizmin!
Ra ora e lirisë për popullin!

RROFTË POPULLI SHQIPTAR!
RROFTË USHTRIA NACIONALÇLIRIMTARE!
RROFTË SHQIPËRIA DEMOKRATIKE POPULLORE!

Për Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar
KRYESIA E KËSHILLIT

Për Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare

Komandanti — **Major SPIRO MOISIU**
Komisari Politik — **ENVER HOXHA**

Faksimile e Thirrjes së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare drejtuar popullit shqiptar, me rastin e kapitullimit të Italisë.

Ushtarë italianë, dorëzuar reparteve partizane.



Shënim:
Diçitura e fotos lart i takon fotos poshtë dhe anasjelltas.



Forca të Brigadës I Sulmuese në Beratin e çliruar penxohësisht.

Kur kapitulloi Italia, më 8 shtator 1943, UNÇSH ndodhej në mësymje në çdo kënd të atdheut. Me luftë të përgjakshme, forcat partizane çliruan qytetet Berat, Gjirokastër, Përmet, Delvinë, Sarandë, Pogradec, Krujë, Peshkopi e Dibër. Në gjithë territorin e çliruar këshillat nacionalçlirimtare njiheshin nga masat popullore si i vetmi pushtet politik në Shqipëri. Me kapitullimin e Italisë, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH u bëri thirrje Komandës së Lartë Italiane dhe gjithë trupave të pushtimit, që të fillonin luftën përkrah UNÇSH ose përndryshe të dorëzonin armët. Por Komanda Italiane u dha urdhër reparteve që të dorëzoheshin te trupat gjermanë. Vetëm 15.000 ushtarë italianë iu dorëzuan UNÇSH dhe nga këta 1500 pranuan vullnetarisht të luftonin me armë në dorë në rreshtat e UNÇSH, ku u pritën si vëllezër e shokë lufte.




Pamje nga Gjirokastra e çliruar përkohësisht nga UNÇSH.

Më 9 shtator 1943, vendin e ushtrisë pushtuese italiane e zuri ushtria gjermane. Rreth 70 mijë ushtarë hitlerianë shkelën në tokën shqiptare. Me pushtimin e Shqipërisë nga Gjermania hitleriane filloi një periudhë edhe më e rëndë për Luftën Nacionalçlirimtare në Shqipëri.

Populli shqiptar, i bashkuar në Frontin Nacionalçlirimtar, i priti kudo me luftë agresorët nazistë gjermanë. Ai nën udhëheqjen e Partisë Komuniste vazhdoi luftën e vet deri në fitoren përfundimtare mbi pushtuesit e tradhtarët.







Partia Komuniste e Shqipërisë, Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe Shtabi i Përgjithshëm u bënë thirrje popullit shqiptar dhe Ushtrisë Nacionalçlirimtare të godisnin pa mëshirë dhe kudo pushtuesit e rinj, fashistët gjermanë. «Rrëmbeni armët, — thuhej në një nga këto thirrje, — i bini armikut me tërbim në fshatra, krahina, në qytete e kudo që ta gjeni, goditeni për vdekje në rrugë, në kazerma, në të gjitha qendrat; hapini dyert e kampeve dhe të burgjeve, shkatërroni krejt makinën skllavëruese të tij, thyeni zinxhirët e robërisë.»

Agresorët gjermanë populli shqiptar i pret kudo me luftë.

Lufta e Krujës më 22-24 shtator 1943, një tjetër faqe e lavdishme në vargun e gjatë të betejave kundër hordhive naziste në javët e para të pushtimit.


Lufta e Drashovicës, 14-15 shtator 1943, një nga luftimet më të ashpra të zhvilluara kundër pushtuesve gjermanë në ditët e para të pushtimit.







Agresorët gjermanë duke hyrë në tokën shqiptare.



Pushtuesit hitlerianë u pritën miqësisht vetëm nga tradhtarët e atdheut, të cilët u shërbyen atyre njësoj si pushtuesve fashistë italianë.



Pushtuesit gjermanë ndoqën taktikën e mashtrimit të popullit shqiptar me anë «të krijimit të shtetit shqiptar të pavarur». Për këtë qëllim, mblodhën më 16 tetor 1943 një asamble kuislingësh, e cila duhej të shpallte «pavarësinë e Shqipërisë» dhe të krijonte një «regjencë» dhe një «qeveri shqiptare», aleate të Gjermanisë. Populli shqiptar me Partinë Komuniste në krye u dha armiqve përgjigjen e vet të vendosur: luftë pa kompromis kundër pushtuesve hitlerianë e tradhtarëve deri në çlirimin e plotë të vendit dhe në ndërtimin e një Shqipërie Demokratike Popullore.



VDEKJE FASHIZMIT LIRI POPULLIT

Si i përgjigjet populli Shqiptár Asambles s'Gestapos?

me TOP!

Asamblea trathtare e Shqipnis u mbloth sot më 18 Tetuer, m'ora 9 në Pallatin e Viktor Emanuelit në Tiranë, u mblodh për të përsërit trathtin e 12 Prillit 1939. Kurdoherë anmiqt e popullit t'onë, trathtarët, reaksionarët, janë bashkue dhe bashkohen me të huejt për të mbajt popullin në robni.

Asamblesë së 18 Tetorit, populli Shqiptar, n'armë kundra okupatorit, i dha përgjigjën e tij me luftë.

Artileria e brigatës së tretë t'Ushtris Nac. Çl. Shqiptare qëlloi sot m'ora 10 Pallatin e V. E. Pallatin e Asamblesë.

Poshtë Asamblea e Gestapos!
Rrofte Ushtrija Nacjonal-Çlirimtare!
Rrofte Shqipnija e Lirë demokratike-popullore!



Faksimile e traktit, që njofton goditjen e asamblesë tradhtare nga artileria e Brigadës III S të UNÇSH.


Me urdhër të drejtpërdrejtë të shokut Enver Hoxha, artileria e Brigadës III Sulmuese, më 18 tetor 1943. goditi që nga kodrat e Saukut (në jug të Tiranës) godinën ku ndodhej e mbledhur asambleja tradhtare.





ENVER HOXHA

Në vjeshtë të vitit 1943, në të gjitha zonat e çliruara u zhvilluan zgjedhjet e leja të këshillave nacionalçlirimtare të fshatrave dhe krahinave. Në disa zona u zhvilluan konfelencat e qarqeve, ku u zgjodhën këshillat nacionalçlirimtare të qarqeve. Radhët e këshillave u shtuan dhe u forcuan me njerëz besnikë të sprovuar në zjarrin e luftës, duke u futur kështu në to më shumë fshatarë të varfër dhe duke u bërë ato më luftarake.



LETËR E KQ TË PKSH MBI MASAT PËR FORCIMIN E PUSHTETIT TË KËSHILLAVE NACIONAL-ÇLIRIMTARE DHE TË PARTISË, MBI QENDRIMIN KUNDREJT «BALLIT KOMBËTAR», KUNDREJT «LEGALITETIT» DHE KUNDREJT MISIONEVE USHTARAKE ANGLEZE

1 tetor 1943

SHOKUT....

për veprim gjithë komiteteve qarkore të Partisë

Ju kemi çuar disa letra; deri tani besojmë se i keni marrë dhe i keni punuar. Në këto momente paraqitet urgjente dërgimi i lajmeve dhe raporteve të tëmta nga ana juaj, sepse vetëm në këtë mënyrë do të mundim të ndihmojmë shoqi-shoqin dhe t'u japim një zgjidhje të shpejtë dhe të drejtë çështjeve që po rrokullisen.

Në radhë të parë na paraqitet çështja e pushtetit, dua të them vendosja kudo e këshillave nacional-çlirimtare, forcimi i tyre dhe mbrojtja e tyre nga çdo tentativë e «Ballit» ose e ndonjë partie tjetër, që do të përpiqet t'i sabotojë ose t'i luftojë hapiazi. Për këtë punë nuk duhet të këtë dy kuptime: vetëm pushteti i keshillave duhet të ekzistojë dhe asnjë pushtet tjetër, nuk ka kompromis dhe dualitet në këtë gjë. Për këtë shkak ne duhet të jemi të zgjuar dhe jo të flemë e ta lëmë «Ballin» të hyjë në ndonjë vend dhe atje ai të bëjë ligjin e të vetëvendosë, kurse ne të lidhim duart dhe të kënaqemi me një luftë politike. Ne këtë kohë forcat tona, që në shumë ra... duarlidhur që d... të shohin a mu... me që kanë bë... Për shembull, ... 600 bashkoru... Muka kanë ma... këi: tanë bytnë ...

Për çështjen e misioneve angleze, në qoftë se keni, qëndrimi kundrejt tyre duhet të jetë i qartë. Ato janë këtu përfaqësuese të ushtrisë angleze dhe si të tilla të përkrahin ata që luftojnë kundër okupatorit; në asnjë mënyrë ato s'kanë të drejtë të përzihen në punët tona të brendshme dhe ushtarake. T'u thuhet hapiazi qëndrimi ynë kundër «Ballit» dhe çdo partie tjetër, dhe për çdo gjë që ato do të bëjnë në favor të tyre dhe në dëshmor të luftës që bën populli shqiptar, do të jemi përgjegjës para qeverisë së tyre dhe para nesh. Në asnjë mënyrë të mos merren si arbitra për të zgjidhur çështjet tona dhe të «Ballit», këto ne i rregullojmë vetë; ato mund të veprojnë si t'u dojë qejfi, ne kemi për detyrë t'u bëjmë vërejtjet, sepse jemi në vendin tonë dhe jemi ne që bëjmë ligjin këtu; pastaj ne jemi të lirë të veprojmë ashtu si na e lyp interesi i vendit tonë, i popullit tonë dhe i luftës sonë, që është e lidhur ngushtë me luftën që bëjnë popujt e demokracive të mëdha dhe jo me ato që kërkon të bëjë misioni anglez në qarkun tuaj.

Ne i njohim kush janë amerikano-inglizët dhe nuk harrojmë për asnjë çast se ata janë kapitalistë, se ata janë kundër komunizmit, kundër socializmit; as ata nuk harrojnë kush jemi ne, por as ne nuk harrojmë kush janë ata. Tani jemi në aleancë me ta kundër fashizmit italian dhe nazizmit gjerman dhe ne i qëndrojmë besnikë kësaj aleance. Por ne nuk kemi lejuar dhe nuk do të lejojmë kurrë që ata të ndërhyjnë në punët e brendshme të Shqipërisë. E kaluara e hidhur e popullit tonë nuk do të përsëritet më. Këtë nuk do ta lejojnë PKSH dhe populli shqiptar.

Shumë të fala
Për Komitetin Qendror të Partisë
Komuniste të Shqipërisë

Shpati

Faksimile e Letrës së KQ të PKSH dërguar komiteteve qarkore të Partisë për forcimin e pushtetit të këshillave nacionalçlirimtare.




Këshillat nacionalçlirimtare të zgjedhura demokratikisht, i vetmi pushtet i popullit në Shqipëri.

Në vjeshtë të vitit 1943, për herë të parë filluan të kryenin funksione pushteti këshillat nacionaiçlirimtare në qytetet e çliruara të Gjirokastrës, të Beratit, të Peshkopisë, Pogradecit, Përmetit, Sarandës, Delvinës, Tepelenës. Në të gjitha qytetet e tjera (të pushtuara), këshillat nacionalçlirimtare vepronin në ilegalitet si organe të Frontit e të kryengritjes.



Populli zgjedh përfaqësuesit e vet në këshillat nacionalçlirimtare.





«Këshilltarët e Hekalit». **F. Haxhiu**



Nën udhëheqjen e PKSH dhe në përputhje me vendimet e Konferencës II Nacionalçlirimtare, në të gjitha krahinat e çliruara dhe në qytetet e pushtuara u formuan këshillat e Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare (BRASH). Organizimi i shëndoshë i rinisë antifashiste i dha forcë e gjallëri të paparë pjesëmarrjes së saj në lëvizjen e madhe revolucionare, që kishte përfshirë anembanë Shqipërinë.

Grupe të rinjsh komunistë e antifashistë, pjesëmarrës në Luftën Nacionalçlirimtare.





Grup grash dhe të rejgsh partizane.

Nëna dhe motra thurin veshje për luftëtarët e lirisë.




Bashkimi i Grave Antifashiste Shqiptare (BGASH) grumbulloi masën e gjithë grave të vendit tonë në luftën për çlirimin kombëtar e atë shoqëror dhe luajti një rol shumë të rëndësishëm në forcimin e Frontit Nacionalçlirimtar.

Enver Hoxha midis një grupi fëmijësh (vjeshtë 1943).

Luftëtari partizan bënte edhe detyrën e mësuesit.

Një kontribut të çmuar në Luftën Nacionalçlirimtare dhanë edhe pionierët. Ata shpërndanin shtypin e Partisë dhe të Frontit Nacionalçlirimtar, mblidhnin informata mbi armikun, kryenin detyra si ndërlidhës dhe merrnin pjesë në aksione të ndryshme luftarake. Mjaft pionierë hynë e luftuan si partizanë në rreshtat e UNÇSH.





VDEKJE FASHIZMIT LIRI POPULLIT

FLETUSHKA e PIONIERVE

E botuar Keshilli i Rinise Antifashiste e qarkut Tiranes.

Viti I-re N° I-re Nandor 1944


SHOKE E SHOQE PIONIERE!

GAZMEN E JONE E VOGEL DOLLI! AJO QE NA PO PRISHNIM PREJ KOHESH U BA. JA KU ASHT KE SHKELME, VJESHTA E VIZATIAR, MUNDOJMI, HAPESI KUDO ME KESHIU-PE NDEJJOMI! SANI I JONE NGA ÇDO ANE.


PIONIERE!.....PIONIERE?.....ATA TE VEJSELLI.....

Keshtu flet pergjli per ne me çdli dite plot gezim. Ne punojme dhe i ndihmojme te gjitho shokeve t'one ne qytete o partizanave tane ne kohe. U deftojme rruget, u japim nje kur ata jane to lodhur. Ne pionieret jemi sot ne qinda e qinda.. si partizanet vogjel ne shkobe dhe yll ne krahe ruar.

Perpiqemi qenje nuk mendonte per ne. Jemje nuk na jepte doren e te na ndihmonte. Shkollat t'one kane qene per ay e fuqe. Jemje vone dafrini per ne ndonji luftinte o ndonji gje tjeter. Keshtu ne kohen e Zogut dhe po nshtu nen Fashizem. Ne u shfaqem rrugeve dhe merrshim c'fare de rruge te koqe. Sepse qenje nuk na drejtonte dhe nuk na keshillonte.



«Ato që i kënduan Luftës» **Andon Lakuriqi**



DIREKTIVA E KQ TË PKSH PËR FORCIMIN E LIDHJEVE ME QASHKIMIN SOVJETIK, PËR QËNDRIMIN KUNDREJT «BALLIT KOMBËTAR», «LEGALITETIT» DHE MISIONEVE USHTARAKE ANGLEZE, PËR FORCIMIN E FRONTIT, TË KËSHILLAVE DHE TË USHTRISË NACIONAL-ÇLIRIMTARE, PËR FORCIMIN E PARTISË DHE TË ORGANIZATAVE TË TJERA ANTIFASHISTE

3 nëntor 1943

KOMITETEVE QARKORE TË PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

Të dashur shokë.

Ju e dini se prej kohësh situata është kthyer në favor të koalicionit antifashist. Faktori kryesor për këtë ndryshim ka qenë

Për të mbërritur në këto rezultate duhet t'ja bëjmë të qartë popullit qëndrimin tonë, mendimin e Partisë sonë, vijën politike të saj. Popullit duhet t'i tregojmë se ç'ka bërë Partia dhe ç'po bën. Duhet të popullarizojmë në kulm Partinë tonë heroike, sakrificat në gjak që ajo ka dhënë për çlirimin e atdheut; duhet të vëmë në dukje rolin udhëheqës të saj në këtë Luftë nacional-çlirimtare, ngritjen e moralit e të vullnetit të popullit tonë, gjallërinë dhe heroizmin që ajo ka ngjallur në rininë shqiptare, shpirtin e sakrificës e të organizimit, i cili është një model. Duhet, gjithashtu, të jetë e qartë në popull se ç'është lëvizja nacional-çlirimtare, ç'janë këshillat dhe ç'është Ushtria Nacional-Çlirimtare; popullit duhet t'ja bëni të qarta qëllimet e armikut dhe të reaksionit, kur këta përpiqen të konfondojnë lëvizjen nacional-çlirimtare me Partinë Komuniste. Duhet të përpiqeni që ta zgjeroni Frontin Nacional-Çlirimtar dhe në të të grumbullohet gati gjithë populli ynë, populli i ndershëm dhe luftëtar, populli që i dhimbet vatani dhe liria; me këtë mënyrë ta bindni popullin, dhe ky të shohë konkretisht se në Frontin Nacional-Çlirimtar janë grumbulluar të gjithë ata që luftojnë për interesin e Shqipërisë dhe për t'i bërë varrin okupatorit.

Me ardhjen e pushtuesve nazistë, i gjithë reaksioni u bashkua rreth tyre. Kuislingët e kallëpeve të ndryshme, «Balli Kombëtar», «Legaliteti» etj. shpresonin tani se me ndihmën e ushtrisë gjermane do ta shkatërronin Luftën Nacional-çlirimtare të popullit shqiptar. «Balli Kombëtar» — shkruante shoku Enver Hoxha në nëntor 1943 - po e lot hapët kartën e tradhtisë, ai është bërë një nga zyrat e Gestapos gjermane në Tiranë». Organizata tradhtare e «Legalitetit» bënte lojën e dyfishtë, nga njëra anë bashkëpunonte me forcat gjermane të pushtimit kundër Luftës Nacionalçlirimtare dhe nga ana tjetër mbante lidhje me misionet ushtarake angleze, të cilat nga ana e tyre përpiqeshin që të mbanin gjallë forcat dhe lëvizjet kundërrevolucionare në Shqipëri.

Faksimile e Direktivave të KQ lë PPSH për qëndrimin kundrejt «Baliit Kombëtar», «Legalitetit», dërguar komiteteve qarkore të PKSH, më 3 nëntor 1943.



VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

Buletin i "Bashkimit"

LODRAT E NAZISTAVE OKUPATORE

Balli Kombtar po e lot hapët kartën e tradhtis, ay është bër një nga zyrat e Gestapos Gjermane. Balli Kombtar bën punën e okupatorit : çetat e tij të tipit Hamit Matjani, Tefik Sfir e Aziz Çami janë në dorë të Gjermanve ashtu siç ishin në dorë të italianve Halil Alia Selim kaloshi, e Isa Toska. Ashtu si veproni me Kolonelët Clemente dhe me tankset e armikut Halil Alija e Isa Toska ashtu veprojnë edhe sot "të famëkëmcit," çetat "nacionaliste," të Ballit që përmëndëm më sipër. (Tash qi shkruajmë këtë artikull marrim vesht se çeta e Ballilit e udhëhequr prej Isa Manastirliut kyri triumfaliaht në Durrës **në mos** të duartrokitjeve të Ushtris Gjermane). Është e kotë të zgjatemi mbi kto argumente, kto s' duan komentime, lshati që digjet s' do kallauz dhe të gjith e kanë kuptuar se Balli Kombtar do të thot, tradhti. Tradhtija asht aq e hapët sa qi të gith'ata qi ngritën zërin në për kafene e Tiranës duke u reklamuar të Ballit e duke sharë ndyrë ata qi luftojnë për Lirin e Atdheut, tash e mohojnë qenien e tyre at Ball, e shajnë Ballin, pretendojnë qi s' kanë qenë kurrë antarë të tij ose kanë dhënë dorëheqjen. Të tilla gjëra ngjasin kurdoherë përpara katastrofës : vapori qi mbante emrin Balli Kombtar, po mbytet në trathti dhe mitë kanë tilluar të len vaporin. Por me mbytjen e Ballit Kombtar reaksionarët e qelbur nuk i kanë bedhur armët. Ata përpiqen të bashkoben gjetiu nën nji emër tjetër, nën nji tabellë tjetër të ilustrosur pse ajo e Ballit Kombtar hyri në Historin e Shqipnis krah për krah me Mustafa Krujën si një nga faqet më të zeza të Historis t'onë Kombtare.


Momentet janë të vështira për okupatorin gjerman dhe për reaksionin Shqiptar. Nazistave Gjermanë s' ju mjafton me pas vetëm disa vegla të verbta si Tefik Sfir, Aziz Çam e Hamid Matjan t' organizuar dhe t'udhëhequr nga nji oficjn e diskredituar e Gestapos qi quhet Ball Kombtar; ju duhet me organizu diçka të re, të freskët për të tërhequr e gënjyer popullin pas me Ballin Kombtar armiku i preu shpresat qi mund të gënjej popullin : asaj arme që përdori Bushati e Dalmazzo i dolli kallaj. Pra Gjermanët përpiqen të grumbullojnë reaksionin nën tabellën e Mehdi Beut e Fuat Beut. S' ka kush që Shqipri që të mos e ket kuptuar se tradhtarët Mehdi Frashri, Lef Nosi e Co., vegla shum ma të poshtra se i poshtri Mustafa Kruja, përpiqen të rregullojnë zonën e re të Gestapos qi do të shëndëtnoj Ballin Kombtar. Dikush mund të thot se kta njerëz kanë humbur gjykimin pse s' ka kush të mos ket kuptuar se bashkpunimi me Gjermanët të çon në trathti dhe vendin në shkatërrim më të errët që ka parë Historia. Jo, Mehdi Beu, Fuad Beu, Lef Nosi, Pateri dhe të gjith agjentët e tjerë të Gestapos s' janë të marrë, as matanë, dhe as i ka detyruar kush me kërcënim të pranojnë një gjë të tillë jasht vullnetit të tyre, por Mehdi Beu, Lef Nosi dhe gjithë pazvanët e tjerë janë trathtorë të popullit Shqiptar dhe tradhtija e tyre është konkrete. Ë shkuara e këtyre është tjetër (dhe ajo diskutohet) dhe e tashmja është trathti. Mga e shkuara e tyre kërkojnë të përtihojnë dhe Gjermanët dhe trathtarët vetë si Mehdia, Fuati e Lefi për të gënjyer dhe për-çarë. Por edhe kjo lodër nuk ju ndez, populli Shqiptar i regjur në kaq halle dhe mjerime, në kaq vojtje epërpjetje, e mer erën shpejt të dallaverës qi lshet. Mehdiu me Fuad Dibrën kujtuan se tjala e 6 Prillit dhe pak ndihma në të holla qi i ka dhënë dikur nji delegacioni Shqiptar në Paris do të gënjejnë popullin që vuan, që vritet, që gjakoset, të bedhi armët nër këmbë të barbarve nazista shkatërrimtarve të vënulit të tyre dhe të botës, mbarë; ata kujtuan se Atdheu çlirohet me nji fjalë gojë dhe më nji qind trathtira, ata kujtuan se populli dhe djalërija, do t' i ndiqte kta bukurosha qi kanë emrin Mehdi e Fuat në trathtin e tyre. Si e priti Mehdin populli shqiptar dhe djalërija që si e kërcënoi me armë e di gjithkush.

Në nji situatë të tillë, okupatori dhe reaksioni shkojnë momente të kqija pse dhe kjo kartë s' ju pi ujë; më kot po vijnë dita ditës nër sallonet e Mehdiut, Lumo Skëndot, Skënder Muçot, njerzit e Beut e të Pashës, Teki Selenicat e Aleks Mavraqët me të vetmin qëllim që të rigrumbullohen, të riorganizohen nën nji flamur, nën nji tabellë të re për të gënjyer popullin ; më kot pse tabella e fëlliqur e pse flamuri Mehdi e Fuad Bej ku flamkën e trathtis, damkën e Gestapos Hitleriane.

Armiku e peshon situatën dhe përpiqet të përdori ç' do lodër për t' i mbritur qëllimit : ay sikundër që s' kënaqet veçse me veglën Balli Kombtar, asht a'kënaqet me ilustrën e sapunit që quhet manevra Mehdi Fuad ; ai përdor taktikën e anarkis, e konfuzionit, e frikës, e terrorit, e luftës së nervave. Kjo lodër është e rrezikshme dhe mjer ay qi s' e kupton e qi gënjehet, mjer për ata qi s'janë të fortë, për ata që s'janë të vendosur, për ata që kanë qënë të shmangur nga kjo luftë titanike qi bën populli dhe qi s'kanë besim as ne vetja e tyre as në energjit e shëndoshta të popullit Shqiptar. Kta njerëz bien në kurthin q' i ngre armiku. Por ky i fredit s' mund t' i mbrij qëllimit pse populli i jonë s'është në hapin e parë politik, mbi të kanë kaluar shum valë, shum lodra e dallavere janë lojtar në kurrizin e tij është rrejzur dhe mprehur politikisht dhe kto momente për të janë të kalueshme pse nervat i ka të shëndoshta dhe vitalitetin e ka të madh, lodrën qi kërkon të lozi armiku është në gjendje t'a kuptojë mirë dhe t' a lëftojë si duhet pa u tronditur aspak dhe pa u çjerë në ferrat e rrugës.

Si vepron armiku ? Nga nji anë ai përpiqet me anën e Mehdi Beut të lidhi fillet e rjetës së prishur, të grumbullojë rreth tij gjith refugjatët e Ballit Kombtar e të reaksionit Shqiptar ; per së e di fare mirë se s' është mjalt me i grumbullu kta njerëz reth Mehdiut, Lelit, Fuadit dhe të Pater Andonit, s' është mjalt me ba pilitne n' odë kur s' të dëgjon njeri e s' të ndjek kush në rrugën e trathtisë ; duhet pa tjetër me e gënjy populln me hir e pa hir që të ndjeki qerren e Mehdiut. Armiku dha reaksioni hodh në shesh çështjen e Zogut si nji mollë grindjaje. Çështjen e Zogut e rgjeti gazeta "Atdheu", çështjen e Zogut e zë në gojë Balli Kombtar me Ali Bej Këlcyrën i cili në një tjalim publik ka thënë rekatualisht kështu : "un jam kundërshtar i Zogut, por komunistat do të më detyrojnë të bashkohem" me të, ajinoi sikur të thosh : nga inati i s' ime vjerre do të vete të flë me mullixhinë ; çështjen e Zogut e përkëdhel dhe e trumbenton Mehdi Beu, atë e trumbeton Mustafa Kruja dhe mbi të gjitha atë e lejon Gjermani të propagandohet si pa gjë si keqe. Qëllimi i armikut në këtë mes asht i qart : ay do të mbjelli anarqi dhe duke i kallur trikën popullit për

Faksimile e artikullit të shokut Enver Hoxha, botuar në gazetën «Bashkimi», në nëntor 1943.



EPOPEJA E BALLIT KOMBËTAR

NGA BUULUFCKA.

I.

U mbyt gjemija
Ke federale
O burra shpejto
Kush mund te dale

S'ka ne Parim
Ne Real Palazzo
Ja Kol Biban
Ja Sir.Dalmazzo

Na ngordhi kali
I rane thonjte;
Ç'po vrapon Balli
T'i heq potkonjte.

Flet Ali Beu:
Luft per Atdhe!
Se zot Atdheu
Fret shum nga né.

Na vlen bder deja
Ofiqe shqiptari
Ke dorezue kurre
Ngjeshtu burrari.

Fashizmi i krisur
Ke na trathtare
Ka shkeli vatrak
Ze bere varre

Ngrihi t'i bien
Qaqanor plak,
Se Shqiperija
S'lind dy pa djak...

Pa kur t'i shohesh
Derven dervenet
Ne vend te pushkes
Gota dhe cmo.

Jeke te ngrira,
Pantofla, gonte
Pizhme, kapulla,

Do bejme lufte?
De more de
Si lum ti populli
Kezi na ke.

Pa nie dollija
Theren kurbanet;
Vardha rakija
Posht italianet?

Pije me fund
Te kam rixha:
Shendet' i flamurit
S'i thone shaka.

Do bejme lufte
Do tundem malet...
Dhe fshati qeshet
Dhe bota tallet;

Dhe vendi pyet:
Ç'vajzor i solli?
Ku ish gjor dit
Kjo fnre

Ç'thue ti Daj Cen
Ti gja o vllaz
K'tahet
Ne tevel

Do bejme lufte
Me armiqt barbare;
S'kini ku futi
Gridhi trathtare!

Kush jan trathtaret?
Shehin e bejme
Te marrim frenat
Fustaj i gjejme.

E bane lufton
Me pulaatrena
Dash duen dhe frena
Gjemon Daj Cena.

.....
Pellemb' e gjak
Andej m'at ane
Luftojne trimat
Nij Partizane

Prej vjoteh ne popul
Ne luft' ne sjarr
Ma' grusht imperen
E shtin' ne varr.

As buk' As uje
As recke veshur
Kepucet qqyer
Po armet gjeshur.

Nga lufta sthejne
Shkumbenjsh tebeje
Ne gas ne buze
Ne kong' ne gojo....

Pa dale shoke
Degjehet zhurme!
Ku vete valle
Ky varg,kjo turme?

Kush po na vjen
Si varg rebelash
Ne kaq argjent
Shirk (1) pse te


Na qenka Balli!
Dale,pa dale...
E ç'kerkon Balli
Kaq vone ne male?

Del Lumo Skendua
(Aljaz Kit'hasi)
Me
Prej diplomasi.

Sot djem
Per lufte vigane
B'duron Shqiptari
Sgjedh' italiane

(1) Shirk = Kush.kofin.

Abaz Kupi, i zgjedhur anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar në Konferencën e Pezës dhe më vonë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, kishte hyrë në Frontin Nacionalçlirimtar me qëllim që të minonte udhëheqjen e Partisë Komuniste dhe t'i imponontе Frontit dhe Ushtrisë Nacionalçlirimtare politikën dhe strategjinë britanike. Si nuk ia arriti dot këtij qëllimi, fill pas kapitullimit të Italisë, ai doli nga Fronti dhe krijoi, me ndihmën e misioneve ushtarake angleze, «Partinë zogiste», që u shndërrua në «Legalitet». Njëkohësisht ai u shpall kundërshtar i Frontit Nacionalçlirimtar dhe nuk vonoi të hynte në bashkëpunim me pushtuesit gjermanë dhe me qeverinë kuislinge për të shuar Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Për shkak të kësaj tradhtie, Këshilli i Përgjithshëm e përjashtoi atë nga radhët e tij dhe të Shtabit të Përgjithshëm (dhjetor 1943), duke e shpallur «Legalitetin» organizatë tradhtare.




REZOLUCION I KRYESISË SË KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM NACIONAL-ÇLIRIMTAR MBI PËRJASHTIMIN E ABAZ KUPIT NGA KËSHILLI I PËRGJITHSHËM

7 dhjetor 1943

REZOLUCION
I KRYESISË SË KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM NACIONAL-ÇLIRIMTAR MBI PËRJASHTIMIN E ABAZ KUPIT NGA KËSHILLI I PËRGJITHSHËM NACIONAL-ÇLIRIMTAR. APROVUAR NË MBLEDHJEN E JASHTËZAKONËSHME TË 7 DHJETORIT 1943

Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar konstaton se anëtari i Kryesisë Abaz Kupi ka nisur të largohet fare nga Lëvizja jonë që nga kapitullimi i Italisë dhe Konferenca e dytë Nacional-Çlirimtare, atëhere kur fryma reaksionare e «Ballit Kombëtar» doli fare sheshit dhe ne u detyruam të marrim një qendrim të prerë dhe kategorik kundrejt reaksionit. Abaz Kupi edhe përpara mbante në radhët tona një pozitë jo të qartë dhe përfaqësonte një tendencë pak a shumë oportuniste. Ai ka bërë kurdoherë në radhët tona një politikë personale, një politikë bajraku që është në kundërshtim me karakterin nacional, demokratik e popullor të Lëvizjes sonë. Ka pasur frikë prej një organizimi të vërtetë dhe gjithnjë ka sabotuar organizimin e Këshillave në ato rrethe ku ka influencë personale, si Mati e Kruja. Në pikëpamjen ushtarake Abaz Kupi ka mbajtur kurdoherë format bashibozuke të çetave, çeta vendi të frymëzuara me parullën: «kur të vijë koha». Që nga Konferenca e Pezës, ku qe vendosur të goditej armiku okupator me aksione ushtarake të paprera, ai nuk ka bërë veçse një luftë demostrative ose difensive, ose luftë për të mbajtur autoritetin dhe prestigjin e tij personal (p.sh., lufta e Krujës). Ai kurrë nuk e ka kuptuar rëndësinë e një lufte të paprerë dhe të organizuar.


Faksimile e Rezolucionit të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar mbi përjashtimin e Abaz Kupit nga Këshilli i Përgjithshëm.



Faksimile e një raporti të komandantit të trupave gjermonë në Shqipëri, gjeneralit Fen, dërguar eprorëve të tij, ku tregon se «Bandat nacionaliste shqiptare (balliste) japin një ndihmë efikase kundër komunistëve» dhe prandaj është i mendimit që të shtohen ndihmat në armatime e veshmbothje për bandat e «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit» dhe për forcat e qeverisë kuislinge.









Ylbere Bilibashi.
Heroinë e Popullit.

Më 9 tetor 1943, në fshatin Ballhaxhias të Pezës, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH u formua Brigada III Sulmuese me partizanë të qytetit e të qarkut të Tiranës.

Partizanë të Brigadës III Sulmuese në marshim.

Robër gjermanë të kapur nga forcat partizane të Brigadës III Sulmuese.



Enver Hoxha me luftëtarë të Brigadës II Sulmuese
në ditën e inaugurimit.



Kozma Naska.
Hero i Popullit.



Në fshatin Shëngjergj të Tiranës, më 28 nëntor 1943, u formua Brigada II Sulmuese me partizanë të rretheve të Tiranës, Elbasanit e të Beratit etj.



Partizanë të Brigadës II Sulmuese në marshim.


Pamje nga inaugurimi i Brigadës II Sulmuese.



Shokët Enver Hoxha dhe Spiro Moisiu drejtojnë veprimet luftarake të forcave partizane.

Komanda e trupave gjermanë të pushtimit zhvilloi një varg operacionesh ushtarake në dimrin e vitit 1943-1944, që të asgjësonte Ushtrinë Nacionalçlirimtare, të shkatërronte këshillat nacionalçlirimtare dhe Partinë Komuniste të Shqipërisë. Rreth 40 mijë ushtarë gjermanë, të gjitha bandat e ballistëve, të qeverisë kuislinge, të zogistëve etj. morën pjesë në këto operacione. Lufta Nacionalçlirimtare kaloi në dimrin 1943-1944 provën më të rëndë. Në këtë provë doli fitimtar populli kryengritës shqiptar, Fronti dhe Ushtria Nacionalçlirimtare me Partinë Komuniste në krye. Plani i armiqve pësoi dështim të plotë.

Rol vendimtar në dështimin e mësymjes së përgjithshme armike në dimrin e vitit 1943-1944 luajti udhëheqja e drejtë dhe energjike e KQ të PKSH, e Shtabit të Përgjithshëm dhe personalisht e shokut Enver Hoxha.



Mësymja e përgjithshme armike e dimrit 1943-1944 (nëntor 1943 - shkurt 1944).











Terrori i egër i armikut, uria dhe mjerimet në dimrin e viteve 1943-1944, nuk e ndanë poputlin kryengritës shqiptar nga Partia Komuniste dhe Fronti Nacionalçlirimtar, nuk e mposhtën vullnetin e tij të çeliktë për të luftuar dhe për të fituar. Populli u lidh edhe më tepër me Partinë dhe Ushtrinë e tij Nacionalçlirimtare.





Tenda e Qypit **F. Haxhiu**





Enver Hoxha, në ditët e kundërmësymjes partizane, në dimër të vitit 1943-1944.

Komiteti Qendror i PKSH dhe Shtabr i Përgjithshëm i UNÇSH me shokun Enver Hoxha në krye me anën e anëtarëve të vet, që i kishin shpërndarë nëpër zonat e ndryshme të vendit, ndiqnin zbatimin e urdhrave dhe të udhëzimeve, që kishin dhënë më parë, bënin vlerësimin e situatave nga ana ushtarake e politike dhe jepnin udhëzime të reja të nevojshme. Asnjëherë nuk u ndërpre kontrolli, ndihma dhe udhëheqja e tyre me gjithë kushtet jashtëzakonisht të rënda.







Brigada IV Sulmuese u formua më 28 dhjetor 1943, në Voskopojë, me partizanë të qarkut të Korçës, në kulmin e mësymjes së përgjithshme armike të dimrit 1943-1944.

Luftëtarë dhe kuadro të Brigadës IV Sulmuese. Në foton 2, shoku Rita Marko, i treti nga e majta, në këmbë; Josif Pashko i treti nga e majta, ulur.





Hysni Kapo, komisar i Brigadës V Sulmuese. Hero i Popullit.

Ka dita rasta gë jam thëmeltare të historisë e luftës sonë e të ndërtimit sonë, dhe një nder këto të tilla krijimi i Brigadës së 5të, e cila u mbulua me laade gjaku gjithë luftëtarë të saj. Në Brigadën e 5të, të formuar nga djem më të mirë të Vlorës, dhe të Labërisë, Ulza shkon të një nga formacionet e ushtrisë së organizuar, shkon kuadër e madhe Partisë, shkon sigurisë e ftuar.

Enver Hoxha



Pamje nga inaugurimi i Brigadës V Sulmuese.



Abaz Shehu, Dervish Hekali, Llambro Andoni Laze Nuro, Hysen Çino, Zonja Çurre, Nimete Progonati. Heronj të Popullit.

















Luftëtarë dhe kuadro të Brigadës V Sulmuese, midis të cilëve shokët hysni Kapo (i treti nga e djathta në këmbë), Manush Myftiu (i treti nga e djathta, ulur), Shefqet Peci (i dyti nga e majta, në këmbë), Kadri Hazbiu (i treti nga e djathta, në këmbë).

Luftëtarë dhe kuadro të Brigadës V S.



Më 20 janar 1944, u inaugurua Brigada V Suimuese në Tërbaç me luftëtarë të qarkut të Vlorës. Për luftën e saj me vetëmohim dhe heroizëm të lartë kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve i është dhënë titulli «Hero i Popullit», me këtë motivacion:

«Për luftën e saj me vetëmohim dhe heroizëm të lartë kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve, për kontributin e shquar që ajo ka dhënë në çlirimin e atdheut dhe në vendosjen e pushtetit popullor.

Ajo i ka përmbushur kurdoherë me trimëri të pashembullt, me besnikëri të pakufishme detyrat e mëdha luftarake e politike ndaj popullit e Partisë dhe ka treguar në të njëjtën kohë një frymë të thellë të internacionalizmit proletar, kur Komandanti i Përgjithshëm e ngarkoi atë të shkonte tok me njësi të tjera të Ushtrisë Nacionalçlirimtare për të ndihmuar në çlirimin e popujve të Jugosllavisë...»



Brigada VI Sulmuese u formua më 26 janar 1944 me partizanë të Zonës I Operative Vlorë-Gjirokastër. Për plotësimin me heroizëm të lartë dhe me vetëmohim të detyrave të saj të mëdha luftarake e politike i është dhënë titulli «Hero i Popullit», me këtë motivacion: «Për plotësimin me heroizëm të lartë dhe me vetëmohim të detyrave të saj të mëdha luftarake e politike, për kontributin e shquar në çlirimin e atdheut nga pushtuesit fashistë e tradhtarët dhe në vendosjen e pushtetit popullor. Ajo ka luftuar gjithnjë me trimëri të rrallë dhe ka treguar një besnikëri të pakufishme ndaj popullit e Partisë, duke korrur fitore të shkëlqyera mbi armiqtë dhe duke mbajtur gjithnjë lart emrin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ajo ka kryer gjithashtu me nder dhe me një frymë të thellë internacionalizmi detyrën që i ngarkoi asaj Komandanti i Përgjithshëm tok me njësi të tjera të UNÇSH, për të ndihmuar në çlirimin e popujve të Jugosllavisë».



Mustafa Matohiti (nga e djathta), komisar i Brigadës VI Sulmuese, Heroi i Popullit. Haki Toska, zëvendëskomisar i Brigadës VI Sulmuese.

Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës VI Sulmuese.





Jaho Gjoliku, Meleq Gostinishti, Lefter Talo, Fato Berberi, Çelo Sinani, Mitro Xhani. Heronj të Popullit.



Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës VI Sulmuese.






Shoku Enver Hoxha (i pari nga e majta) në ditët e para të janarit 1944.

Pas operacionit të pushtuesve gjermane në Shqipërinë e Mesme, një gjendje shumë e rrezikshme u krijua për udhëheqjen e KQ dhe të Shtabit të Përgjithshëm me shokun Enver Hoxha, që mbeti e bllokuar në zonën Çermenike, Shëngjergj, Martanesh. Nazistët e tradhtarët nuk lanë mjet pa përdorur për të zbuluar dhe asgjësuar udhëheqjen e Luftës Nacionalçlirimtare. Por ata nuk mundën. Shumë fshatarë i dinin bazat ku strehohej ajo, por asnjëri nuk u frikësua nga kërcënimet e armiqve dhe nuk e tradhtoi Partinë Komuniste dhe Shtabin e Përgjithshëm. Shoku Enver me udhëheqësit e tjerë të Partisë e të popullit përballuan me heroizëm e gjakftohtësi vështirësitë e jashtëzakonshme dhe me ndihmën e fshatarëve patriotë dolën nga rrethimi pa pësuar dëme.

Edhe në kushtet e rrethimit, udhëheqja e Partisë dhe e Shtabit të Përgjithshëm mbajti lidhje të vazhdueshme me komitetet qarkore të Partisë, me shtabet e qarqeve dhe të njësive të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Këto lidhje mbaheshin duke kapërcyer një mijë pengesa e rreziqe. Korrierët, që bënin ndërlidhjen, kanë kryer një punë heroike, plot vetëmohim e theror.



GAZETA ZYRTARE 1 DHJETOR 1945 Nr. 76

VENDIM Nr. 166 d. 23-11-1945

për dhenie dekoratash disa personave

Urdh rin e Trimërisë

Për të shpërblyer në mënyrë të meritu**ar**
ata që gjatë ofendivës së dimrit me guxim e
abnegacion strehuan dhe udhëhoqën nëpër mes
zonash të re zikëshme Gjeneral Kolonel Enver
Hoxhën dhe Shtabin e tij;

Në bazë të propozimit të Kry tarit të Qe
verisë dhe Komandant' i Përgjithshëm i Ushtërisë
Kombëtare të Shqipëri ë;

Kryesija e Këshillit Antifashist Nacional-
Çlirimtar

V e n d o s i :

I.

Të d korohen me Urdhërin e Trimërisë
personat e poshtë hënuem:

1) Zoti Sami Babolli, 2) Zoti Halil Buzhiçi nga katundi Shmil i Elbasanit, 3) Zoti Ali Disha nga katundi Shmil i Elbasanit, 4) Zoti Sherif Çeka nga katundi Shmil i Elbasanit, 5) Zoti Ali Gjura nga katundi Shmil i Elbasanit, (6 Zoti Ram Karagjozi nga katundi Shmil i Elbasanit, 7) Zoti Jaho Kalija nga katundi Fush-Bull i Elbasanit, 8) Zoti Muço Boduri nga katundi Shushicë i Elbasanit, 9) Zoti Ymer Çoba nga katundi Kaligat i Elbasanit, 10) Zoti Fon Deda nga katundi Nezhan i Elbasanit, 11) Zoti Belul Bicaj nga katundi Nezhan i Elbasanit, 12) Zoti Kadri Mu aj nga katundi Kishtë i Elbasanit, 13) Zoti Tare Qurmishi nga katundi Bulçar i Elbasanit, 14) Zoti Jakup Kule nga katundi Gop sh i Elbasanit, 15) Zoti Qazim Pe bku nga katundi Kostenj Elbasanit, 16) Zoti Jashar Muça nga katundi Kostenj Elbasan, 17) Zoti Qazim Aliu nga katundi Val Martanesh, 18) Zoti Imer Koçi nga katundi Oshtun Elbasan, 19) Zoti Beqir Koçi (dëshmor) nga katundi Orenj Elbasan, 20) Zoti Miftar Hoxha nga katun i Urë e Haxhibeqirit, 21) Zoti Ali Strori nga katundi Strorë Elbasan, 22) Zoti Qazim Koçi nga katundi Shushicë Elbasan. 23) Zoti Nok Tollumi nga katundi Trepshenisht Elbasan, 24) Zoti Sadik Balla nga katundi Orenjë Elbasan.

II.

Ky Vendim hyn në fuqi me nji herë.

Tiranë, me 23 11- 945.



Nënë Zyhraja nga Orenja e Çermenikës.




Kasollja e Galigatit në Shpat të Elbasanit.




«Çajmë rrethime» **F. Haxhiu.**

Në kuadrin e mësymjes së UNÇSH një vend të posaçëm zë marshimi heroik i tre batalioneve të Brigadës I Sulmuese, me shokun Mehmet Shehu në krye, në shkurt-mars 1944, nga jugu, thellë në zonat e kontrolluara prej armiqve, në veri të Shkumbinit, për f i ardhur në ndihmë komandës së Shtabit të Përgjithshëm dhe udhëheqjes së Komitetit Qendror të Partisë me shokun Enver Hoxha, të bllokuar në Çermenikë. Vlerësimin e këtij marshimi e ka dhënë shoku Enver Hoxha: «Inkursioni i Brigadës I thellë në zonat më reaksionare, që, me një marshim të shpejtë dhe plot rreziqe... kalon si rrufe nëpërmjet Skraparit, Mokrës, Çermenikës, Gollobordës, Martaneshit, Shëngjergjit, Pezës, Dumresë, Sulovës për t'i ardhur në ndihmë Shtabit të Përgjithshëm, ishte shprehja e besimit dhe e besnikërisë së ushtrisë sonë ndaj Komitetit Qendror të Partisë dhe Sekretarit të Përgjithshëm të saj; ky ishte njëkohësisht dhe një diversion në shkallë të gjerë, që tronditiarmikun duke mos lejuar rifillimin e shpejtë të një operacioni të dytë nga forcat reaksionare në Shqipërinë e Mesme; ky forcoi besimin e popullit dhe shkatërroi demagogjinë e armikut, që trumbetonte se u shkatërrua Ushtria Nacionalçlirimtare-.





Shoku Mehmet Shehu në ditët e marshimit të tre batalioneve të Brigadës I S.



Pamje nga marshimi heroik i tre batalioneve të Brigadës I Sulmuese.



Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës VII Sulmuese. Në foton 1, shokët: Adil Çarçani, zëvendëskomisar (i 6-ti nga e djathta, në këmbë), Ramiz Alia përgjegjës i rl-nisë i Brigadës VII S (i 6-ti nga e djathta, ulur).



Pamje nga inaugurimi i Brigadës VII Sulmuese.

Brigada VII Sulmuese u formua më 17 mars 1944, në fshatin Vlush të Skraparit, me partizanë të qarkut të Beratit, si edhe nga një numër partizanësh nga qarku i Gjirokastrës dhe i Korçës.



Në rrethanat jashtëzakonisht të vështira, që shkaktoi mësymja e përgjithshme armike në dimrin 1943-1944, rreziku më i madh ishte të binte fryma luftarake sulmuese e reparteve dhe njësive partizane dhe të krijohej kështu ndjenja për një pushim, për një çlodhje pas operacionit. Komiteti Qendror i Partisë dhe Shtabi i Përgjithshëm e mënjanuan një rrezik të tillë duke kërkuar nga Ushtria Nacionalçlirimtare të hidhej papritur në kundërmësymje.

Kundërmësymja e reparteve të UNÇSH e zhvilluar me sukses në janar-shkurt-mars 1944, solli si përfundim çlirimin e të gjitha krahinavetë pushtuara gjatë operacionit armik në Shqipërinë e Jugut.

Edhe në krahinat e tjera të Shqipërisë së Mesme e të Veriut, pushtuesit hitlerianë dhe tradhtarët nuk mundën ta shuanin Lëvizjen Nacionalçlirimtare, megjithëse këto krahina qëndruan edhe për një kohë të pushtuara nga armiqtë. Aty vepronin pa pushim njësitet partizane dhe shumë këshilla nacionalçlirimtare.



Mësymja e UNÇSH në pranverë të vitit 1944 (prill-maj 1944). UNÇSH në prill-maj të vitit 1944 numëronte në radhët e saj 35000 partizanë.

Brigada VIII Sulmuese u formua më 25 prill 1944, në Sheper të Zagorisë me partizanë të Zonës I Operative Vlorë-Gjirokastër.



Theodhori Mastora.
Hero i Popullit.



Pamje nga inaugurimi i Brigadës VIII Sulmuese.

Luftëtarë dhe kuadro të Brigadës VIII Sulmuese.






Në fshatin Sukë të rrethit të Përmetit, më 20 maj 1944, u formua Brigada XII Sulmuese me partizanë të Zonës I Operative Vlorë-Gjirokastër.


Luftëtarë e kuadro të Brigadës XII Sulmuese.



Dulet me kujue sa më parë zyrëu informative
dhe informatat të vinë sa me parë dhe të sakta.

Shpati





KOMANDA E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM
TË USHTRISË NACIONAL-CLIRIMTARE
SHQIPTARE

Date 18/VII/44

32.

QARKORE

Në vijën e parë ai dhe ai vendet e tjera që rrinë trupat dhe që punushtifet ushtarake e ndenji zanyjes ushtke e ai q'do vend tje-tër,të ndrrven roje në vendet dominuese të atmie dhe kto roje të kontrollohen shpesh herë dhe ndonse natën.

Rojet dikën emnë të bryhen prej ajli rojtari per natën dukat të jenë dy veta(çifte).

Në ushtrimet t'tanë ka rhet mundsija shkuktue prej Ushtrisë Italiane se ndë ka nevoja për roje natën per vet ka kuhuenë shkaqi ata vegetonin vetëm në ndrrjen.Ka lloj mundsije dukat të shkuktet ne për ndrrjen ne natën e konfrontmeve në ndrrjen që i b'ri nepet ne kupton se nse ne ru në befasi q'do regart dukat ne pus roje dhe se kto dukat të vejnë gjith kujdesin e tyne dhe të ikrpetkohen shpesh ndonse natën.dhe atu që të gjenden në gjumë të dinehen pa ndrrë,shpesh ajli roje ka në dorë shpëtimin dhe shkuktrimin e ajli regarti dhe nga ndenji herë të shmë regartave tjerrit të ofiqit tne ditë që puru ka trupa në vijën e parë dhe rrinë pe thuaj ne të qetë nga befasija.

Dse shkëmbimi për atu që nuk e kryejnë ne kujdes detyrën e rojes në se dmnë që gjatë t shukve dhe nmdë i popullit në kto lëvizje të nse shkoj në.

Vëzhje Pushimit - Liri Popullit

Këshilltari Politik
(Enver Hoxha)

Komandanti Shtabit të Përgjithshëm
t'Ushtrisë Nacional-Clirimtare Shqiptare
(Najar Spiro Koleka)

Faksimile e Qarkores së Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH mbi shërbimin e rojes.

Shoku Enver Hoxha me luftëtarë të shërbimit të rojes pranë Shtabit të Përgjithshëm.

Kompania e shërbimit të rojes pranë Shtabit të Përgjithshëm.





Ali Demi, Manush Alimani, Qeriba Derri, Persefoni Kokëdhima, Bule Naipi, torturuar për vdekje në burgjet e Gestapos. Heronj të Popullit.

Terrori i egër dhe masakrat çnjerëzore jo vetëm nuk e ndërprenë qëndresën e popullit në qytete, përkundrazi shtuan urrejtjen, dhe kjo qëndresë u forcua dhe u zgjerua më shumë. Organizatat e Partisë dhe njësitet guerile, me aksionet dhe veprimet luftarake, u bënë shpirti i papërkulshmërisë së popullit në qytete. Djegia e depove, vrasja e spiunëve, shpërndarja e trakteve mbanin lart moralin e popullit dhe shkaktonin panik në strofkat e armiqve.


Lufta në qytete luajti një rol shumë të rëndësishëm në arritjen e fitores përfundimtare të Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Pas mësymjes pranverore të UNÇSH u çelën perspektiva të qarta për çlirimin e qyteteve.



Një moment nga lufta në qytete.




«Atentatori». **S. Papamihali.**



«Heroinat Bule Naipi e Persefoni Kokëdhima» **L. Dhrami**

Më 24 maj 1944 u mbajt Kongresi I Antifashist Nacionalçlirimtar në qytetin e Përmetit, i cili themeloi shtetin e ri shqiptar të demokracisë popullore. Kongresi zgjodhi Këshillin Antifashist Nacionalçlirimtar, si trupin më të lartë legjislativ dhe ekzekutiv në Shqipëri, si përfaqësuesin e sovranitetit të popullit e të shtetit shqiptar. Këshilli Antifashist i zgjedhur në Përmet ishte Kuvendi i parë Popullor i Shqipërisë. Kongresi krijoi gjithashtu Komitetin Antifashist Nacionalçlirimtar me atributet e qeverisë së përkohshme. Komiteti Antifashist ishte qeveria e parë demokratike popullore e Shqipërisë. President i Komitetit u emërua Enver Hoxha, Sekretar i Përgjithshëm i PKSH.





Shoku Enver Hoxha duke mbajtur raportin në Kongresin e Përmetit.



RAPORT
NË KONGRESIN I ANTIFASHIST
NACIONAL-ÇLIRIMTAR[1]

24 maj 1944

ZHVILLIMI I LUFTËS NACIONAL-ÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR NË LIDHJE ME NGJARJET NDËRKOMBËTARE

Populli shqiptar, i shtypur ekonomikisht dhe politikisht, i shfrytëzuar deri në palcë prej regjimit policor të Zogut, u gjend i izoluar politikisht nga bota e jashtme dhe i dezorientuar; kur ushtritë fashiste italiane sulmuan vendin tonë më 7 prill të vitit 1939.

Xhelati i popullit shqiptar, Ahmet Zogu, që urrehet nga mbarë populli ynë, sepse, i ardhur në fuqi me forcë kundër vullnetit të popullit, gjatë sundimit të tij

Kongresit të sotëm, të dalë nga vullneti sovran i popullit dhe që përfaqëson gjithë shtresat e shoqërisë sonë, i bie barra e rëndë, por glorioze, të marrë të gjitha masat e duhura, i ngarkohet të krijojë organe të tilla popullore, politike, legjislative si dhe ekzekutive, të cilat do të dalin nga ky kongres dhe do të jenë në gjendje të kapërcejnë çdo pengesë që do t'u dalë përpara, do të përfaqësojnë ashtu siç duhet popullin shqiptar, si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë, dhe do të jenë të afta të ndalojnë çdo tentativë, të bërë nga çdo anë qoftë dhe që do të ketë për qëllim mosrealizimin e dëshirave, për të cilat populli ynë po lufton dhe po derdh kaq gjak në këtë luftë të madhe çlirimtare.

Përfaqësuesve të popullit që përbëjnë këtë kongres historik u bie barra e shenjtë të zgjedhin Këshillin Antifashist Nacional-Çlirimtar, i cili do të jetë trupi më i madh legjislativ dhe ekzekutiv nga do të dalë Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar, organ ekzeku-

Faksimile e Raportit të shokut Enver Hoxha mbajtur në Kongresin e Përmetit.

DEKLARATË

Dita 24 Maj,ditë e madhe historike për popullin shqiptar. Në këtë fazë të lavdishme të luftës s'onë nacional-çlirimtare,në qytetimin e lirë të Përmetit,u mbloth Kongresi i I-rë Antifashist Nacional-Çlirimtar,i cili kurorëzon luftën heroike të popullit t'onë.Për të parën herë në historinë e tij populli shqiptar dërgon delegatë të zgjedhur demokratikisht,delegatë të dalë nga lufta që ka bërë populli i ynë kundër armikut okupator dhe tradhtorëve të vëndit.Për të parën herë populli shqiptar çfaq solemnisht vullnetin e tij të lirë e demokratik .

Në luftën e tij të ashpër e të përgjakëshme populli shqiptar ka korbr suksese të mëdha e të lavdishme,ka hedhur bazat e shëndosha të pushtetit të tij demokratik,ka formuar e forcuar ushtërimë e tij popullore nacional-çlirimtare. Tentativave të armikut për të shkatërruar Lëvizjen Nacional-Çlirimtare,populli u është përgjegjur duke forcuar gjithënjë më tepër Frontin Nacional-Çlirimtar e duke shtërnguar më tepër radhët e lavdishme të ushtërisë s'onë.

Janë formuar bataljone e brigada dhe janë duke u formuar divizione. Këto formacione të mëdha ushtarake janë bërë themra i armikut. Zona të gjëra po çlirohen dita ditës.

Tre ministrat e jashtëm të aleatëvet t'one,Eden,Molotov,Hull, na e njohën solemnisht të drejtën që të jemi indipendentë. Fatkeqësisht në botën e jashtëme lufta e jonë nuk çmohet akoma si duhet,po neve shpresojmë se për së shpejti,të gjithë miqtë t'onë do të mundin ta shohin më sirë këtë gjë. Edhe qeverija italiane deklaroi se nuk ka asnjë aspiratë mbi Shqipërinë.

Kongresi i I-rë Antifashist Nacional-Çlirimtar ka një rëndësi të jashtëzakonëshme,sepse nga ky del Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar,organi suprem legjislativ dhe ekzekutiv i popullit t'onë dhe Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar,organi ekzekutiv kryesor me atributet e një qeverije provizore.

Në këto momente historike ne kaqë rëndësi për vëndin t'onë, Kongresi cakton vijën e drejtë të politikës e të luftës s'onë, e ci sot me proporcionet që ka zanrë e mëdha që ka marrë,kërkon një udhë heqje të re për të çfrytezuar me mënyrë të plote suksesët e lëvizje nacional-çlirimtare.

KONGRESI I I-rë ANTIFASHIST
NACIONAL-ÇLIRIMTAR I SHQIPËRISË

VENDIME Nr. 1 dt. 27 Maj 1944

Kongresi i I-rë Antifashist Nacional-Çlirimtar zgjodhi Këshillin Antifashist Nacional-Çlirimtar,si trupin kryesor Legjislativ dhe ekzekutiv që përfaqëson sovranitetin e popullit dhe të shtetit shqiptar.

Kongresi i jep të drejtë Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar që të formojë Komitetin Antifashist Nacional-Çlirimtar me të gjitha atribute e një qeverije të përkohëshme popullore,me anën e të cilit Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar realizon funksionin e tij ekzekutiv.

I .

Të ndërtohet Shqipëria e re demokratike popullore,sipas vullnetit të popullit që sot e sharrë solemnisht në Këshillin Antifashist Nacional Çlirimtar,i cili është një pushtet me të vërtetë popullor,i dalë nga lufta nacional-çlirimtare që po bën populli shqiptar .

II .

I ndalohet Zogut hyrja në Shqipëri,me qënë se çështja e regjimit do të vëndoset nga populli me vullnetin e tij pas çlirimit të gjithë vëndit t'onë.

III .

Të mos njihet asnjë qeveri tjetër që munt të formohet brënda ose jashtë Shqipërisë kundra vullnetit të lirë të popullit shqiptar,të cilin e përfaqëson vetëm Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar .

IV .

Kongresi vëndos solemnisht që të vazhdohet më ashpër lufta kundër okupatorit dhe shërbëtorëve të tij,dhe të mos lejohet në asnjë mënyrë që nga provokacionet e manevrat e ndryshme politike të okupatorit dhe të reakcionit të largohemi nga ky objektiv .

V .

Të vazhdohet edhe më e rreptë lufta e filluar prej popullit shqiptar kundër të gjithë tradhtorëve të gjumbulluar rreth qeverisë kuislinge të Tiranës,Ballit Kombëtar,Legalitetit e të tjerë,dhe kundra çdo klike tjetër reakcionare që eventualisht mund të paraqitet më vonë,gjer në çkatërrimin e plotë të tyre dhe në vëndosjen e Shqipërisë së lirë demokratike popullore .

VI .

Aprovon vijën e drejtë politike që ka ndjekur Këshilli i Përgji - këshës Nacional-Çlirimtar në luftën e ashpër kundër okupatorit dhe të gjithë klikave reakcionare të vëndit t'onë;aprovon gjithë direktivat e dhëna prej tij gjer më sot .

VII .

Aprovon të gjitha udhëzimet që ka dhënë Shtabi i Përgjithëshëm për ngritjen e kuadrove politike e ushtarake,për formimin e konshiencës politike të Ushtrisë s'onë Nacional-Çlirimtare,e cila sot,e ndërgjegjëshme për detyrën që ka karshi popullit,do të vazhdojë luftën gjersa gjithë Shqipëria të çlirohet prej okupatorit dhe trathtorëve .


VIII .

Kongresi çfaq dëshirën që të dërgohen dhe prej Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës misione ushtarake pranë Shtabit të Përgjithëshëm .

Kryetari
(Dr. Omer Nishani)

Faksimile e Deklaratës së Kongresit I Antifoshist Nacionalçlirimtar dhe e Vendimit Nr. 1, më 27 maj 1944.

Shoku Enver Hoxha, President i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar me Omer Nishanin (i treti nga e djathta) kryetar i Këshiliit Antifashist Nacionalçlirimtar, Medar Shtyllën (i pari nga e djathta) anëtar i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe Spiro Moisiun (i pari nga e majta) Shef i Shtabit Madhor të UNÇSH.



KRYESIJA E KËSHILLIT ANTIFASHIST
NACIONAL-ÇLIRIMTAR TË SHQIPËRISË

1

VENDIM Nr6 dt 28. Maj 1944

i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë.

I.

Kryesija e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar,në bazë të propozimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Partizane Vullnetare Nacional-Çlirimtare,emëron ENVER HOXHËN Komandant të Përgjithshëm të Ushtrisë Partizane Vullnetare Nacional-Çlirimtare.

II.

Kryesija,në bazë të propozimit të Shtabit të Përgjithshëm,vendosi të gradojë në:

ENVER HOXHA -Gjeneral-Kolonel,Komandant i Përgjithshëm.

SPIRO MOISIU-Gjeneral-Major,Shef i Shtabit Madhor.

28.V.1944
Tiranë

KRYETARI
(Dr.Omer Nishani)

Faksimile e Vendimit të Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar mbi emërimin e shokut Enver Hoxha Komandant të Përgjithshëm të UNÇSH.



Pamje nga zhvillimi i punimeve në Kongresin I Antifashist Nacionalçlirimtar.



Shtrirja e organizatave të BRASH, BGASH, të Këshillave nacional-çlirimtare, njesive guerile etj. në maj 1944.

KËSHILLI I PËRGJITHSHËM ANTIFASHIST
NACIONAL-ÇLIRIMTAR

26 maj 1944

V E N D I M E

TË MBLEDHJES SË PARË TË KËSHILLIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR

I.

Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar, i cili është trupi kryesor legjislativ dhe ekzekutiv që përfaqëson sovranitetin e popullit dhe të Shtetit Shqiptar për kohën e Luftës Nacional-Çlirimtare, zgjodhi Kryesinë e tij, e cila përbëhet prej Presidentit, tre nënpresidentave, dy sekretarëve dhe njëzet e katër anëtarëve.

II.

Kryesia e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar përfaqëson në emër të Këshillit sovranitetin e popullit dhe të Shtetit Shqiptar dhe ushtron funksionin e tij legjislativ dhe ekzekutiv nga një mbledhje te tjetra e Këshillit, para të cilit jep llogari për punën e saj.

III.

Kryesia e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar emëron Komitetin Antifashist Nacional-Çlirimtar, i cili përbëhet prej Presidentit, dy nënpresidentave dhe njëmbëdhjetë të ngarkuarve me punë.

IV.

Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar ka të gjitha atributet e një qeverie popullore provizore. Për punën e tij Komiteti është përgjegjës përpara Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar.

V.

Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar është organi më i madh ekzekutiv dhe urdhërdhënës i pushtetit popullor në Shqipëri, me anën e të cilit Këshilli Antifashist Nacional-Clirimtar realizon funksionin e tij ekzekutiv.

VI.

Duke marrë parasysh se Lëvizja Nacional-Çlirimtare do të zhvillohet gjithnjë më tepër dhe do të çlirohen krahina të okupuara sot prej armikut, Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar i jep të drejtë Kryesisë të kooptojë anëtarë të rinj.

26.V.1944.

KËSHILLI I PËRGJITHSHËM ANTIFASHIST
NACIONAL-ÇLIRIMTAR

Faksimile e Vendimit të Mbledhjes së parë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, më 26 maj 1944.



Shoku Enver Hoxha me anëtarë të tjerë të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar. Nga e djathta në të majtë: Hysni Kapo, Haxhi Lleshi, Myslym Peza, Omer Nishani, Spiro Moisiu.



Mehmet Shehu në ditët e Kongresit të Përmetit.



Nga e majta në të djathtë: Haxhi Lleshi, Spiro Koleka (anëtarë të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar) dhe Gogo Nushi (anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar) në ditët e Kongresit të Përmetit.




Grupe delegatësh duke dalë nga salla e Kongresit të Përmetit.



Shoku Enver Hoxha midis një grupi delegatësh dhe partizanësh në ditët e Kongresit të Përmetit.



Shoku Enver në ditët e Operacionit armik të Qershorit 1944.



URDHËR DITE DREJTUAR USHTRISË
NACIONALÇLIRIMTARE ME RASTIN
E FORMIMIT TË KOMITETIT
ANTIFASHIST NACIONALÇLIRIMTAR

28 maj 1944

URDHËR DITE

SHOKË PARTIZANË E UDHËHEQËS USHTARAKE DHE POLITIKË TË USHTRISË SONË NACIONALÇLIRIMTARE

Dita e sotme, që i dha popullit s
Antifashist Nacionalçlirimtar, është dit
pullin dhe ushtrinë tonë heroike, se s
Komitetit po del edhe dekretimi i par
trima.

Në përpjekje të përgjakshme me
tonë dhe me tradhtarët lindi dhe u fo
lindën udhëheqësit e kësaj ushtrie trim
tojnë ushtrinë e popullit shqiptar me s
sa kanë çuditur botën. Nga giri i popul
të lidhur ngushtë me popullin, punëto
intelektualë të ndershëm dolën dhe m
thyeshëm e me një bindje të plotë në
luftime të ashpra dhe u treguan të aft
trinë tonë. Komandantët dhe komisart
në prova të një zotësie të shquar dh
mundur oficerët italianë e gjermanë të pajisur me njohuri
të mëdha ushtarake dhe sot ata qëndrojnë të patundur e
fitimtarë në luftën kundër okupatorit gjerman.

OFICERË TË USHTRISË NACIONALÇLIRIMTARE,

Udhëheqja në ushtrinë tonë është me rëndësi të madhe
dhe e shumanshme. Ajo duhet të jetë ushtarake e
politike dhe, për të qenë e përsosur, duhet që kuadrot

...en me njohuritë e nevojshme teorike. Detyra
... Përgjithshëm është krijimi i shkollave, ku
... popullorë të pajisen me taktikën e luftës dhe
...ë të përballojnë taktikën ushtarake të ar-
...os e lënë kurrë armikun të na imponojë tak-
...Ne duhet të jemi kurdoherë në ofensivë,
...fensivë, dhe kur armiku sulmon ne të dimë
...ë planet e tij, ta godasim nga të gjitha anët,
...hjet dhe t'i hyjmë thellë në prapavijat, t'i
...met, t'i shkatërrojmë shtabet e tij dhe të çli-
... okupuara. Ju e kuptoni fare mirë rëndë-
...s dhe të mësimit ushtarak, i cili do t'ju

tikën e tij. Ne duhet të jemi kurdoherë në ofensivë,
gjithnjë në ofensivë, dhe kur armiku sulmon ne të dimë
t'i shkatërrojmë planet e tij, ta godasim nga të gjitha anët,
t'i presim lidhjet dhe t'i hyjmë thellë në prapavijat, t'i
presim furnizimet, t'i shkatërrojmë shtabet e tij dhe të çli-
rojmë qytetet e okupuara.

para dhe në rrugën e fitoreve të lavdishme. Armët që
keni në dorë t'i përdorni më së miri kundër okupatorit
e tradhtarëve dhe të mos i lëshoni gjersa populli ynë
ta ketë fituar lirinë dhe gjithë të drejtat e tij.

...e fitoreve të lavdishme. Armët që
...rdorni më së miri kundër okupatorit
... të mos i lëshoni gjersa populli ynë
... dhe gjithë të drejtat e tij. Armiku
...e përpiqet të na shmangë nga lufta
...r okupatorit, duke na hedhur në një
...or ne nuk duhet të harrojmë kurrë se
...shtë okupatori gjerman dhe se këtij


...luftën më të ashpër, luftën më të ashpër
...e gjithë tradhtarëve që bëjnë lodrën e tij.
...përgjakshme, e lidhur ngushtë me atë të
...të mëdhenj: Bashkimit Sovjetik, Anglisë
...i dhe të popujve të robëruar, është garancia
...mit tonë.
...i mjeruar, që lëngon nën thundrën e
...rës gjerman, kërkon prej nesh shpëtimin,
...uxim e heroizëm, me atë shpirt sakrifice
...atë disiplinë shembullore që na ka da-
...përpara në luftë për të çliruar sa më
...të dashur.
...dhe shpresa për popullin tonë që
...azhdoni luftën gjer në fitore.

ANTIFASHIST NACIONALÇLIRIMTARI!
ANTIFASHIST NACIONALÇLIRIMTARI
PËRGJITHSHËM I USHTRISË NACIO-
I NJESIVE PARTIZANE!
ANTIFASHISTE ME NE KRYE POPUJT
SHQIPTARI
NACIONALÇLIRIMTARE!

Jetën për lirinë e atdheut!


Komandanti i Përgjithshëm i
Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare
Gjeneralkolonel
ENVER HOXHA

Faksimile e Urdhrit të ditës, dhënë UNÇSH nga shoku Enver Hoxha, Komandant i Përgjithshëm i UNÇSH.




Më 28 maj 1944, Komandanti i Përgjithshëm Enver Hoxha i dha urdhër Ushtrisë Nacionalçlirimtare të hidhej në mësymje të përgjithshme për çlirimin e plotë të Shqipërisë nga pushtuesit gjermanë dhe për shkatërrimin rrënjësor të «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit» dhe të gjitha forcave reaksionare.

Plani i Komandës së Përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit kishte për qëllim njëkohësisht të siguronte dështimin e orvatjeve që bënte komanda anglo-amerikane e Mesdheut për të ndaluar kalimin në mësymje të përgjithshme të UNÇSH dhe për të mënjanuar shkatërrimin e forcave reaksionare. Në plan parashikohej edhe ndjekja e trupave hitleriane përtej kufijve shtetërorë.




Ditën që u lëshua urdhri për mësymjen e përgjithshme, filloi operacioni tjetër i madh i trupave gjermane. Armiqtë hodhën në mësymje katër divizione e gjysmë gjermane dhe disa mijëra xhandarë, ballistë e zogistë.



Operacioni armik i Qershorit 1944 përfundoi, ashtu si operacionet e dimrit, me disfatë për nazistët gjermanë dhe reaksionin. Ky operacion shërbeu si një provë tjetër e madhe e forcës së pathyeshme të UNÇSH e të popullit shqiptar. Ushtria Popullore doli edhe më e rritur dhe më e fortë, populli doli më i vendosur për të vazhduar luftën deri në fitore, me besim dhe më të thellë tek udhëheqja e Partisë Komuniste.



Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. MAKRES 1943. **F. Haxhiu**


Buletin i përkohshëm Nr. 1 (1 - 15 Qershor)

"DIVIZIONI I-rë PAGEZOHET ME ZJARR"

BULETIN I VEPRIMEVE TË DIVIZIONIT I-rë SULMUES

Më 28 maj 1944 u krijua Divizioni I Sulmues. Në përbërjen e këtij Divizioni u futën Brigada I, IV dhe V Sulmuese dhe forca të tjera partizane të qarkut të Korçës e Beratit.

Krijimi i Divizionit I Sulmues si njësia më e madhe ushtarake, në këtë kohë, luajti një rol kryesor në përmbushjen e detyrave të mëdha luftarake historike, që shtronte Komandanti i Përgjithshëm i UNÇSH Enver Hoxha. Më 1 qershor 1944, shoku Enver Hoxha lëshoi urdhrin e mësymjes së Divizionit I Sulmues në Shqipërinë e Mesme e në Veri, mësymje që filloi më 26 qershor 1944. Mësymja e Divizionit në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut shënoi dhe mësymjen e përgjithshme të UNÇSH për çlirimin e plotë të atdheut. Luftëtarët e Divizionit, me mbështetjen e popullit, i shpartalluan forcat hitleriane e reaksionare dhe çliruan pjesën më të madhe të Shqipërisë së Mesme dhe qarkun e Dibrës me qytetet e Peshkopisë (29 korrik 1944) dhe Dibrës së Madhe (2 shtator 1944).



Luftëtarë të brigadave partizane në përbërje të Divizionit t Sulmues.



Reparte partizane të Divizionit I Sulmues gjatë kalimit në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut.





Në fshatin Protopapë të malësisë së Opa-rit, më 29 qershor 1944,u formua Brigada XV Sul-muese me kuadro e partizanë të qarkut të Korçës.

Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës XV Sulmuese.



4 gusht 1944

URDHËR-DITE

Për të njësuar veprimet e brigadave tona dhe për ta bërë më të fuqishme goditjen kundër okupatorit gjerman dhe tradhëtarëve të vendit, urdhërojmë formimin e DIVIZIONIT II SULMUES, i cili do të përmbledhë në gjirin e vet Brigadën VI Sulmuese, Brigadën III Sulmuese dhe Brigadën XVIII Sulmuese.

Me këtë rast historik për Ushtrinë tonë Nacional-Çlirimtare u çoj në emër të Shtabit të Përgjithshëm, përshëndetjet gjithë reparteve të këtij divizioni duke pasur bindjen e plotë se Divizioni II Sulmues, i përbërë nga bijtë më të ndershëm e trima të popullit tonë, do të vere gjithë forcën e tij për të ngritur lart flamurin e ushtrisë sone heroike dhe, duke i dhënë grushte vdekjeje okupatorit të urryer gjerman dhe shërbëtorëve të tij, tok me repartet e tjera të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare ay do të shpejtësojë çlirimin e popullit dhe të Atdheut tonë të dashur.

Vdekje Fashizmit — Liri Popullit!

Komandanti i Përgjithshëm i
Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare
Gjeneral-kolonel ENVER HOXHA

Faksimile e urdhrit të formimit të Divizionit II Sulmues, më 4 gusht 1944.






Kuadro dhe luftëtarë të brigadave të Divizionit II S.




Në qershor të vitit 1944, kur Divizioni I Sulmues luftonte heroikisht kundër pushtuesve gjermanë dhe tradhtarëve në Shqipërinë e Mesme, radistët partizanë të këtij Divizioni, me aparatet e zëna në luftë armikut, hynë në lidhje me Shtabin e Përgjithshëm të UNÇSH, që gjendej në jug të Shqipërisë.

Më 8-14 gusht 1944, në Heimës të Skraparit u mblodh Kongresi I i Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare (BRASH). Në këtë Kongres jehoi fuqishëm zëri i asaj rinie, e cila nën kushtrimin e PKSH qe e para që iu përgjigj thirrjes për të shpëtuar atdheun nga kthetrat e fashizmit. Rinia mbushi njësitet guerile të qyteteve, batalionet, brigadat, divizionet dhe tregoi shembull të lartë heroizmi dhe therori.





Shoku Enver Hoxha pritet me dashuri të madhe nga delegatët e Xongresit.



Shoku Enver Hoxha, në emër të Shtabit të Përgjithshëm dhe Komitetit Antitashist Nacionaiçlirimtar, përshëndet Kongresin I të BRASH.

Pamje nga punimet e Kongresit I të BRASH.






Nako Spiru duke mbajtur raportin në Kongresin I të Rinisë Antifashiste. Nga e majta në të djathtë: Nexhmije Xhuglini, Alqi Kondi, Ramiz Alia, Piro Kondi

Shoku Ramiz Alia duke folur në Kongresin I të BRASH.





Shoku Enver Hoxha dhe Nako Spiru, i zgjedhur President i BRASH, në ditët e Kongresit.



FJALIM NË KONGRESIN E PARË TË RINISË ANTIFASHISTE SHQIPTARE¹

8 gusht 1944

Shokë dhe shoqe të Rinisë Antifashiste Shqiptare!

Ju përshëndes nga zemra në emër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe në emër të Komitetit Antifashist Nacional-Çlirimtar.

Kur hordhitë e Musolinit u vërsulën mbi tokat tona për të na skllavëruar dhe për të na zhdukur si popull, për të na përdorur si mish topi për interesat e tyre imperialiste, rinia e vendit tonë, ajo rini që nën regjimin mesjetar dhe grabitës të Zogut nuk ishte përkulur kurrë, u bë shkëndija e parë që i dha zjarr luftës sonë çlirimtare. Në ditët e para të robërisë ju kemi parë të ndjenit dhe të mendonit si njerëz të pjekur, si njerëz që u dhimbej atdheu dhe liria, si njerëz që parashikonit një përleshje të përgjakshme, ku do të luhej fati juaj, fati i popullit tonë, fati i gjithë njerëzimit, i kërcënuar nga fashizmi gjerman e italian. Ju kemi parë me fytyra të vrëjtura, por me zemrat lart, të armatosur me vullnetin e çelniktë dhe me një guxim të patreguar të shihemi nga punëtoritë, nga parmendat, nga bankat e shkollës, në demostratat e para të qyteteve. Ju kemi parë të vërsuleni mbi mitralozat e armikut dhe të tradhëtarëve me një guxim të patregueshëm, të gjakoseni, të vriteni, të kaloni mbi kufomat e shokëve tuaj, por të shkoni gjithmonë përpara për mbrojtjen e popullit e të atdheut.

ENVER HOXHA

Përëndim dhe po i vënë përpara ushtritë e Romelit. Qentë fashistë, që u vërsulën të skllavëronin botën, ...në hesapet pa rinînë antifashiste të Bashkimit Sovje- ...të udhëhequr prej Komsomolit heroik leninist, pa ...në antifashiste të popujve të Anglisë dhe të Ameri- ...pa rininë e gjithë popujve të robëruar. Sot gjende- ...ërejt rrugës së triumfit, sot perspektiva e fitores ...është e qartë. ...Po tamam në këtë kohë nuk duhet të ... ...tona, tamam në ... ...e shtyu ...fuqive të

Rinia e ver 'it tonë, krenaria e popullit shqiptar, u hodh me misl. e me shpirt në luftën e përgjakshme, ajo dha dëshmorët e parë heroikë dhe tregoi që në fillimin e robërisë se, me gjithë terrorin e tmerrshëm fashist dhe pa pasur ende armët në dorë, ajo ishte e vendosur të luftonte, ajo dinte përse luftonte dhe se në hovin e saj ngadhnjimtar s'kish fuqi që ta ndalonte. Kur Partia Komuniste e Shqipërisë lëshoi zërin e kushtrimit për të shpëtuar atdheun tonë të dashur nga kthetrat e fashizmit, rinia shqiptare qe e para që ju përgjegj thirrjes së saj, që u hodh e para në luftë, mbushi njësitet guerrile të qyteteve dhe të maleve, të përbëra nga bijtë më të zgjedhur të popullit tonë, mbushi batalionet partizane, të cilat u zmadhuan në brigada e divizione e që sot përbëjnë Ushtrinë tonë të rregullt N.-Çl.

...ur nga faqja e dheut armikun më të madh të po- ...pullit tonë dhe të njerëzimit: nazizmin gjerman.

Rroftë Rinia Antifashiste trime Shqiptare!


Rroftë Kongresi i parë i Rinisë Antifashiste Shqiptare!

Faksimile e fjalimit të shokut Enver Hoxha në Kongres.





Pamje nga jeta e rinisë në ditët e Kongresit.






Delegatë të Kongresit I të BRASH.



«Shkolla partizane» **S. Capo**




Partizanë të njësive të Korparmatës I.



Hysni Kapo,
komisar i Korparmatës I.


Më 18 gusht 1944 u formua Korparmata I Sulmuese e UNÇSH. Formimi i Korparmatës I Sulmuese siguronte më mirë zbatimin e idesë së shokut Enver Hoxha për mësymjen e përgjithshme të UNÇSH, që do të përfundonte me çlirimin e plotë të Shqipërisë.






...he kalimin e Divizionit të dytë sulmuës në veri të Shkumbinit urdh...
...ojnë formimin e Korp Armatës së Irë e cila do të përbëhej nën...
...komandën e vet repartet e poshtme:
Divizionin e Irë Sulmuës
Divizionin e IItë Sulmuës
Gjithë batalionet teritoriale të Qarkut t'Elbasanit
Batalionin "Dajti"
Batalionin "Ishmi"
Batalionin e Matit
Arudhën"Perlat Rexhepi" të Shkodrës
Batalionet teritoriale të Qarkut të Dibrës
Dhe gjithë komandat e Qarqeve me përjashtim të ato të zonës Penë.
Vdekje fashizmit-Liri popullit
Komandant i Përgjithshëm i Ushtërisë
Nacional Çlirimtare Shqiptare
Gjeneral Kolonel ENVER HOXHA

Faksimile e urdhrit të Komandantit të Përgjithshëm të UNÇSH shokut Enver Hoxha mbi krijimin e Korparmatës I.




Partizanë të njësive të Korparmatës I.





UNÇSH në mësymje të përgjithshme për çlirimin e plotë të Shqipërisë.



Njësi partizane në ditët e mësymjes së përgjithshme të UNÇSH.







Brigada XIV Sulmuese u formua më 17 gusht 1944, në fushën e Sheperit të qarkut të Gjirokastrës me partizanë të qarkut të Gjirokastrës.

Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës XIV Sulmuese.





Liri Gero.
Heroinë e Popullit.



Brigada XVI Sulmuese u formua më 20 gusht 1944, në fshatin Therepel të Beratit me partizanë të qarkut të Beratit si dhe me luftëtarë të Kurveleshit.

Kuadro e luftëtarë të Brigadës XVI Sulmuese.



Brigada XVIII Sulmuese u formua më 20 gusht 1944, në Sllatinë të Peshkopisë me partizanë të qarkut të Dibrës.



Ibe Palikuqi.
Heroinë e Popullit





Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës XVIII Sulmuese.



Ndoc Dedo (Teli),



Ndoc Mazi (Minuku),




Naim Gjylbegu (Besniku),



Hidajet Lezha (Hida),



Ahmet Haxhia (Tigri).



Më 21 gusht 1944 bien dëshmorë Heronjtë e Popullit Ndoc Deda, Ndoc Mazi, Naim Gjyl beau, Hidajet Lezha, dhe Ahmet Haxhia në Vig të Mirditës në luftë kundër qindra mercenarëve të nazizmit gjerman.

Ja se çfarë shkruanin ata në çastin e rënies:

«Të dashur shokë,

Jena të rrethuem dhe po presim në çdo çast të na përshkojnë plumbat e tradhtarëve, por na kena da ma mirë me dhanë jetën si me le, se sa me tradhtue luftën që kena nisë. Nji herë thamë: «Ja vdekje ja liri!» Pra shokë, ju do të ndjekni punën tonë prej ku po e lamë na, me guxim të pathyeshëm.

Shokë, prej maleve të Mirditës ju çojmë përshëndetjet tona tue brohoritë të gjithë njizani: «Vdekje fashizmitl — Liri popullit!»

Të fala

Të pesë shokët: Teli, Besniku, Tigri, Minuku, Hida».

«Heronjtë e Vigut». **Sh. Hadëri**

Brigada XIX Sulmuese u krijua më 30 gusht 1944, në Theollogo të Delvinës me partizanë të qarkut të Gjirokastrës.



Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës XIX Sulmuese.





Oibro Sokoli.
Heroinë e Popullit.

Brigada XX Sulmuese u formua më 9 shtator 1944 në fshatin Protopapë të Korçës, me partizanë të qarkut të Korçës.



Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës XX Sulmuese, midis të cilëve Riza Kodheli (i dyti nga e majta).

Një grup luftëtarësh të Brigadës XX Suimuese pas shkatërrimit të një reparti nazist





Met Hasa,
Hero i Popullit.

Brigada XXII Sulmuese u formua më 18 shtator 1944, në Pezë me partizanë të grupit të Pezës.



Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës XXII Sulmuese.



Më 21 shtator 1944, në Zall-Mner të qarkut të Tiranës u formua Brigada XXIII Sulmuese, me partizanë të qarkut të Tiranës dhe të rretheve të Krujës e të Matit.



Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës XXIII Sulmuese.



Forcot portizane të Brigadës VII Sulmuese dhe të qarkut të Beratit, pas një lufte të përgjakshme, më 12 shtator 1944, çliruon qytetin e Beratit. Populli i Beratit teston i gëzuar çlirimin përfundimtar të qytetit.





Më 18 shtator 1944, forcat partizane të Brigadës XIV Sulmuese në bashkëpunim me Brigadën XIX Sulmuese dhe me luftëtarë të Zonës I Operative çliruan qytetin e Gjirokastrës. Partizanë e popull të mbledhur në ditën e çlirimit të Gjirokastrës.

Brigada XVII Sulmuese u formua në Gjinar të Shpatit, më 26 shtator 1944, me partizanë të qarkut të Elbasanit.






Gogo Nushi (në mes) midis kuadrove të shtabit të Brigadës XVII Sulmuese.

Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës XVII Sulmuese.




Brigada XXIV Sulmuese u formua më 4 tetor 1944, në Bicaj të Lumës me partizanë të qarkut të Kukësit dhe të njësive të ndryshme të UNÇSH.



Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës XXIV Sulmuese.

Brigada IX Sulmuese u formua më 16 tetor 1944 në fshatin Lozhan të Gorës të qarkut të Korçës.



Pamje nga inaugurimi i Brigadës IX Sulmuese.




Partizanët e Brigadës XII Sulmuese së bashku me luftëtarë të Qarkut të Vlorës, më 15 tetor 1944 çliruan përgjithmonë qytetin e Vlorës. Po në tetor të vitit 1944 u çliruan Saranda, Delvina, Fieri, Lushnja. Populli i Vlorës feston ditën e çlirimit.



Forcat e Brigadës II Sulmuese dhe të Brigadës IX Sulmuese më 24 tetor 1944 çliruan qytetin e Korçës. Në këtë kohë u çliruan Erseka (22 tetor), Bilishti (24 tetor). Populli i Korçës pret me entuziazëm çliruesit.

Më 20-22 tetor 1944, në qytetin e lirë të Beratit u zhvillua Mbledhja II e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Shqipërisë, e cila vendosi shndërrimin e Komitetit Antifashist në qeveri demokratike të Shqipërisë. Mbledhja e Beratit miratoi ligjin e ri mbi këshillat nacionalçlirimtare. Këtej e tutje këshillat do të kryenin detyra vetëm të pushtetit demokratik popullor. Fronti Nacionalçlirimtar do të krijonte organizatat e tij më vete. Një nga vendimet më të rëndësishme të Mbledhjes ishte miratimi i Oeklaratës mbi të drejtat e qytetarëve, që përbënte një dokument kushtetues të shtetit të ri të demokracisë popullore. Vendimet e Mbledhjes II të KANÇ ishin plotësimi dhe konkretizimi i mëtejshëm i vendimeve të Kongresit te Përmetit dhe shënonin një fitore të re të popullit shqiptar mbi fashizmin dhe reaksionin e brendshëm.






Shoku Enver Hoxha dhe anëtarë të tjerë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar drejtohen për në sallën e Mbledhjes II të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar.



Shoku Enver Hoxha, kryetar i Qeverisë së Parë Demokratike, duke mbajtur raportin në Mbledhjen II të KANÇ.



V E N D I M Nr 14 dt 22.V.944

i

Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë

mbi

NDËRRIMIN E KOMITETIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR NË QEVERI DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË

Duke marrë parasysh se vendimet historike të marra në Kongresin e Përmetit janë aprovuar dhe përshëndetur më entuziazmin më të madh nga i gjithë populli shqiptar;

Duke marrë parasysh se pas Kongresit të Përmetit,më shumë se tre të katërtat e Shqipërisë janë çliruar nga thundra e okupatorit dhe e tradhtarëve të vendit t'onë;

Duke marrë parasysh se në të gjitha visat e çliruara është ngritur dhe forcuar kuqe pushteti demokratik i popullit shqiptar;

Duke marrë parasysh se Ushtrija e janë Nacional-Çlirimtare është forcuar dhe se ne mjira e me mjira luftëtarë të rinj kanë shtuar radhët e saj,dhe nga ushtri me forcacione të mecme si bataljone dhe brigada është bërë një ushtri e rregullt me forcacione të mëdha ushtarake si divizione e korp armate;

Duke marrë parasysh se rreth luftës nacional-çlirimtare janë grumbulluar masat e gjëra të krejt popullit shqiptar ;

Duke marrë parasysh se autoriteti politik dhe ushtarak i luftës u'onë është rritur më tepër se kurrë si brenda,ashtu edhe jashtë Shqipërisë ;

Duke marrë parasysh se lufta kundër Gjermanisë naziste ka hyrë në fazën e saj finale dhe ndodhemi ne pragun e çlirimit të gjithë Shqipërisë ;

Duke marrë parasysh se përpara ushtëheqjes së shtetit paraqiten shumë detyra për forcimin e luftës,për forcimin e pushtetit,për mobilizimin e krejt popullit,për forcimin kherinëdrtimin ekonomik të vendit të shkatërruar nga kjo luftë e tmerrshme,për edukimin dhe lartësimin kulturol dhe arsimor të masavet të popullit ;

Duke marrë parasysh se të gjitha këto nëryshime të situatës , kërkojnë një ushtëheqje të përshtatëshme për këtë situatë ;

Duke marrë parasysh dëshirën dhe vullnetin e gjithë popullit për të forcuar edhe më tepër pushtetin e tij demokratik dhe për të patur marrëdhënie zyrtare të rregullta me të gjithë aleatët t'onë të ndëshenj dhe me gjithë botën e jashtme antifashiste me anë të një qeverije ;

Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar i Shqipërisë

V E N D O S I

NDËRRIMIN E KOMITETIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR TË SHQIPËRISË NË QEVERI DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË.


Faksimile e Vendimit të Këshillit Antifashist mbi ndërrimin e Komitetit Antifashist në Qeveri Demokratike të Shqipërisë.



Pamje nga punimet e Mbledhjes së Beratit.
Midis pjesëtarëve: Myslim Peza, Spiro Moisiu, Goqo Tashko, Musa Basha, Llazar Bozo, Qazim Kondi, Haki Stërmilli, Nuredin Aliu.



Shoku Enver Hoxha dhe anëtarë të tjerë të Qeverisë së Parë Demokratike. Nga e majta në të djathtë: Mysl'tm Peza, Spiro Koleka, Medar Shtylla, Haxhi Lleshi.



DEKLARATË E QEVERISË DEMOKRATIKE TË
SHQIPËRISË BËRË PËRPARA MBLEDHJES SË DYTË TË KËSHILLIT ANTI-
FASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR TË SHQIPËRISË

Në këtë luftë të madhe antifashiste e çlirimtare,ku gjithë popujt përparimtarë,të bashkuar përpara rrezikut që kërcënonte njerëzimin, hodhën energjitë e tyre kundër barbarve nazisto - fashistë, populli yné heroik dha me vetmohimin më të madh,kontributin e tij për çlirimin e Atdheut dhe për çdukjen e murtajës fashiste. Populli Shqiptar ndërmori me guxim luftën në të tmerrshme dhe njëkohësisht në gloriose që ka parë historija jonë dhe tregoje me vepra gjaku që do të mbeten monumente të pashembura për btezat e ardhëstmë të vendit t'onë, se në dejt e Shqiptarit vëlon gjaku i stërgjyshëve të tij heroikë,dhe se shpirti i tij është i pajosur me virtutet e larta që karakterizojnë popullin t'one.Përpara rebeshit të madh që kërcënonte Atdheun,populli yné, pa marrë parasysh vuajtjet,urinë,djegëjet e vrasjet,u hodh përpara në rrugën e vetze të shpëtimit që do të thyente zinxhiret e tmerrshme të roberisë,në rrugën e luftës së pamëshirëshme kundër okupatorit dhe tradhëtorve të vendit.Populli Shqiptar me luften e tij kundër armiqvet të egër e të fortë,të armatosur me mjete më moderne,mjaftë,njerën pas tjetrën,shkallët e lavdishme që cuan naltë emërin e Shqipërisë dhe të Shqi,tarit,që e bënë Atdheun t'onë të respektohet prej botës xbarë,dhe që(me gjakun e kullu-ar të bijve të tij të lavdishëm) të xërë vend krah për krah me të gjithë ata popuj që ndërmuarën veprën e madhe për shpëtimin e njerëzimit.

Në sjarrin e kësaj lufte çlirimtare,u ngrit në këmbë Ushtrija heroike Nacional-Çlirimtare,Ushtrija e popullit t'onë të pathyer, e cila i dha grushte vdekjeje okupatorit dhe tradhëtorve,dhe në luftë e në përpjekje të përgjakshme u armatos dhe u çelikos me një vetmohim,një disiplinë dhe një eksperiencë të madhe.Në luftë dhe në përpjekje u ngritnë Këshillat Nacional-Çlirimtare,të cilat u bënë me të vërtetë pushteti demokratik i popullit,dhe tok me Ushtrinë t'onë,faktorët kryesorë të fitoreve t'ona.Organizimi i yné i pushtetit,mjaftë dhe ai,krahas me fitoret e Ushtrisë, etapet e tij të lavdishme,duke kaluar nga njera në tjetrën në perfekzionimin e tij.Peza,Labinoti,Përmeti dhe Berati janë katër etapa të shkëlqyera të luftës s'onë.Kongresi i math i Përmetit, ku delegatët e popullit shqiptar ngjodhën Këshillin Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë dhe e veshnë me atributat legjislative dhe ekzekutive,i dha Shqipërisë KOMITETIN ANTIFASHIST,organin kryesor ekzekutiv dhe urdhërdhënës të Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar.Mbledhja e dytë historike e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë mbajtur në qytetin e lirë të Beratit,i dha Shqipërisë Qeverinë e parë demokratike,e cila është organi kryesor ekzekutiv dhe urdhërdhënës dhe me anën e së cilës Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar kryen funksionet e tij ekzekutive.

Qeverija demokratike e Shqipërisë,koshiente për barrën që i është ngarkuar,do të qëndroje besnike e vendimeve të marra në Kongresin e Përmetit,do të jetë vazhdim i Komitetit Antifashist,do të zbatojë dhe do të mbrojë të gjitha parimet ushtarake dhe politike të lëvizjes Nacional-Çlirimtare në një shkallë më të gjërë.

Qeverija,e mbështetur në funksionet e saj,deklaron përpara gjithë popullit Shqiptar :

...ërisë do të qëndrojë besnike e
...it Antifashist Nacional-Çlirim-
...fashist Nacional-Çlirimtar të
...ojë në gjurmat e Komitetit Anti-

...jerimin dhe vazhdimin e luftës,
...ë Shqipërisë dhe mbrojtjen e in-

...risë do të grumbullojë të gji-
...th pushtetit Nacional-Çlirimtar
...dllave nacional-çlirimtare.
...risë,pas çlirimit të plotë të
...lizuar gjendjen do të procedojë
...ënyrë demokratike për Asamble-
...jë formën e Shtetit dhe do të
... Shqiptar.
...risë do të rishikojë të gjitha
... ekonomike të bëra me shtetet
... do t'i prishij të gjitha ato
...htetit Shqiptar.
...isë do të sigurojë dhe do të
... të nënshtetasit.
...isë do të përpiqet t'a bëje
...tët e mëdhenj Bretanjën e
...t e Bashkuara t'Amerikës si
... të bllokut antifashist.
...isë do të kërkojë prej Alea-
...,Bashkimit Sovjetik dhe Shte-
... prej gjithë pjesëtarve të
... si Qeveri e vetme e Shqipërisë.

Berat,më 23 Tetor 1944.

Në emër të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë
KRYEMINISTER
dhe Komandant'i Përgjithshëm i Ushtrisë
Nacional-Çlirimtare të Shqipërisë
GJEN.KOL. ENVER HOXHA

Faksimile e Deklaratës së Qeverisë Demokratike të Shqipërisë bërë përpara Mbledhjes II të KANÇ.

Populli i Beratit pret me dashuri shokun Enver Hoxha dhe udhëheqës të tjerë të Luftës Nacionalçlirimtare, pjesëmarrës në Mbledhjen II të KANÇ.





Populli i Beratit pret me dashu;i shokun Enver Hoxha dhe udhëheqës të tjerë të Luftës Nacionalçlirimtare, pjesëmorrës në Mbledhjen II të KANÇ.












Delegate nga të katër anët e Atdheut vijnë në Kongresin I të BGASH. Në foto Nr. 2, (në mes) Hilmie Kosturi.



KRYEMINISTRI I QEVERISË DHE KOMANDANT I U. N. ÇL. SH. GJENERAL KOLONEL ENVER HOXHA FOLI KËSHTU NË KONGRESIN E I-rë TË B. G. A. SH.

Të dashura shoqe delegate të gruas antifashiste Shqiptare,

Në emër të qeveris demokratike të Shqipërisë e të Shtabit të përgjithshëm përshëndes nga zëmra përfaqësueset e denja të gruas antifashiste të vëndit t'onë, të mbledhura në këtë kongres historik.

...heroiko... dheut, ... unjet ... shënjtë ... falët a ... bijve d... Shqipë... ...n themelet e ...gjithë populli i jonë i ... i organizuar do të marri çdo ditë e përherë forcën e shpirtit që do të na çojë përpara, drejt përparimit dhe lulëzimit, drejt idealeve për të cilët ata ranë dëshmorë —(duartrokitje të pa prera)—.

Lavdi për Heronjtë t'anë që dhanë jetën për çlirimin e Atdheut!

Rroftë Kongresi i I-rë i Gruas Antifashiste!

Rroftë Gruaja Antifashiste e vëndit t'onë!

Rroftë Bashkim'i Gruas Antifashiste Shqiptare!

Rrofte Shqipërija e lirë dhe demokratike!

Faksimile e fjalimit të shokut Enver Hoxha mbajtur në Kongresin I të BGASH.



Më 4 nëntor 1944 në qytetin e lirë të Beratit u mbajt Kongresi I i Gruas Antifashiste Shqiptare. «Gruaja Antifashiste Shqiptare, — tha shoku Enver Hoxha në fjalën e mbajtur në këtë Kongres, i fitoi me gjak të drejtat e saj dhe këto të drejta ia garanton pushteti i popullit që ajo, tok me vëllezërit e saj, e ngriti, duke sakrifikuar çdo gjë të shenjtë që kishte.

Kongresi i madh dhe historik i Gruas Antifashiste, në të cilin po asistojmë sot, do t'i japë një impuls të madh hovit të gruas shqiptare».



Pamje nga punimet e Kongresit I të BGASH.



Otlga Plumbi, Presidente e BGASH.



Nexhmije Xhuglini, kryetare e komisionit Iniciator të BGASH, duke folur në Kongres.



Vito Kondi, një hga kuadrot dreitues të BGASH, duke diskutuar në Kongres.



Duze Bajrami, një nga aktivistet e dalluara të gruas antifashiste, duke folur në Kongres.



Shoku Enver Hoxha përshëndetet nxehtësisht me nëna dëshmorësh.

Grupe delegatesh në pushimet midis seancave të Kongresit.

Brigada XI Sulmuese u krijua më 1 nëntor 1944, në qytetin e Fierit me partizanë të Zonës I Operative Vlorë-Gjirokastër.



Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës XI Sulmuese.



Briyada X Suimuese u formua më 6 nëntor 1944, në fshatin Karbunarë të Lushnjës me partizanë të qarkut të Beratit.



Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës X Sulmuese.



Më 6 nëntor 1944, u krijua Brigada XXV Sulmuese në Tropojë me partizanë të këtij rrethi dhe të njësive të ndryshme të UNÇSH.




Pamje nga inaugurimi i Brigadës XXV Sulmuese.





«Në thirrjen e Partisë» **Sh. Hysa**



URDHËR DËRGUAR SHTABIT TË KORPARMATËS SË I PËR KALIMIN E DY BRIGADAVE TË U.N.Ç.SH. NË KOSOVË PËR TË LUFTUAR PUSHTUESAT GJERMANË

12 shtator 1944

(Shumë konspirative)

Të pregatiten dhe të nisen menjëherë për Kosovë Brigada I-rë dhe III-të.[1] Brigada I-rë të kalojë e para në malësitë e Gjakovës[2] dhe të Pejes, Brigada III-të ta ndjeki të parën menjëherë dhe mundësisht të bjerë në kontakt me forcat e Kryeziut[3] dhe ta detyrojë atë të mbajë qëndrim. Me këtë të veprohet si me Muharrem Bajraktarin.[4] Por mos vonohet rrugës dhe mos presë kontakt me Brigadën I-rë. Këto dy brigada do të veprojnë ngushtë me një shtab operativ të njëjtë. Manush Myftiu do të shkojë me të si i deleguar i korpusit. Këto brigada do të veprojnë nën komandën e Korpusit të parë. Do të bëjnë kontaktin me Korpusin II-të jugosllav, drejtim Plavë[5]-Andrievicë.[6]

Komandanti i Përgjithshëm i
U.N.Ç.SH.
ENVER HOXHA

Faksimile e Urdhrit të Komandantit të Përgjithshëm shokut Enver Hoxha dërguar Shtabit të Korparmatës I për kalimin e dy brigadave të UNÇSH në Kosovë, për të luftuar pushtuesit gjermanë. Por dy ditë më vonë Komanda e Përgjithshme e UNÇSH aprovoi propozimin e Korpusit I, që në Kosovë, në vend të Brigadës I, të kalonte Brigada V, meqenëse kjo e fundit, në këtë kohë, ndodhej në krahinën e Kukësit.

Në shtator të vitit 1944, shoku Enver Hoxha, Komandant i Përgjithshëm i UNÇSH u dha urdhër Brigadës ill Sulmuese dhe V Sulmuese të kalonin në Kosovë për çlirimin e saj nga pushtuesit gjermanë e nga tradhtarët. Këto brigada të UNÇSH kaluan përtej kufirit shtetëror të Shqipërisë më 5 tetor 1944. Në bashkëveprim me brigadat kosovare, deri më 18 nëntor kishin spastruar nga trupat hitleriane krejt Rrafshin e Dukagjinit, duke çliruar me luftë të ashpër Gjakovën (më 7 nëntor), Prizrenin (më 16 nëntor) dhe Pejën (më 17 nëntor) dhe vise të tjera të Kosovës.

Luftëtarë të UNÇSH, të pritur si çlirimtarë nga populli, kalojnë nëpër rrugët e gytetit të posaçliruar të Pejës.





Hajdar Dushi, zëvëndëskomisar i batalionit «Perlat Rexhepi». Heroi i Popullit.




Miting i popullit të një qyteti të Kosovës, çliruar nga forcat e Brigadës V Sulmuese të UNCSH.

Lufta për çlirimin e Tiranës filloi më 29 tetor 1944, me urdhër të shokut Enver Hoxha, Komandant i Përgjithshëm i UNÇSH. Ajo zgjati 19 ditë rresht.

«Tirana u çlirua prej brigadave heroike të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të ndihmuara prej popullit të Tiranës. Në luftën e përgjakshme rrugë më rrugë e shtëpi më shtëpi kundër një armiku të vendosur e të egër të armatosur me mjetet më moderne, vullneti i hekurt i ushtrisë sonë dhe i popullit të Tiranës triumfoi. Gjaku i bijve të popullit tonë, që ranë në këtë betejë për çlirimin e kryeqytetit tonë, shkroi një nga faqet më të shkëlqyera të luftës sonë ngadhnjimtare».

ENVER HOXHA





Komandanti i Përgjithshëm i UNÇSH, shoku Enver Hoxha, drejton veprimet luftarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare për çlirimin e plotë të Shqipërisë.

URDHËR DREJTUAR SHTABIT TË KORPARMATËS I PËR ÇLIRIMIN E TIRANËS

30 tetor 1944

Shumë urgjent
Shumë konspirativ

Duhet me sulmue Tiranën dhe me e marrë me çdo kusht, dhe s'duhet me pritë që gjermanët të tërhiqen. Politikisht do të jetë një sukses i madh dhe do të ketë reperkusione të mëdha, si brenda edhe jashtë. Ushtarakisht do të zëmë armë e municion dhe automjéte, do të ndalojmë gjermanët të grabitin dhe të djegin. Me këtë sulm partizanët dhe udhëheqësit do të fitojnë besim dhe eksperiencë.

Aksioni mbi Tiranën do të bëhet i kombinuar. Janë në lëvizje Brigada VIII dhe X nën komandën e Asaf Dragotit dhe Qazim Kondit, drejtim Pezë. Këto brigada do të afrohen me Divizionin I dhe vihen nën komandën e korpusit për këtë aksion.

Janë në lëvizje Brig. II dhe XX në drejtim të rrugës Elbasan-Librazhd, për të goditur armikun në rrugë dhe mundësisht për të bërë presion mbi Elbasan.

Janë në lëvizje brigadat XII dhe XI nën komandën e I.R. drejtim Peqin-Kavajë për të goditur rrugët në atë sektor, dhe në rast nevoje për të ndihmuar forcat që operojnë mbi Tiranë.

Dita që do të veprohet, të na njoftohet më parë, që të lajmërojmë të gjitha forcat të bëjnë presion të madh nga të katër anët.

Mbi Elbasan duhet të bëhet diversion ditën e sulmit mbi Tiranë, duke atakuar qytetin me brigadën që ndodhet në atë sektor[1] dhe, në rast se shihet e mundur marrja e këtij qyteti, të sillet me urgjencë një brigadë nga tereni i Dibrës, meqë atje gjendja është e qetë[2].

Pa marrë parasysh pregatitjen e këtij plani, i cili duhet të zbatohet me çdo mënyrë dhe shpejt, duhet të bëni presionin mbi Tiranën dhe, po të shihni mundësitë e marrjes, veproni pa humbur kohë. Në asnjë mënyrë gjermanët s'duhet të ikin rehat e pa luftë.

Gjeneral HOXHA

Faksimile e urdhrit të Komandantit të Përgjithshëm, shokut Enver Hoxha, dërguar Shtabit të Korparmatës I, për çlirimin e Tiranës.




HYSNI KAPO, komisor politik i Korpormatës I Sulmuese, që kryente operacionin për çlirimin e Tiranës.



MEHMET SHEHU, komandant i Divizionit I Sulmues, që vepronte në kryeqytet dhe në rrethet e tij.



GOGO NUSHI. sekretar politik i Komitetit të Partisë për Qarkun e Tiranës.





Nga lufta për çlirimin e Tiranës.





Aspekte nga lufta në barrikada për clirimin e Tiranës.

Partizanët luftojnë sKtëpi më shtëpi për çlirimin e Tiranës.





Populli i Tiranës merr pjesë aktive në ngritjen e barrikadave.


Çast nga lufta për çlirimin e Tiranës.



Në luftën për çlirimin e Tiranës një rëndësi vendimtare pati shpartallimi i kolonës armike prej 3000 vetësh, që vinte në Tiranë nga Elbasani. Beteja e Mushqetas, në afërsi të Kërrabës është një nga betejat më të mëdha e më vendimtare, që pati si përfundim shpëtimin e Tiranës.

Ja si e përshkruan skenën e kasaphanës së Mushqetas një reporter i asaj kohe:

«Kur kalon andej nuk të besohet të kenë qenë 2000-3000 ushtarë. Në bazë të materialit luftarak dhe të mjeteve transportuese, llogaritet të paktën të ketë qenë një divizion gjermanësh. Plaçka është aq e shumtë sa të lë përshtypjen jo të një ushtrie po të ndonjë hordhie të egër. Kur krahason mjetet e shumta e të rënda të armikut, ushtrinë e tij të madhe që marshonte dhe natyrën e vendit, pozitat e forta të tij, me armatimet e pozicionet tona, çuditesh si qe e mundur të shpartalloheshin dhe të asgjësoheshin më tepër se 2000-3000 gjermanë vetëm nga 1200 partizanë».



«Mushqeta» **H. Dule**


Shoku Mehmet Shehu, komandant i Shtabit Operativ për çlirimin e Tiranës, studion situatën e luftës.




Çaste pas një aksioni fitimtar kundër trupave gjermane në afërsi të Tiranës.







Shoku Enver Hoxha i njofton popullit të Beratit çlirimin e Tiranës.



KOMUNIKATE E JASHTEZAKONESHME

Shtabi i Përgjithshmë U.N.Ç.P.V.

komunikon:

Sot më 17-XI-944 më ora 8 u likuidúa rezistenca e fundit gjermane, Tirana u çlirua. Armikut nuk i u la kohë që të prishte Qytetin dhe Centralet e Elektrikut. Ura e Erzenit dhe e Farkës shpëtuan. Rruga Elbasan-Tiranë do të fonksionojë së shpejti.

Shtabi i Përgjithshmë

Vdekje Fashizmit
Liri Popullit

Tirana, pas betejës përfundimtare për çlirimin e saj.











Populli i kryeqytetit fillon jetën e tij të lirë.

Populli i Tiranës pret krahëhapur çlirimtarët.

Fitimtarët përgëzojnë njëri-tjetrin për fitoren e madhe.









Popullsia e qyteteve, e ndjekur nga persekutimet e armikut, kthehet në shtëpi për të filluar jetën paqësore.

Armatime të ndryshme të kapura pushtuesve gjatë luftës së Tiranës.





«17 Nëntor 1944» **B. Sejdini**



Në nëntor u çliruan qytetet: Kukësi (18 nëntor), Puka (20 nëntor), Lezha (20 nëntor), ndërsa Tropoja ishte çliruar më 16 tetor 1944. Në këtë kohë UNÇSH ishte shndërruar e tëra në ushtri të rregullt të popullit dhe të shtetit të ri shqiptar. Ajo kishte tani në gjirin e saj 70 mijë luftëtarë, të organizuar në brigada, divizione e korparmata. Prej tyre 9% ishin gra, rreth 80% të rinj dhe afro 90% fshatarë.



Forcat partizane të Brigadës XII Sulmuese, në bashkëpunim me forcat e Brigadës XI Sulmuese, më 14 nëntor 1944, çliruan qytetin e Durrësit, Populli i Durrësit feston me entuziazëm ditën e lirisë.

Më 11 nëntor 1944 forcat partizane të Brigadës XV Sulmuese çtiruan qytetin e Elbasanit. Populli i Elbasanit feston me gëzim ditën e çlirimit



«Sot 28 Nëntori festohet me një entuziazëm të papërshkrueshëm nga populli shqiptar, i cili e fitoi lirinë me gjak. Sot në Tiranën e çliruar pas një lufte të ashpër, rrugë më rrugë e shtëpi më shtëpi, sot në kryeqytetin e Shqipërisë së lirë e demokratike dhe në gjirin e atij populli heroik, që qëndroi i patundur në pararojën e luftës sonë, që masakrat e gjermanëve dhe të tradhtarëve nuk e përkulën, por e forcuan më tepër, erdhi Qeveria Demokratike e Shqipërisë».

ENVER HOXHA





Populli i kryeqytetit përshëndet me entuziazëm të papërshkrueshëm Qeverinë Demokratike me shokun Enver Hoxha në krye.



Shoku Enver Hoxha dhe anëtarë të Qeverisë Demokratike në ditën e festës së 28 Nëntorit në Tiranë.





I madh e i vogël pret me dashuri hyrjen e Qeverisë Demokratike në Tiranë.






Shoku Enver Hoxha dhe anëtarë të Qeverisë kalojnë në revistë forcat partizane të UNÇSH.



Shoku Enver Hoxha dhe anëtarë të Qeverisë ngjiten në tribunën qendrore.



Shoku Enver Hoxha mban Fjalimin historik ditën e hyrjes së Qeverisë Demokratike në Tiranë.


RINIA E LAGJES



Pamje nga parakalimi i reparteve të UNÇSH.






Pamje nga parakalimi i reparteve të UNÇSH.





Pamje nga parakalimi i reparteve të UNÇSH.






Populli i Tiranës në mes të një entuziazmi të papërshkruar përshëndet ushtrinë e tij, që me heroizëm të pashembullt çliroi Atdheun.



Shoku Enver Hoxha midis nënave të dëshmorëve.



Populli nderon kujtimin e dëshmorëve.

VDEKJE FASHIZMIT LIRI POPULLIT

BULETIN I LUFTËS NACIONAL-ÇLIRIMTARE

FLETË E PËRDITËSHME

VITI I-rë TIRANË 28 NËNDOR 1944 Nr. 81

Populli Shqipëtar feston ditën e 28 Nëndorit

Pas pese shekuj robërie të rëndë, në qytetin e Vlorës më 28 Nëndor 1912, u ngrit flamuri kumbetar. Kudo populli shqipetar e festoi këtë ditë të lirisë plot gezim. Indipendencën n'até kohe e fituam. Përpjekjet e patriotëve patën një frut.

Por s'kishim asgjë ahere që t'a ruanim këtë independencë. Në çdo çast ishim në rrezik që tregetarët e politikës të na i shitnin këto.

Kaluan që atëhere 27 vjet gjer më 7 Prill 1939 kur pazarllëku për Shqipërinë mori fund. Vendi i yne u be prenja e fashizmit. Populli i ynë ra në një skllavëri edhe më të rëndë, që ishte pjella e këtyre tregtar flamujsh te etiket ikën me vrap duke e tradhëtuar aqe dhe keq dhe e lënë në mëshirën e okupatorit fashist.

Pesë vjet robërie më të rende se kurdoherë kaloi populli shqipëtar. Ky popull i shumëvuajtur.

Dita e zezë mbuloi vendin t'onë

Por në dejt e populli shqipëtar zjen gjaku për liri. Që në ditët e para u mundua t'i dalë zot vëndit te vet dhe vetvehtes. Që até ditë filloi rezistencën e tij, e cila më pas u be me arma, me luftë të vazhduarshme, kundër okupatorit dhe tregëtarëve te zakonëshëm të politikës, të cilet mundohethin t'a mbanin te skllavëruar, të shtypnin ndjenjat e tij liridashëse dhe përparimtare.

Na me luftën t'one pesëvjeçare i treguam botës se jemi pasardhës te denjë të traditave luftarake dhe liridashëse të stergjyshëve tone, që u përpoqen në Kuvendin e Leshit, me 1444, me 1878, më 1912, në Luftën e Vlorës më 1920 për të na lënë nje Shqipëri të Lirë.

Pesë vjetët e robërisë kanë mbaruar. Me luftë e gjak, përpjekje, sakrifica dhe heroizma, ayt i tërë populli shqipëtar feston ditën e 28 Nëndorit, i lirë dhe krenar.

Festa e flamurit këtë vit ka një ndryshim renjëmuar nga ajo e vitit 1912. Sot e festojmë këtë ditë me një Shqipëri të Lirë me të vertetë pa tregetarë te politikes me një Ushtëri t'one lavdiplote, që eshtë një force sigurimi për t'a ruajtur ne çdo kohe këtë indepen-dence. Populli Shqipëtar e feston këtë ditë i lumtur se e sheh vehten e tij te bashkuar, të forte e t'organizuar, me një front të perbashket Nacional-Çlirimtar, me një Qeveri te tij Demokratike, frut i perpjekjeve dhe i luftrave te pergjakeshme kundra okupatoreve te forte e barbare dhe te gjithe tradhetareve t'Atdheut, qe me çdo menyre u munduan t'a perçanin dhe t'a benin vegël te dëshirave te tyre.

Populli shqipetar sot ne këtë feste te madhe brohoret lirin e tij, Ushtërin e tij qe eshte garancia e lirisë, Qeverinë e tij Demokratike Çlirimtar që u perpoq te realizoje aniteën politik per te ndertuar Shqiperine e re si dhe udheheqësin e dashur te tij Gjeneral-Kolonel ENVER HOXHËN.

DËSHMORËVE

Kur zgjedhë e tiranise
Mbi popullin rëndoi:
Në zemrat t'uaj, shokë,
Kushtrimi shpejt ushtoi

Mbi tanksa dhe ilogore,
Mbi tela dhe zenzherë,
E dhate jetën t'uaj,
O shokë, o martirë.

I thyet prangat, shokë,
Me rrullin guximtar
Dhe skuqte me gjak t'uaj,
Flamurin çlirimtar.

Mbi varre t'uaj ejellim
Sot lule dhe kurore,
Për jetë ju kujtojmë,
O shokë, o dëshmorë

28 Nendor 1944

Radio Tirana

Programi i 28 Nëntorit ora 17-19

1) Hymni i Flamurit
2) Hymni i Këshillit Nac. Çlir.
3) Mbi manifestimin e 28 N. në Tiranë
4) Hymni i ushtrisë
5) Lajme të Jashtëme
6) Hymni i Rinis
7) Ora e Rinisë
8) Ora e gruas
9) Ora 20 lidhet me Kinema Kosovën

Nga lufta dhe vullneti i popullit lindi Qeverija e l-rë Demokratike e Shqipërisë. Me punën dhe përkrahjen e palodhur të popullit ajo do të realizoj problemet që i shtrohen përpara. Nuk e kurcyem gjakun t'onë për të realizuar një Qeveri të tillë, nuk do të kurcejmë energjin t'onë për ta ndihmuar dhe përkrahur në barrën e saj të madhe.



Më 29 Nëntor 1944, forcat partizane të Divizionit II Sulmues në bashkëveprim me forcat partizane të grupit të Shkodrës çliruan Shkodrën, qytetin e fundit. Populli i Shkodrës pret me entuziazëm bijtë e tij çlirimtarë. Po atë ditë u krijua në Shkodër Brigada XXVII S.

Kuadro dhe luftëtarë të Brigadës XXVII Sulmuese.






Më 29 Nënfor 1944, pas pesë vjet e gjysmë lufte heroike nën udhëheqjen e Partisë Komuniste kundër pushtuesve fashistë italianë e gjermanë dhe kundër tradhtarëve të vendit, e gjithë Shqipëria ndodhet e çliruar. Kudo valon flamuri i lirisë. Populli shqiptar ka zhdukur përgjithmonë sundimin e huaj, ka shkatërruar krejtësisht sundimin politik të çifligarëve e të borgjezëve. Ka triumfuar revolucioni popullor, vendi ka hyrë në rrugën e socializmit.

29 Nëntori hyri në historinë e popullit shqiptar si Dita e Çlirimit të Atdheut dhe e fitores së revolucionit popullor.

Pas çlirimit të vendit, me vendim të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare dhe me urdhër të Komandantit të Përgjithshëm, shokut Enver Hoxha, Divizionet V dhe VI të UNÇSH ndoqën pushtuesit hitlerianë në tokat e Jugosllavisë.

Gjatë viteve 1942-1945, përtej kufijve shtetërorë të Shqipërisë, në Dibër e në Maqedoni, në Kosovë e Mal të Zi, në Bosnje e Hercegovinë kanë luftuar me heroizëm kundër pushtuesve italo-gjermanë më tepër se 20 000 luftëtarë të UNÇSH për çlirimin e vëllezërve shqiptarë të Kosovës dhe të popujve të Jugosllavisë. Në këto luftime kanë dhënë jetën qindra partizanë shqiptarë.





Reparte partizane të UNÇSH në marshim në tokat e Jugosllavisë.



Pamje nga luftimet në tokat e Jugosllavisë.



Pamje nga luftimet në tokat e Jugosllavisë.





Pamje nga luftimet në tokat e Jugosllavisë.

Luftëtarë të UNÇSH dhe të UNÇJ në tokat e Jugosllavisë.





Luftëtarë të UNÇSH në tokat e Jugosllavisë nderojnë kujtimin e bashkëluftëtarit të tyre të rënë në fushën e nderit.

Luftëtarë të UNÇSH parakalojnë në qytetet e Jugosllavisë, që i kanë çliruar së bashku me UNÇ Jugosllave.





Çaste nga nisja për në Atdhe e luftëtarëve të UNÇSH, që morën pjesë në luftimet për çlirimin e Jugosllavisë.



Krenar për luftën kundër pushtuesve fashistë populli shqiptar, si një nga pjesëtarët më aktivë të koalicionit antifashist hyri në analet e historisë së luftës kundër fashizmit me një kontribut të çmueshëm në fitoren historike mbi fashizmin. Në truallin shqiptar shkeli këmba e më shumë se 700 mijë ushtarëve fashistë. Populli ynë gozhdoi në luftë më se 15 divizione italiane dhe gjermane dhe nxori jashtë luftimit më se 70.000 armiq. U shkatërruan dhe u kapën qindra tanke dhe autoblinda, 1331 topa e mortaja, 1934 kamiona dhe një sasi shumë e madhe municioni e materiali luftarak.





«Partizani fitimtar». **0. Paskali.**



Nazistë të vrarë dhe materiale të kapura armikut.




Vorsicht bei Transport
und Einbau






«Agim me titore» **M. Fushekati**





Dhe ja fundi i agresorëve.







Në kampet e vdekjes u masakruan shumë patriotë shqiptarë.

Ky tas, simbol i vuajtjeve të Mathauzenit, në kujtim të patriotëve shqiptarë, që vdiqën në kampet naziste të shfarosjes. Në të këtilla tase të internuarit hanin lëngun. Teli është marrë nga ai që rrethonte kampin, këmbëzat nga dërrasat e barakave, toka nga ajo ku janë varrosur luftëtarët e lirisë dhe qesja është bërë nga këmishët e tyre.



Lufta Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve italianë e gjermanë dhe kundër tradhtarëve është lufta më e përgjakshme dhe më burrërore, që kanë bërë shqiptarët gjatë historisë së tyre. Dëmet që pësoi populli ynë qenë gjithashtu shumë të mëdha. U vranë 28.000 vetë, u plagosën 12.600, u internuan në Itali e Gjermani 12.000 vetë, u shkatërruan 1850 qytete e fshatra.


Për sa u përket dëmeve materiale të pësuara gjatë Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria zë një nga vendet e para në botë, po të llogariten këto për frymë të popullsisë.













Populli shqiptar nderon me respekt të thellë dëshmorët e lirisë, që dhanë jetën për çlirimin e vendit.

«Ne kujtojmë me krenari Luftën vigane Nacionalçlirimtare të popullit tonë, veprën e pavdekshme të partizanëve trima, që hodhën themelet e patundshme të Republikës Popullore të Shqipërisë, të pushtetit popullor, të jetës së re që gëzojmë sot».

ENVER HOXHA



«Nënë Shqipëri» K. Rama**, Sh. Hadëri, M. Dhrami.**

- **FORMULIMI GRAFIK**

- **HIQMET AGOLLI**
- **SPIRO KRISTO**

SHTYPUR NË KOMBINATIN POLIGRAFIK
Shtypshkronja e Re - TIRANË